

BISMIL'LAHI'R-RAHMANI'R-RAHIM

TASAVVUFI DHE METODAT E EDUKIMIT

Dilaver Selvi

Prishtinë, 2015

SHTËPIA BOTUESE “PIRAMIDA” PRISHTINË

Për botuesin:

Mustafë Voca, ecc. i dipl.

Titulli i origjinalit:

TASAVVUF VE TERBIYE METODLARI

Përgatiti dhe përktheu:

Is-hak Shala dhe Abdullah B. Ferizi

Përgatitja kompjuterike:

İlhan Bölükbaşı

U shtyp në shtypshkronjën SHKROLA PRINT

ISBN

978-9951-18-174-7

Përmbajtja

HYRJE	5
TASAVVUF DHE SUFI.....	7
BURIMI I TASAVVUFIT ËSHTË KUR’ANI DHE SUNNETI.....	9
PASTËRTIA E ZEMRËS, QËLLIMI KRYESOR I TASAVVUFIT	16
SI E PËRMEND KUR’ANI SUFIZMIN?	25
SUFI ËSHTË EMËR TJETËR PËR BESIMTARIN E DEVOTSHËM .	31
ÇDO SALIK NUK QUHET SUFI	39
SHKALLA E PARË E SUFIUT - IMANI DHE DASHURIA.....	43
NUK BËHESH SUFI VETËM ME LIBËR	50
TASAVVUFI ËSHTË MORALI I KUR’ANIT DHE SUNNETIT	52
TASAVVUFI NUK PRANON EMËR TË RREJSHËM	61
SEJR-U SULUK DHE METODAT E EDUKIMIT	67
ÇKA ËSHTË SEJR-U SULUK?	68
ÇKA ËSHTË DHIKRI?	70
ESENCA DHE QËLLIMI I IBADETEVE ËSHTË DHIKRI	73
PIKA E PARË NË DHIKËR	79
LLOJET DHE MËNYRAT E TË BËRIT DHIKËR	82
DHIKRI I FSHEHTË.....	85
RRUGA E MËSIMIT TË DHIKRIT TË FSHEHTË	87
11 METODAT THEMELORE (USUL)	88
SQARIMI I DISA METODAVE BAZË	100

DHIKRI ME ZË (I HAPUR)	138
ÇKA ËSHTË VIRDË?	140
DOBITË E DHIKRIT	142
SOHBETI	149
RABITA - URA NGA ZEMRA NË ZEMËR	152
SECILI MUND TË BËJË RABITËN	154
RABITA ËSHTË NJË LLOJ MEDITIMI	155
KRITERI BAZË NË RABITA	159
DOBITË E RABITËS.....	159
PËRFUNDIM: TASAVVUFI ËSHTË SHËRBËTOR I FESË	165

HYRJE

Falënderimi (hamd) i përket Atij që na krijoi, që na mban në jetë, që na ngriti e lartësoi me islam, më të Mëshirshmit të Mëshiruesve, Rabbit të të gjithë botëve, Allahut Teala.

Salat dhe selam i qoftë të dërguarit - mëshirë për të gjithë botët, robit më të dashur të Allahut, Diellit të evliave, Hënës së plotë të pasuesve të sunnetit të tij, prijësit të pejgamberëve, Muhammedit s.a.v.s..

Salat dhe selam ju qoftë Ehl-i Bejtit, të pastër në të jashtmen dhe të brendshmen.

Salat dhe selam ju qoftë as'habëve, atyre që janë lartësuar nga shikimi i Resulallahut s.a.v.s., që janë përsosur me muhabetin e tij, e të cilët të ngritur si yje kanë mbajtur gjallë dritën e njerëzimit.

Respekt dhe nderim ju qoftë të gjithë dijetarëve, arifëve¹dhe robërve të mirë që kanë bartur deri tek ne nurin, njohjen, bereqetin dhemoraline bukur(ahlak), të Pejgamberit të mëshirës të ardhur në sipërfaqen e Tokës.

Në këtë libër shtjellohen tema që gjatë historisë, si edhe sot, janë të rëndësishme për myslimanët. E këto tema janë edukimi shpirtëror,sufizmi dhe tasavvufi.

Kush është sufi, çka është sufizmi?

¹Arif [rrjedh prej fjalës irfan]: ai që di; ai që njeh; i ditur; ai që njeh Hakun; ai që me Hak e njeh Hakun.

Përgjatë historisë, tasavvufi gjithmonë ka ruajtur rëndësinë e vet. Cili është vendi, nevoja dhe lidhshmëria e tasavvufit me Kur'an dhe sunnet?Çfarë ndodh me atë që mohon tasavvufin?A është edukimi në tasavvuf,farz(obligim),apo vlerë e lartë?A është e mundur ngritja dhe edukimi pa tasavvuf?A është e domosdoshme që çdokush të hyjë në edukimin e tasavvufit?Nëse tasavvufi merret me obligimet siç janë teube, dhikër, vird, devotshmëri (takva), meditim (tefekur),dhe ngritjen e njeriut në përsosmëri (insan-i kamil), atëherë si do t'i përmbushë këto obligime ai që nuk i hyn kësaj rruge?

Kësaj, dhe pyetjeve të ngjashme duhet t'iu jepet një përgjigje, sepse për këtë temëinteresohe masë e madhe njerëzish.

Nëlibrin që keni në dorë, për pyetjet që u cekën më lartë,përgjigjet ikërkuam në veprat e dijetarëve që e zotërojnë këtë dijeni.Arritëm në burimet themelore të tasavvufit; u këshilluam me zotëruesin e kësaj diturie. Besojmë që dhamëdituri të mjaftueshme për ata që janë të interesuar dhe që kuptojnë.Të bëhet e qartë që ne nukprovojmëtë bindim askënd të besojë në atë çka ne flasim, as të bindim ata që mohojnë tasavvufin. Ajo çka na takon neve është që vetes dhe vëllezërve tanë t'iu tregojmë të drejtën (hak).Pas kësaj,gjithçka mbetet në vlerësimin e Allahut Teala.

Dilaver Selvi

TASAVVUF DHE SUFI

Çka është tasavvuf? Kush është sufi? Këto pyetje janë të vjetra sa vet historia e tasavvufit. Prej momentit që këta dy emra janë paraqitur, ato asnjëherë nuk kanë dalë prej rendit të ditës. Siç po shihet, kjo do të vazhdojë deri në ditën e kiametit për shkak se synimi i tasavvufit është edukimi i njeriut, pra është një sistem që ka për qëllim moralin (ahlak)² e njeriut. Përderisa njeriu të qëndrojë në këtë botë, i obliguar me edukatë morale të mirë, tasavvufi do të vazhdojë të ekzistojë, të bëjë detyrën e vet dhe t'i shërbejë këtij qëllimi.

Tasavvufi i vërtetë është shërbëtor i Islamit, përfaqësues i devotshmërisë (takva) dhe edukimit, është kopsht i dashurisë. Këtë të vërtetë duhet ta dinë ata që hyjnë në edukimin e tasavvufit, por edhe ata që e kritikojnë nga jashtë.

Ne, në këtë vepër do të mundohemi të japim dituri për këto dy struktura njerëzish, ata që hyjnë dhe ata që e kritikojnë nga jashtë. E, qëllimi është ky:

Ata që i hyjnë kësaj rruge të dinë arsyen pse kanë hyrë, si edhe të jenë të vetëdijshëm që janë duke bartë një amanet. Edhe ata që e mohojnë dhe kritikojnë tasavvufin pa e njohur atë, tadinë se kundër çka janë dhe të shohin se çka përfitojnë me këtë në përfundim.

²**Ahlak [sh. Hulk]:** moral; edukatë; shprehje; veçori; natyrë; karakter; gjendja shpirtërore dhe mendore e njeriut; sjellja dhe qëndrimi moral i njeriut.

Ajo që fillimisht na takon neve është të dimë saktë se çka është sufizmi dhe tasavvufi. Kjo dituri na sjell dy dobi të rëndësishme:

E para, mësojmë se si kjo rrugë ka qenë aktuale në të gjitha periudhat, duke përfaqësuar thirrjen në Islam (davet) në mënyrën më të bukur.

Dhe e dyta, të përfitojmë nga ky oqean i mëshirës (rahmet) dhe nga burimi i edukatës.

Sot, tasavvufi dhe sufiu nuk njihen në kuptimin e tyre të vërtetë. Si shumë terme tjera të fesë, edhe këto përdoren gabimisht; nuk njihen kuptimet e tyre të vërteta, prandaj edhe bëhen akuza të padrejta dhe vlerësime të gabuara.

Duke u dhënë mosdije kuptime të gabuara fjalëve dhe koncepteve, e drejta(hak) dhe besëtytnitë(batil) janë duke u përzier. Prandaj, në kohën e sotme materialiste, vlerat e larta të fesë sonëshihen si të pavlefshme. Zaten, në njeriun e sotëm është duke u fikur kuptimi i fesë - drejtimi kah bamirësia dhe respekti për vlerat e fesë janë duke u pakësuar dukshëm. Gjithashtu, për vite të tëra, armiq të fesë, tinëzisht dhe me plan, përhapën konfuzion për fjalë të caktuara në mes të myslimanëve, duke prezantuar të shenjtën si të ultë dhe të ulëtën si të shenjtë.

Duhet të jemi të mençur dhe t'i njohim kriteret, duhet të jemi të kujdesshëm dhe mendje-zgjuar. Për një punë që nuk kemi dijeni, të pyesim ata që janë të aftë në atë punë. Nuk duhet të jemi të ngutshëm në gjykim. Mos të mohojmë diçka të cilës nuk ia njohim të vërtetën dhe nuk e kuptojmë menjëherë. Kjo sepse bie në rrezik t'i thuhet besimtarit qafir, të diturit - injorant, arifit - i pavëmendshëm (gafil).

Mos të harrojmë këtë: nëse për një person ose sistem japim një gjykim që nuk përputhet me pëlqimin e Allahut, ne *i hyjmë në hak* – ia cenojmë të drejtën; në ahiret, ai gjykim bëhet dëshmi për ne, japim llogari për të.

BURIMI I TASAVVUFIT ËSHTË KUR'ANI DHE SUNNETI

Përputhja me kriteret hyjnore, siç ika përcaktuar Kur'ani dhe sunneti, është kusht për një veprim që ka për qëllim kënaqësinë(riza)e Allahut Teala. Të gjitha kriteret që i paraqet Kur'ani dhe sunneti, quhen islam.

Allahu Teala haptas ka shpallur që përpos Islamit, nuk do të pranojë asnjë fe, rrugë, filozofi ose veprim tjetër dhe këtë e ka lidhur me gjykimin definitiv:

“E, kush kërkon fe tjetër përveç fesë islame, atij kurrësi nuk i pranohet, dhe ai në botën tjetër është nga të dëshpëruarit.” 3-Ali Imran: 85.

Kurse Resulallahu s.a.v.s. na njofton:

“Kush e bën një punë e ajo punë nuk është(haptas ose me shenja) në urdhrin(dhe lejimin) tonë, ai (person dhe puna, tek Allahu) refuzohet.”³

Kur lexon për këto dëshmi, natyrisht që njeriu mund të shtrojë këto pyetje:

Në qoftë se tek Allahu Teala nuk është e pranishme asgjë tjetërpërveç Islamit, atëherë çka janë shkollat (medh’hebet) e fikh-ut me emra të ndryshëm dhe rrugët e edukimeve (tariketet) që kanë hyrë në jetën tonë? Ku janë këto në rrethin e islamit? Në qoftë se të gjitha ato janë pjesë e islamit, pse përmenden dhe shpjegohenme emratë ndryshëm? Këta emradhe shkolla të ndryshme, a nuk e prishin bashkimin e fesë? Nëse feja është një, pse u shfaqënrrugë të ndryshme?

Në historinë e islamit, këso lloj pyetjesh në lidhje me medh’hebet dhe tasavvufinjanë parashtruar gjithmonë. Këtyre pyetjeve, shkurtimishtmund t’iu përgjigjemi kështu:

Medh’hebet dhe rrugët eedukimit nuk janë vet feja, ato përbëhennga udhëzimet e fesë dhenga komentimi i kuptimeve të Kur’ani Kerimit(tefsir). Asnjëra nuk e dëmton, e as që e rrënon fenë; përkundrazi – ato i bëjnë shërbim fesë. Këto

³ Buhari, I’tisam, 20; Muslim, Ekdijje, 17; Ebu Davud, Sunnet, 5; Ibnu Maxhe Mukaddime, 2.

dyja(medh'hebet dhe tasavvufi)kanë bërë një detyrë të rëndësishme duke u bërë zëdhënës për temat për të cilat sheriatu ka heshtur, dhe për ato që i ka lejuar ixhtihadi(vendim që nxirret nga Kur'ani dhe sunneti e që nuk prek esencat e Sheriatit). Të kthehemi tek tasavvufi.

Para së gjithash tasavvufi nevojitet të kuptohet drejtë.Është gabim që tasavvufi të paraqitet si tabu.

Tasavvufi nuk është diçka që nuk kuptohet me mendje,që nuk shpjegohet me gjuhë dhe të cilit nuk mund t'i afrohemi. Shpjegimi i fjalës tasavvuf është i lehtë; por jetësimi i tasavvufit është i vështirë.

Tasavvufi është i hapur për kritikë.Kritikat e drejta dhe me vend, pastrojnë tasavvufin prej besëtytnive. Por, kritikatat e gabuara dhe të padrejta bëhen ngatërresë, ndezin zjarrin e armiqësisë.Edhe ai që hyn në tasavvuf, edhe ai që gjuan gur mbi të, duhet ta njohin mirë tasavvufin. Përndryshe, njëri me injorancë, tjetri me pavëmendje, i bëjnë të padrejtë.

Edukimi i tasavvufit është ndërtuar mbi edukimin dhe moralin që e mësoi Allahu Teala dhe Resulallahu s.a.v.s..Është një sistem i edukatës morale dhe shpirtërore. Qëllimi është që njeriutë ngritetme devotshmëri dhe të edukohet me moral të bukur,për të arritur kënaqësinë e Allahut Teala.

Në qendër të edukimit të tasavvufit gjendet murshid-i kamil⁴-shejhu. Kompetencën për të edukuar njerëzit, shejhu nuk e merr nga njerëzit, por nga Haku Teala. Kjo punë kërkon njohuri dhe dijeni. Ai që nuk është edukuar në të vërtetën, nuk mund të edukojë të tjerët.

Se çka është kjo rrugë, Shejhui madh Ebu Hafs Haddad shkurtimishtë përshkruan me këto fjalë:

“Tasavvufi është tërësisht i përbërë prej edukimit. Çdo moment, çdo gjendje dhe çdo gradë, ka një edukim të vetin. Sa herë që dikush zbaton edukimin, bëhet mik i Allahut Teala. Dikush që nuk e ruan edukimin, sado që të mendojë për vete se është në gjendje të mirë, në të vërtetë ai nuk ka vend dhe vlerë tek Haku. Nëse një person mendon se para prezencës hyjnore është i pranishëm, në të vërtetë është shumë larg.”⁵

Në këtë shkollë, hyjmë me sinjeritet e dalim me edukim. Ata që me sabër (durim) vazhdojnë, me lejen e Allahut Teala arrijnë në qëllim, marrin *diplomë* në miqësinë hyjnore. Lum’ata që janë bërë miq të Allahut Teala!

⁴**Murshid:** Shejh: ai që udhëzon në rrugën e drejtë; piri i tarikatit; trashëgimtari i Pejgamberit s.a.v.s.. * **Në traditën tonë, Murshidi është quajtur me emërtimin *Shejh*.**

Kamil: i përkryer; i përsosur.

⁵ Huxhvir, Keshfu’l-Mahxhup, 51; Suhreverdi, Avarif, 54.

Synimi i edukimit të tasavvufit është që të arrijë te njeriu dhe ta pasurojë atë me edukim hyjnor. Thirrja në Islam (davet) është për njeriun, e njerëzit janë me natyra të ndryshme.

Çdo njeriut,dashuria (muhabet) dhe marrëdhënia me Allahun Teala i paraqitet ndryshe, varësisht nga natyra që ka. Për tëshpjeguar këtë,shehlerët thonë: *“Numri i rrugëveqë çojnëtek Allahu Teala është sa numri i krijesave.”*

Pra, në këtë mënyrë, të mëdhenjtë e tasavvufit, pa asnjë lëshim nga esenca e fesë, janë munduar të përdorin metoda të ndryshme që të arrijnë deri te njeriu, ta zbulojnë atë dhe t’ia zgjerojnë aftësitë. Kjo praktikë, nga fillimi deri në fund, quhet *‘sejr-u suluk’* (edukim shpirtëror).

Të mëdhenjtë e tasavvufit, metodat e edukimit në themel i kanë marrënga Kur’ani dhe sunneti.Gjithashtu kanë përdorur vlerat dhe përvojat e përbashkëta të njerëzimit. Këtë e kanë bërë duke iu përshtatur hadithit:

“Urtësia(hikmet)është pasuria e humbur e besimtarit, dhe është e drejtë e tij ta marr, kudo që e gjen.”⁶

⁶ Tirmidh, Ilim, 19; Ibnu Maxhe Zuhd; 10.

Ata gjithashtu kanë shfrytëzuar principet e dobishme që feja jonë i pranon, siç janë zakonet, adetet dhe veprat e mira. Të mëdhenjtë kanë pranuar kriteret nga fetë e mëparshme, të cilat nuk janë anuluar, dhe vlerat e edukatës morale të këtyre kritereve i kanë vlerësuar sipas nevojës. Gjatë gjithë kësaj kohe, ata vazhdimisht kanë pasur parasysh këtë princip:

“Imitimi është i ndaluar në parimet kryesore. Por, imitimi është i lejuar për metodat që ndihmojnë në realizimin e këtyre parimeve.”⁷ Kjo nënkupton:

Nuk pranohet asgjë që kundërshton parimet themelore të fesë islame dhe diçka e tillë nuk mund të paraqitet si pjesë e fesë. Por, dituria dhe përvoja e feve jashtë islamit, në qoftë se nuk janë të kundërta me parimet e islamit, mund të shfrytëzohen.

Kështu, Resulallahu s.a.v.s., në luftën e hendekut ka përvetësuar dhe ka shfrytëzuar mënyrën e gërmimit të persianëve.⁸

Resulallahu e ka bërë këtë qetëketë sukses në luftë, dhe mori përfundim të mirë. Gjërat që shërbejnë për arritjen e qëllimit të një ibadeti, janë po aq të çmueshme sa vet ibadeti.

⁷ Për më shumë: Abdulbari en-Nedvi, Bejne't-Tasavvufi ve'l-Hajat, 50-54.

⁸ Suhejli, Ravdu'l-Unuf, VI, 306; Ibnu Kethir, es-Siretu'n-Nebevije, III, 183; Ibnu Haldun, Tarih, II, 29.

Të këtilla janë edhe shfrytëzimet e njohurive dhe përvojave të të tjerëve, të cilat i kanë bërë të mëdhenjtë e tasavvufit. Këtë kuptim të gjerë të tyre, dhe përqaftimin e njerëzve, ata që nuk kanë mundur ta kuptojnë tasavvufin, e kanë vlerësuar si një lëvizje që ka burim të jashtëm.

Ndërsa, kur kjo çështje të analizohet dhe kur bëhet gjykimi drejtë, çdokush e sheh këtë të vërtetë. Kështu, njohësi i islamit, shkencëtari francez Roger Garaudy, në hulumtimet përfundimtare, lidhur me këtë temë arriti në këtë përfundim:

“Tasavvufi nuk rrjedh nga misticismi i krishterë. Tasavvufinuk buron nga filozofia e re. Tasavvufi nuk ka lindur nga njohuria hinduse. Burimi i tasavvufit është Kur’ani.”⁹

Në fakt, të pyesësh dikë që është jashtë tasavvufitse *“çka është tasavvuf”*, është gabim. Kjo pyetje duhet t’u shtrohet arkitektëve të kësaj pune.

Arkitektët e tasavvufit kanë njohur, prezantuar dhe shpjeguar tasavvufin në shumë aspekte të ndryshme. Sipas konstatimit të Imam Suhreverdit këto shpjegime kalojnë numrin njëmijë¹⁰. Me deklaratën e Zerrukit arrin deri në dymijë¹¹. Esenca e të gjitha këtyre përshkrimeve është kjo:

⁹ Roger Garaudy, Islami dhe ardhmëria e njerëzimit, 38-42.

¹⁰ Suhreverdi, Avarifu’l-Mearif, 47.

¹¹ Zerruk, Kavaidu’l-tasavvuf, 3. (Kajro, 1989)

Tasavvufi përbëhet prej edukatës së bukur morale.

Morali i bukur është edukimi me sheriat. Kjo është miqësia me Allahun Teala.

Rruga për të përfituar këtë gjendje shpirtërore është përshtatja me sinqeritet (ihlas)të dashurit të Allahut Teala (Habiballah)- Muhammedit s.a.v.s..Kush i përshtatet, bëhet mik i Allahut Teala.

Zemra është qendra e kësaj miqësie dhe adhurimi.Për këtënevojitet që punët të fillohen ngazemra. Problemi më i madh është rigjallërimi i zemrës.

PASTËRTIA EZEMRËS, QËLLIMI KRYESOR I TASAVVUFIT

Çka nënkuptojmë me pastërtinë e zemrës?

Kjo temë, edhe pse përbën vet themelin e fesë tonë, nuk është me ndjeshmëri të njëjtë për secilin besimtar.

Në ditët tona, ibadetet që janë farz dhe largimi nga gjynahet e mëdha të jashtme, prezantohen sitakva (devotshmëri)dhe me këtë kënaqemi.

Kjoështë shkalla e parë e devotshmërisë, por pa dyshimjo edhe pika e fundit. Pastërtia nuk realizohet plotësisht, nëse nuk pastrohen gjynahet e fshehta, të cilat gjinden në zemër dhe punohen me zemër. Allahu Teala urdhëronlargimin nga çdo lloj gjynahu:

“Dhe mos bëni gjynahe as haptas as fshehtas. Ata që bëjnë gjynah do të ndëshkohen për gjynahun e bërë.” 6-En’amë: 120.

Pastrimit të zemrës Kur’ani ia ka dhënë emrin *tezkije*, dhe atë e ka lidh me shpëtimin e pafund:

“I shpëtuar është ai që pastrohet,
që e përmend emrin e Rabbit të vet dhe që fal namaz!”87-A’ëla :14-15.

“Vërtet, kushdo që e pastron shpirtin, do të shpëtojë,
ndërsa kushdo që e shtyp atë (me punë të këqija),
do të dështojë.”91-Shems:9-10.

Detyra themelore e Resulallahut s.a.v.s. është mësimi i shpalljes dhe pastrimit.

“Është e vërtetë se Allahu u dha dhuratë të madhe besimtarëve, kur ndër ta, nga mesi i tyre dërgoi të dërguar që atyre t’u lexojë shpalljen e Tij, t’i pastrojë ata, t’ua mësojë Kur’anin dhe sheriatin, edhe pse më parë ata ishin krejtësisht të humbur.”

3-Ali Imran: 164.

“Ai është që analfabetëve u dërgoi Pejgamberin nga mesi i tyre që t’iu lexojë ajetet e Tij, t’i pastrojë ata, t’ua mësojë librin dhe sheriatin, edhe pse më parë ata ishin në një humbje të dukshme.”62-Xhuma:2.

Tezkije është pastrimi i zemrës prej ndyrësirave shpirtërore siç janë shirku, mohimi (kufër), kryengritja dhepavëmendja. Ky pastrim bëhet me iman, nur, dituri, pendim, me lot dhe ibadet.

Hadithet vendosin zemrën në qendër të besimit dhe moralitë bukur (ahlak). Resulallahu s.a.v.s., kështu shpjegoi vendin e zemrës në jetën fetare të njeriut:

“Në trupin e njeriut gjendet një pjesë e tillë që, kur ajo pjesë të jetë e mirë, tërë punët e trupit bëhen të mira dhe të bukura. Por kur ajo pjesë prishet, prishet tërë trupi. Keni kujdes, kjo pjesë është zemra.”¹²

Për këtë arsye edukatorët, që janëmurshidët e përsosur,si cak të parë zgjedhin zemrën. Të gjitha punëtidrejtojnë kah zgjimi dhe rigjallërimi i zemrës. Këtëe kanë vazhdimisht në rend dite, dhe ndajnë shumë kohë për ta realizuar.

Me keqardhje duhet të cekim se sot, në mesin e myslimanëve, zemra është lënë pas dore; në përgjithësi - mundimet janë të orientuara kah barku dhe trupi.Meqë janë të fshehura, gjynahet që bëhen me zemërnuk ndalen ashtu siç ndalen gjynahet e hapura.

Për shembull, vrasja e njeriut, pirja e alkoolit, gënjeshtër -janë prej gjynaheve të hapura. Një besimtar, ashtu si largohet prej këtyre gjynaheve, duhet të largohet edhe prej gjynaheve të fshehta,siç janë inati, mendjemadhësia, zilia, dyfytërësia, dashuria e pamasë

¹² Buhari, Iman, 39; Muslim, Masakat, 107; Ibnu Maxhe Fiten, 14.

ndaj kësaj bote, kundërshtimi i kaderit, mos-kënaqësia me miratimin hyjnor, pavëmendshmëria (gaflet).

Sipas transmetimit nga Ibnu Haxher el-Hejtemiu¹³, gjynahet që bëhen me zemër janë më të rrezikshme se sa gjynahet që bëhen me organe të jashtme; sepse ato si përfundim dëmtojnë imanin, pengojnë pranimin e ibadeteve, asgjësojnë sevapet dhe veprimet e drejta e të mira.

Shumica e gjynaheve të fshehta tërheqin njeriun në shirk, e përlyejnë me dyfytirësi, bile edhe e nxjerrin nga feja. Gjynahet e fshehta që gjejnë vend në zemër janë të vazhdueshme, dhe e fusin njeriun në rrezik në çdo kohë. Gjynahet e hapura nuk janë të tilla.

Një njeri nuk mundet të vras njerëz vazhdimisht, nuk mund të pijë alkool pa bërë ndonjë ndërprerje. Por një njeriziliqar vazhdimisht piqet në zjarrin e zilisë. Njeriu mendjemadh, në çdo punë qet në shesh mendjemadhësinë e tij. Secilës punë që bën dyfytirëshi - i vjen erë dyfytirësi. Dashuria ndaj kësaj bote dhe ambiciet për pasuri, nëse nuk mjekohen – bëhen plagë dhe perde në zemër deri sa të del shpirti. Aq sa është e vështirë të dallohen gjynahet që mbështjellin zemrën, aq është e vështirë edhe të braktisen ato. Për këtë arsye, njerëzit që janë përmirësuar, dhe që kanë gjetur qetësi shpirtërore, janë të paktë.

¹³ Hejtemi, ez-Zevaxhir, I, 49.

Tema kryesore e tasavvufit është fikhu i brendshëm(*fikh-u batin*). Fikhu batin është dituri e ndritshme që ka për qëllim pastrimin, edukimin, ngritjen dhe përparimin e qendrave shpirtërore që formojnë botën e brendshme: zemrën,shpirtin dhe nefsin(egon).

Fikhu i jashtëm (*Fikh-u zahir*)na mëson si të bëhen ibadete me gjymtyrët e jashtme. E tasavvufi,që mund tëquhet edhe fikhu i brendshëm (*fikh-u batin*), ka për temëkryesore ibadetet e zemrës dhe moralin e bukur (ahlak).

Në edukimin shpirtëror, qëllimi është që zemra të arrij në shkallën *ihsan*¹⁴.

Ihsan është gjendja kur zemra posedon një vetëdije dhe ndjeshmëri sikur ta shihte Allahun Teala. Kjo gjendje është qëllim i secilit besimtar. Resulallahus.a.v.s.na mëson që feja përbëhet prej imanit, islamit dhe ihsanit.

Feja fillonme iman, piqetme ibadet dhe arrinnë përsosmërimet ihsan.

¹⁴**Ihsan:** - ata të cilët i bëjnë ibadet Allahut Teala sikur ta shihnin Atë. 'Më trego ç'është ihsani?' (Përgjigjimi) tha: 'Ta adhurosh Allahun sikur e sheh Atë, sepse edhe pse ti nuk e sheh Atë, Ai vërtet të sheh ty'.

Buhari, Iman, 37; Muslim, Iman, 1; Ebu Davud, Sunnet, 16; Tirmidhi, Iman, 4; Ibnu Maxhe, Mukaddime, 9.

Në tasavvuf, arritja e gjendjes së përsosur të zemrës realizohet në tri faza. Faza e parë është pastrimi prej ndyrësiraveshpirtërore, faza e dytë është zbukurimi me moral (ahlak) të bukur, dhe faza e tretë është prania në prezencë hyjnore dhe miqësia e veçantë me Allahun Teala.

Pas kësaj vjen grada (makam) *huzur*. Arifët e përshkruajnë këtë gjendje si '*kurbijet'* dhe në kuptimin e vërtetë, fjalën 'sufi' e përdorin për njeriun e përsosur (insan-i kamil) që ka përfituar këtë cilësi.¹⁵

Siç e përmendëm më lartë, pastrimi i zemrës dhe edukimi i nefsit është qëllimi i përbashkët i të gjithë besimtarëve. Nuk ka asnjë mosmarrëveshje sa i përket këtij qëllimi. Temë e mosmarrëveshjes është mënyra se si të përfitohet kjo gjendje.

Muhammedi s.a.v.s., deri sa ishte në këtë botë, vet ai ishte në qendër të kësaj pune. Pastërtia shpirtërore dhe edukimi realizohej nën mbikëqyrjen e tij. Pas tij, është punuar me metoda të ndryshme që të realizohet kjo detyrë.

Pas epokës së lumturisë (kur Resulallahu s.a.v.s. ishte në këtë botë) sëmundjet e zemrës u shumuan dhe u përhapën. Kështu, pa ndonjë hulumtim se a është diçka e drejtë apo jo, në jetën fetare mbizotëroi imitimi. Udhëheqja shtetërore nuk mund t'i gjente zgjidhje prapambetjes shpirtërore që mbizotëroi.

¹⁵ Suhreverdi, Avarifu'l-Mearif, 18.

Me gjithë përpjekjet me synim të mirë, fakihët nuk mundën të ndalin këtë prapambetje, dhe vetëm shikonin me keqardhje.

Muhadithët(dijetarët e haditheve), pos shpjegimit të rrezikut nga kjo zbrazëti shpirtërore, nuk mundën të bëjnë më shumë.

Vërejtjet e komentuesve të Kur'anit(mufesir) nuk mundën të ndalin njerëzit,që ishin drejtuar kah ambiciet e kësaj bote.

Ndërkohë, bashkë me shekullin II Hixhri filloi një lëvizje e ringjalljes për jetën fetare e cila kishte filluar të fikej. Në ballë të kësaj lëvizje ishin evlijatë e mëdhenj. Kjo lëvizje do të bëhet më vonë një disiplinë,dhe do të përbëjë themelin e edukimit të tasavvufit. Udhërrëfimin e kësaj lëvizjeje kanë bërë Hasan el-Basri, Maruf el-Kerhi, Malik b. Dinar, Dhunnun el-Misri, Syfjan es-Sevri, Haris el-Mahasibi, Xhunejd el-Bagdadi.

Ata filluan me këshilla (vaz), biseda fetare(sohbet) dhe duke u bërë shembull për njerëzit me qëndrimet e tyre,e njerëzit përqafuan këto.

Në shekullin VI Hixhri,brenda kësaj lëvizjeje formua disiplina e tarikatit bashkë me metodat e veta të edukimit, që mori një formë të redhe u përhap në gjithë botën islame.

Këto tarikate (rrugë të edukimit), që njihen me emrat e themeluesve të vet, si Kadirijje, Rufaijje, Kubrevijje, Shazelijje, Nakshibendijje, Mevlevijje, Bajramijje... kanë bërë hizmet (shërbim) të madh në botën islame.

Ne, të gjitha rrymave që formuan sistemin e edukimit, mund t'iu themi 'Tasavvuf'.

Pikëpamje e përbashkët e themeluesve të këtij sistemi është:

*"Përveç ndjekjes së sunnetit të Muhammedit s.a.v.s., nuk ka mënyrë tjetër që çon në rrugë të drejtë. Nëse dikush, në të gjitha gjendjet që është dhe në punët që bën, nuk i përshtatet Kur'anit dhe sunnetit, nuk e njohim si mik të Allahut."*¹⁶

Ky është kuptimi që na vjen ndër mend, kur thuhet tasavvuf. Ai që e ruan këtë kriter dhe edukatë është vërtetë besimtar, është vërtetë sufi. Zaten, tasavvufi është një edukim i nevojshëm për secilin besimtar.

Imam Gazali rah.konstaton se hyrja në një edukim të këtillë për të përmirësuar nefs (egon) është obligim i detyrueshëm (farz-i ajn) për secilin; sepse, përveç peygamberëve, askush nuk është larg nga sëmundjet shpirtërore të zemrës, dhe prej tyre vetë nuk mund të shpëtojë.¹⁷

¹⁶ Ebu Nuajm, Hiljety'l-Evlija, X, 257; Sylemi, Tabakatu's Sufijje, 159; Kusheri, Risale I, 107; Suhreverdi, Avarify'l-mearif, 55.

¹⁷ Ibnu Axhibe, Ikazu'l-Himem, 21.

Shejhu i madh Ebu'l-Hasan esh-Shazeli thotë:

“Ai që nuk merr dituri dhe edukim shpirtëror, vdes e shkon duke bërë shumë gjynahe të mëdha, epa e dalluar fare.”¹⁸

Ibnu Alan es-Siddiku rah., sqaron se këto janë gjynahetë fshehta, që nuk dallohen, si kryelartësia, mendjemadhësia, lavdërimi me ibadetet, mospëlqimi i njerëzve, etj.¹⁹

¹⁸ Ibnu Axhibe, Ikazu'l-Himem, 21.

¹⁹ Abdulkadir Isa, Hakaik ani't-Tasavvuf, 35.

SI E PËRMEND KUR'ANI SUFIZMIN?

Disa, për çdo çështje pyesin se a e përmend Kur'ani dhe sunneti. Dhe çdo gjë që nuk e përmend Kur'ani dhe sunneti e llogarisin jashtë fesë. Ky është një gabim serioz.

Ata që kritikojnë tasavvufin, pa ia studiuar mirë kuptimin dhe përmbajtjen, në radhë të parë bëjnë këtë pyetje:

“Fjalët si sufi, shejh, tasavvuf - a përmenden në Kur'an dhe në sunnet? Në qoftë se përmenden tregoni. Në qoftë se nuk përmenden, pse përdoren? Nëse nuk përmenden, a është e drejtë të përmenden ato si koncepte që i përkasin fesë?”

Pikësëpari, të rikujtojmë këtë:

Kushdo që posedon pak dituri fetare, e di që Kur'ani Kerim nuk është fjalor ose enciklopedi për të gjithë emrat dhe termet që i përdorim në jetën tonë.

Është e ditur që Kur'ani është një libër i vërtetë(hakikat) dhe udhëzues. Në Kur'an emrat e njerëzve të mirë(salih²⁰) nuk tregohen,por tregohen cilësitë.

²⁰**Salih:** [prej Salah]: i devotshëm; i hajrit; i mirë; është si duhet të jetë; ai që posedon drejtësi dhe veprime të drejta; ai që i zbaton

Për ata që mund ta çelin zemrën dhe i besojnë Kur'anit, në çdo shkronjë gjendet një dituri dhe edeb²¹. Dituritë dhe edebin në Kur'an i marrin vetëm miqtë e Allahut Teala.

Për besimtarët, Kur'ani është burim i shërimit. Në Kur'an, është shpjeguar morali i bukur, dhe besimtarët ftohen në të. Në veçanti, secili duhet të largohet nga cilësitë dhe morali i keq që përmenden aty.

Kur'ani është libër me të cilin i bëhet ibadet Allahut Teala.

Sunneti është mënyrë e zbatimit dhe jetësimit të Kur'anit nga Muhammedi s.a.v.s. në jetën e kësaj bote.

Allahu Teala e ka bërë Kur'anin amanet në sipërfaqen e tokës, ai është peshore precize për çdo gjë; ndërsa sunneti është gjuha e Kur'anit, treguesi i Kur'anit. Kur'ani dhe sunneti janë peshore -matëse të vlerave, çdo vepër dhe çështje matet dhe vlerësohet me to.

Në këtë rast, neve nuk na intereson se a mban personi titullin Shejh apo Murshid, por na intereson të shohim se a posedon titulli që mban personi cilësitë që janë cekur në Kur'an dhe sunnet, dhe të shohim vlerësimet që jep Kur'ani dhe sunneti.

urdhërat e fesë; njeri i çmuar dhe i nderuar; me virtyt; me dinjitet; ai që është i ndershëm dhe bëmiris.

²¹**Edeb:** edukim; mësim; edukatë; mirësjellje; edukat dhe mirësjellje; morali i bukur.

Tani t'i japim përgjigje pyetjes:

E saktë, fjalët 'sufi' dhe 'tasavvuf' nuk përmenden në Kur'an dhe sunnet, por të gjitha dituritë, gjendjet dhe morali i bukur që posedojnë sufite e vërtetë, ose përmenden haptas në Kur'an dhe sunnet, ose jepen shenja që ato janë të drejta. Në të njëjtën kohë, të gjitha këto bëhen urdhër, stimulim ose rekomandim për secilin besimtar, varësisht nga gjendja e secilit.

Shkurtimisht, ana e brendshme e sufiut është e zbukuruar me dashuri hyjnore, e ana e jashtme me moral të bukur.

Tasavvuf është marrja e edukimit nën udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e një murshid-i kamil. Fundi i këtij edukimi është të bërit njeri i përsosur (insan-i kamil). Njeriut të përsosur i thuhet '*rixhalullah*', që ka kuptimin - mik i Allahut, njeri i të vërtetës (hakikat).

Tasavvufi e largon zemrën nga gjërat kalimtare dhe e lidh atë për shariat.

Tasavvufi, atë që është i dashuruar pas kësaj bote kthen dhe bën mik të Allahut.

Tasavvuf është njohja e esencës së vetes, tejkalimi i pengimeve dhe përmirësimi i vetes, ëmbëlsimi me dashuri hyjnore, çlirimi i zemrës, mbushja e zemrës me nur, gjetja e qetësisë shpirtërore.

Për të kuptuar se çka është tasavvufidhe për të dhënë gjykim në këtë temë, së pari nevojitet të hulumtohet mirë Kur’ani dhe sunneti, e më pas nevojitet të njihen edhe themeluesit e tasavvufit.

Në veprat e këtyre murshidëve(shehlerëve)është treguar mjaftueshëm se çka është tasavvufi, në çka mbështetet ai dhe çka është qëllimi i tij. Më e rëndësishmja ndër to është hyrja në edukim shpirtëror, nën mbikëqyrjen e një murshidi kamil. Pa këtë, tasavvufi vetëm përshkruhet me fjalë, por nuk kuptohet në të vërtetë.

Atyre që pyesin *“Çka është puna jua?”*, të mëdhenjtë u japin këtë përgjigje:

“Eja, hyn, shiko, shijo, kupto!”

Nëse veprohet kështu, shpëtohet nga imitimi dhe arrihet te e vërteta. Tasavvufi nuk është përcjellja e fjalëve të të tjerëve, por kuptimi ivetvetes. Tasavvufi vjen nga dëshira, dhe bëhet mënyrë e jetës.

Jo, të mos thuhet që në këtë kohë nuk ka murshidi kamil (shejh), dhe se të gjindetnjë i tillë është e pamundur. Duhet të dihet e vërteta se:

Deri në ditën e kiametit, nuk do të mungojë asnjëherë një shoqëri përbrenda ummetit,e cila do të mbajë në këmbë dhe do të përhapë urdhrat e Allahut Teala dhe moralin e bukur e të ndershëm të islamit.

Edhe nëse bashkërisht nuk i dilet zot këtij amaneti, disa të dashuruar të kësaj pune, me ndihmë dhe përkrahje hyjnore, kanë për ta realizuar atë detyrë me sukses. Feja shijohet dhe përhapet duke u jetuar. Allahu Teala e ka marrë në mbrojtje të veçantë këtë fe. Islami do të përfaqësohet ngatë dashurit e Allahut (evliatë) në secilën epokë dhe shoqëri. Këtë e tregon Resulallahu s.a.v.s.:

“Një grup nga ummeti im do të vazhdojë të mbajë në këmbë urdhrat e Allahut, deri në ditën e kiametit. Ata nuk do të dëmtohen nga njerëzit që braktisin (këto urdhra) dhe që kundërshtojnë. Kjo do të vazhdojë deri kur të vjenurdhri i kiametit. Ata gjithmonë do të dalin fitimtarë mbi njerëzit.”²²

“Prej ummetit tim, në çdo epokë gjinden sabikun (ata që udhëheqin në mirësi).”²³

“Pa dyshim se Allahu Teala për këtë ummet në fillim të çdo shekulli dërgon dikë që rigjallëron fenë (pastron zemrat prej përçarjes dhe gafletit, pastron gjendjet prej bidateve dhe kryengritjes, udhëzon njerëzit në rrugë të drejtë).”²⁴

²² Buhari, I'tisam, 10; Muslim, Imaret, 53; Tirmidhi, Fiten, 27; Ibnu Maxhe, Mukaddime, 9; Ahmed, Musned, V, 34; 268, 278,

²³ Ebu Nuajm, Hiljety'l-Evlija, I, 7; Sujuti, el-Xhamiu's-Sagir, Nr: 7327; Elbani, Sahiha, Nr: 2001.

²⁴ Ebu Davud, Mëalahim, 1, Hakim, Mustedrek, IV, 523.

Ebu Nasr es-Serrexh, lidhur me këtë temë bën këtë konstatim të bukur:

“Në secilën kohë dhe epokë gjinden njerëz që posedojnë cilësi për të cilat Allahu Teala dhe Resulallahu s.a.v.s., kanë cekur se i takojnë besimtarëve. E si mund të mos gjinden njerëz të tillë, kur këtë e cekë vet Kur’ani dhe sunneti? Kjo vlen edhe për gjendjet dhe cilësitë e cekura për evliatë.”²⁵

Është gabim të jepet gjykim rreth diçkaje për të cilën nuk kemi dituri të saktë dhe të drejtë. Duhet pasur shumë kujdes rreth gjykimeve negative, e posaqërisht kur është në pyetje njeriu i përsosur (insan-i kamil), që është përfaqësues (halife) i Allahut Teala dhe trashëgimtar i Resulullahut s.a.v.s.

Rreth kësaj teme, njëri nga të mëdhenjtë, Shejh Huxhviri thotë:

“Në qoftë se mohuesit thonë se fjalët tasavvuf dhe sufi nuk gjinden në Kur’an, kjo është e drejtë. Por nëse ata mohojnë kuptimin dhe moralin e bukur që përmban tasavvufi, ata mohojnë tërë fenë dhe moralin e bukur që solli Resulallahu s.a.v.s..”²⁶

²⁵ Serraxh, el-luma; 34-35.

²⁶ Huxhviri, Keshfu’l-Mahxhub, 54.

Huxhviri gjithashtut hotë:

*"Padyshim se atyre që janë evlia dhe që kanë arritur në shkallë të larta të velajetit, iu thuhet 'sufi'. Fjala 'sufi' nuk paraqitet nga rregullat e asnjë gjuhe; sepse, fjala 'sufi' ka një kuptim shumë më të gjerë dhe të lartë. Kuptimi i saj nuk tregohet me fjalë, por kuptohet duke u jetuar."*²⁷

Imam Kushejri, ka dashur t'i japë fund diskutimeve në këtë temë me konstatimin:

*"Është e panevojshme të mundohemi për të gjetur rrënjën dhe mënyrën se si u paraqit fjala 'sufi' dhe 'tasavvuf'. Këto emërtime i janë dhënë shoqërisë së famshme të evliave."*²⁸

SUFI ËSHTË EMËR TJETËR PËR BESIMTARINË DEVOTSHËM

Gjatë historisë, në disa rajone, për vite të tëra njerëzit ishin kundër termit 'sufi', dhe kjo fjalë u diskutua panevojshëm. Në esencë, personaliteti që tregohet me fjalën 'sufi' është personi që në Kur'an lavdërohet si personi i devotshëm 'myttaki'.

²⁷ Huxhviri, a.g.e. 53-54.

²⁸ Kushejri, Risale, II, 550.

Në edukimin e tasavvufit, emri *sufi* i jepet personit të cilit i kompletohet edukimi shpirtëror nga shejhu (murshidi), dhe i cili mbërrin në devotshmëri të vërtetë. Grupet tjera islame, të njëjtin person e prezantojnë me emërtimin '*myttaki*'. Është krejt e natyrshme që një person, në mjedise të ndryshme të prezantohet me emra të ndryshëm; kjo nuk guxon të bëhet arsye për ngatërresë.

Personave që kanë cilësitë njëjta por detyra të ndryshme, mund t'i jepen emërtime të ndryshme. Në fushën e secilës dituri ose shkencë, me qëllim që të shprehëveçanti e asaj fushe përdoren emërtime të ndryshme. Ata që janë specialistë në atë fushë, përmenden me emra të ndryshëm varësisht nga gradat që kanë. Kjo nuk është në kundërshtim me fenë. Aq më shumë, kjo është më se e nevojshme.

Tasavvufi udhëzon në dituritë dhe zbatimin e moralit të fesë. Kjo është dituri në vete, njëjtësi fikhu dhe kelami. Me këtë dituri, zemra arrin gjendje të caktuara, dhe vepron sipas tyre. Tasavvufi është pjesë përbërëse e fesë.

Tema e kësaj diturie është njeriu. Qëllimi i saj është të edukojë njeriun me moral hyjnor. Përfundimi është ngritja e njeriut në gradëne njeriut të përsosur (insan-i kamil). Ka njerëztë devotshëm që kanë arritur majat e kësaj diturie. Atyre, në bazë të cilësive që kanë arritur, gradave që përfaqësojnë dhe

detyrave që bëjnë, u janë dhënë emra të ndryshëm, si: veli,murshid,shejh,gavs, dhekutub.Secili nga këta emra është një cilësi, dhe tregon veprimet e personit.Këta emra dhe tituj, edhe nëse nuk gjinden në Kur'an dhe sunnet, nuk janë kundër tyre.

ImamSuhreverdi kështu e sqaron se kush është në të vërtetë sufidhe si përmendet sufiu në Kur'an:

“Në Kur'an-i Kerim nuk ka emër ‘sufi’ por në vend të tij përdoret fjala ‘mukarrebun’.”²⁹

Sufi të vërtetë janë ata që posedojnë këto cilësi. Nuk ka nevojë të debatohet mbi fjalët. Prandaj,kur themi *sufi*, me këtë nënkuptojmë veliun (evlia) që ka mbërritur gradën mukarrebun.

Qoftë në libra të shkruara me dorë,qoftë në vepra të tjera,sufitë më të mëdhenj dhe imamët e kësaj rruge të edukimitpërkruhen si persona që posedojnë cilësinë mukarrebun.³⁰

Allahu Teala në Kur'an-i Hakim,i ndanë të gjithë njerëzit në tri grupe:

1. As'hab-i Mejmene – besimtarët, ata që librin e veprave do ta marrin nga ana e djathtë dhe si përfundim do të hynë në xhenet.

²⁹ 56- Vakia: 7-11.

³⁰ Suhreverdi, Tasavvufi i Vërtetë, 16.

2. As'hab-i Mesh'eme - qafirët dhe munafikët, ky grup do ta marrin librin e veprave nga ana e majtë ose nga prapa, do të hyjnë në xhehenem.
3. Sabikûn –Mukarrebun - ata që janë të parët në mirësi dhe që kanë arritur afërsi hyjnore – njerëzit kamil(përkryer).³¹

Kur imamët e tasavvufit thonëevlia, arif, murshid,shejh,sufi, nënkuptojnë njeriun e përkryer (insan-i kamil) që hyn në grupin e tretë.Të gjithë personat që hyjnë në kategorinëmukarrebunjanë evliapor të gjithë ata nuk janë të angazhuar medetyrën e udhëzimit (irshad)³² shpirtëror.

Një pjesë e tyre, me cilësinë e trashëgimtarit të Resulallahut s.a.v.s. kanë detyrë të irshadit,ata zbatojnë punën e edukimit dhe pastrimit. Kjo është dhuratë nga Allahu Teala, që ia dhuron kujt dëshiron Ai.Irshadi shpirtëror do të vazhdojë deri në ditën e kiametit; sepse peygamberllëku i Resulallahut s.a.v.s. është duke vazhduar.Punën e tij për thirrjenë islam (davet),pastrimin e zemrave, edukimin e nefsit dhe mbushjen e zemrave me dashuri hyjnorejanë duke ezbatuar trashëgimtarët e Resulallahut s.a.v.s..

³¹ 56-Vakia: 7-10.

³²**Irshad:** ; udhëzues; udhëzim shpirtëror; të tregosh rrugën e vërtetë.

Besimtarët e përkryer (kamil) që janë ngarkuar me këtë detyrë janë sufite që kanë arritur cilësinë e devotshmërisë së imamllekut. Në Kur'an-i Hakim ata prezantohen me gradën *sabikun-mukarrebun*.

Cilësitë dhe moralin e bukur të besimtarëve që hyjnë në këtë gradë, mufesirët i kanë përmbledhur kështu:

1. Braktisin botën për hir të Allahut Teala.
2. Kanë më shumë mirësi se sa të meta.
3. Vetëm Allahut i mbështeten plotësisht, shpenzojnë gjithë kohën e tyre në zbatimin e urdhrave të Allahut Teala.
4. Ahireti paraqet të gjitha mendimet dhe dertet e tyre.
5. Me shefatin e tyre bëhen shkak për shpëtimin e të tjerëve.
6. Vazhdimisht kërkojnë kënaqësinë (rizanë) dhe dashurinë e Allahut Teala.
7. Largohen prej gjynaheve, si të mëdha ashtuedhe të vogla.
8. Në namaz e në xhihad, vrapojnë para të gjithëve.
9. Janë të zënë me modestinë e tyre, nuk merren me të metat e të tjerëve.
10. Ata hyjnë në xhenet pa llogari, ashtu siç kanë dhënë myzhde ajetet dhe hadithet.³³

³³ Ajetet 35-Fatir: 32-33; 56- Vakia: 12, 88, 89; 82-Infitar: 13; 83-Mutaffiffin: 28; Në lidhje me këtë çështje, në një hadith, Resulullahu

11. Librin e vepravee marrin nga ana e djathtë.³⁴
12. Frikësohen tepër prej Allahut Teala. Janë dijetarë (alim) të vërtetë.
13. Të brendshmen e kanë më të bukur se të jashtmen.
14. Me gjuhë shqiptojnë njëshmërinë e Allahut Teala, me pjesë të trupit i përshtaten urdhrave që janë dhënë, kanë zemër të sinqertë dhe të pastër, në ibadete dhe vepra qëllim kanë vetëm kënaqësinë e Allahut Teala - për shkak se ashtu ka urdhëruar Ai.
15. Kur lexojnë Kur'anin, e kuptojnë se si duhet vepruar, dhe e bëjnë atë.³⁵
16. Ata janë *muxhahidë*³⁶, dhe vazhdimisht bëjnë hizmet.³⁷

(s.a.v.s.), pasi që lexoi ajetin: “Pastaj Ne u lamë në trashëgim librin robërve Tanë që Ne i kemi zgjedhur; e prej tyre ka që janë dëmtues të vetvetes, ka që janë mesatarë, e ka prej tyre që janë, me ndihmën e Allahut, të parë në punë të mira, e kjo është ajo mirësia e madhe.” (Kur'an, Surja Fatir 35:32), tha: “Kush është i pari në punë të mira prej ummetit tim, në xhenet hyn pa llogari. Ata që janë në gjendje të mesme, japin një llogari të lehtë. Kurse ata që vetes i kanë bërë zullum, do të vuajnë aq sa kanë bërë gjynahe, e më pas do të hyjnë në xhenet.”

Shiko: Ahmed, Musned, V, 194, VI, 444; Hakim, Mustedrek, II, 426; Taberi, Xhamiu'l-Bejan, Xhuz:22, faqe:237; Begavi, Mealimu't-Tenzil, VI, 421; Tabarani, el-Mu'xhemu'l-Kebir, XVIII, 79-80.

³⁴ Për shpjegimet deri këtu shih: Semarkandi, Bahru'l-Ulum, III, 86-87

³⁵ Shk. Begavi, Mealimu'l-Tenzil, VI, 423.

³⁶ “Ata që luftojnë për çështjen Tonë, sigurisht, Ne do t'i udhëzojmë drejt udhëve Tona. Vërtet, Allahu është me punëmirët!” 29-Ankebut”69.

17. Janëngritur në gradën *illijun*.³⁸
18. Dëshirat e veta i kanë humbur në dëshirat e Hakut.
19. Hyjnë në xhami para të gjithëve, dhe dalin të fundit.³⁹
20. Kur u jepet ajo që ju takon – e pranojnë, kur kërkohet prej tyre – japin me bollëk, kur u japin urdhër njerëzve – sillen sikur t’i japin urdhër vetes.⁴⁰
21. Allahun nuk e harrojnë asnjëherë, janë vazhdimisht në gjendje të dhikrit.⁴¹
22. Posedojnë gjendjet e larta shpirtërore.
23. Marrin mësim nga fatkeqësitë.
24. Kur nuk iu jepet malli i botës – falënderojnë, e kur iu kalon një send nëpër dorë – ua japin të tjerëve.
25. Me Rabbin e tyre, janë bërë të pavarur nga gjithçka.⁴²

³⁷ Ibnu’l-Xhevzi, Zadu’l-Mesir, VIII, 133. Është fjalë e Hz.Osmanit.

³⁸ Shk.Tefsir, Ibnu Kesir,VII, 490-491.

³⁹ Sujuti, ed-Durru’l-Mensur, VIII,6-7. Sujuti për këtë pikëpamje i përshtatet transmetimit të një hadithi nga Ebu Nuajm dhe Bejhakui.

⁴⁰ Kurtubi transmeton këtë pikëpamje duke e marrë nga një hadith. Shk.el-Xhami, XVII, 199.

⁴¹ Kurtubi transmeton nga Zunnun el- Misri.

⁴² Kurtubi, a.g.e, XIV, 348-349.

Imam Kushejri kështu na njofton me miqtë e Allahut Teala:

“Ata, kanë arritur gradën bekabil-lah, kanë shkëputur interesimin me zemër nga të gjitha krijesat përpos Allahut, shpirtin ia kanë bërë kurban Allahut Teala, kanë arritur në gradënhaka’l-jekîn, kanë braktisur të gjitha gjërat bosh dhe të panevojshme, kanë përfituar moral të bukur, kanë arritur gradën mushahede(soditje shpirtërore).”⁴³

Personiqë ka këtë edukatë morale është mik i Allahut Teala. Atë, myfesirët e quajnë myttaki, fakihët-dijetar, muhadithët e quajnë salih, mutesavvifët- sufi, e populli e quan evlia; vetëm emri i ndryshon, por jo edhe rezultati.

⁴³ Kushejri, Latafu’l-Isharat, III, 204-206.

ÇDO SALIK NUK QUHET SUFI

Salik do të thotë dikush që ka hyrë në rrugëtëHakut dhe që edukohet nga një shejh (murshid). Dikujt që hyn në rrugën e edukimit shpirtëror, në tasavvuf i jepen emra si salik,sufi,dervish,murid.Këta emra përdoren në përgjithësi për çdo besimtar.Por emrat si sufi,murshid,shejh, duhet të përdoren për udhëzuesit që kanë kompletuar edukimin e tyre shpirtëror.

Sepse morali i bukur që u shpjegua më lartë nuk gjendet tek çdo kush që hyn në rrugën e tasavvufit, dhe nuk është i lehtë të gjendet. Për t'u përfituar ai moral, është e domosdoshme përkrahje e veçantë e Allahut Tealasi dhe njëpërpjekje dhe mundim i madh. Besimtarët e vërtetë që në Kur'ani Hakim shpjegohen me cilësi si mukarrebun, mutakki, muhsin, muhlis, evlia,ebrar,salih, etj. në tasavvuf shkurtimisht u është dhënë emri sufi.

Udhëtarët shpirtërorë, në përgjithësi ndahen në tri grupe:

1. Sufi;
2. Mutesavvif;

3. Mubtedi-muteshebbih⁴⁴

Ata që hyjnë në tasavvufme qëllim që të edukohen shpirtërisht, i quajmë sufi (në disa raste – sofi), por këto janë emërtime metaforike, e jo kuptim i esencës; sepse u cek edhe më lartë që sufi nuk është emër për ata që janë në fillim të edukatës, por është emër që iu jepet muslimanëve të devotshëm që janë në fund të kësaj rruge, e që në Kur’ani Hakimpëmdenme cilësinë mutaki.

Kështu prezantohen udhëtarët e vërtetë, varësisht gradës që ata marrin në edukim.⁴⁵

Personit që bën teube, që hyn në edukim shpitrëror me dashuri dhe dëshirë, që punon aq sa ka forcë për të përfituar nga gjendjet e shejhut, por ende nuk posedon cilësitë dhe moralin e bukur, i thuhet *mutesavvif*. Atij që është në këtë gjendje nuk i thuhet sufi. Me plot kuptimin e fjalës, emri sufi i jepet shejhut që ka përjetuar prani në prezencën hyjnore dhe që posedon gjendjet e evliave.

Pos këtyre dy gjendjeve, dikujt që u përngjanë nga jashtë, por nuk është në gjendje si ata, u thuhet vetëm *muteshebbihose* ‘*muridi që është në fillim*’; kështu quhet fillestari që sa ka hyrë në rrugën e sufive.

⁴⁴ Huxhviri, Keshfu’l-Mahxhub, 44; Suhreverdi, Tasavvufi i vërtetë, 16.

⁴⁵ Suhreverdi, Tasavvufi i vërtetë, 16.

Një murid i ri, edhe nësenga jashtë është si sufite dhe mundohet t'u përngjajë atyre, që beson në gjendjet e bukura të tyre dhe me vullnet dëshiron të bëhet si ta, për shkak të zemrës së fortë, nefsit të shfrenuadhe fuqisë së pamjaftueshme, mbetet mbrapa tyre. Përkundër kësaj, për hatër të asaj që brenda ka besimin dhe dashurinë, merr pjesë në mesin e miqve të Allahut Teala dhe do të njihet prej tyre. Për dikë që është në këtë gjendje arrin myzhden e hadithit:

“Kush i përngjanë një populli, njihet prej atij.”⁴⁶

Dashuria e sinqertë e bashkon një person me atë që do. Ky person, edhe pse nuk është me vlera të njëjta, në grada po aq të larta dhe me cilësi të ngjashme me evliatë, vetëm për shkak të dëshirës së mirë dhe sinqeritetit, duke zgjedhur nga mijëra grupe të njerëzve grupin e miqve të Allahut Teala, takohet me bereqetet e tyre.

Disa nga të mëdhenjtë e tasavvufit, edhe shehlerëve u japin emrin mutesavvif, dhe këtë shprehje përdorin në vend të termit ‘sufi’.

Ky emër, si dhe titujt, mund të ndryshohen, varësisht nga regjionet dhe kulturat ku njerëzit jetojnë. Kjo nuk është e dëmshme. Emrat që përhapen mes njerëzve në sipërfaqen e tokës nuk janë me rëndësi. Me

⁴⁶ Ebu Davud, Libas, 4; Ahmed Musned, II, 50.

rëndësi janë cilësitë që përmenden tek Allahu Teala, mes melaikëve në qiej.

Në sipërfaqen e tokëska miq të tillë të Allahut Teala, që në pamje të jashtme janë të varfër, të çuditshëm, në dukje të pa vlerë, të tillë që askush nuk i respekton, fjalët e tyre nuk merren parasysh, ndoshta as selam nuk u jepet. Por, te ata ka një zemër dhe edukim të tillë që, Allahu Teala ipranon lutjet e tyre. Melaiket i vizitojnë ata, iu japin selame, ju shfaqin nderim.

Për këtë arsye, çdo njeri duhet të shihet si një thesar i fshehur, dhe nuk bën të mashtrohemi duke ia parë rrobat (të jashtmen). Edhe për njeriun të cilit nuk i jepet aspak respekt duhet të mendohet se është e mundur që ai të jetë njëri nga miqtë e Allahut Teala. Para secilit duhet të sillemi me edukim, të tregojmë modesti.

Askush nuk ka pësuar dëm nga edukimi. Miqtë e Allahut Teala sillen me mëshirë dhe edukim edhe ndaj kafshëve; sepse gjithçka është pronë dhe mjeshtri e Allahut Teala. Nuk është gjendur njeri të jetë rehatuar dhe të ketë gjetur nder me mendjemadhësi dhe imoralitet.

SHKALLA E PARË E SUFIUT - IMANI DHE DASHURIA

Në rrugën e Allahut Teala, pasuria më e madhe është imani (besimi) dhe dashuria. Nuk mund të ketë dashuri për diçka në të cilën nuk besohet; ai që nuk dashuron nuk mund t'i bëjë hizmet të dashurit. Kjo rrugë, fillon me dashuri e vazhdon me durim (sabër). Kjo rrugë nuk nis pa sabër. Qëllimi nuk arrihet nëse nuk përcillet metodologjia (usul).

Ai qëi do evliatë arrin mrekullitë (kerametet) e dashurisë. Ai që bën sabër bashkë me miqtë e Allahut Teala, nëse gjendet në të njëjtën rrugë dhe tubim me ta, arrin këtë myzhde të Resulallahut s.a.v.s.:

“Vërtetë, Allahu Teala i ka melaiket që udhëtojnë gjithnjë dhe kërkojnë ithtarë të dhikrit, e kur gjejnë njerëzit që e përmendin Allahun Teala, melaiket thërrasin: ‘Ejani kah nevojat tuaja!’, e pastaj i rrethojnë me krahët e tyre deri në qiellin ekësaj bote, kurse Krijuesi i tyre, edhe pse e di më mirë se ata, i pyet:

‘Ç’poflasin robërit e Mi?’ Melaiket thonë:

‘Po të lavdërojnë (tesbih) Ty, po të madhërojnë (tekbir) Ty, po të falënderojnë (tahmid) Ty, dhe po të lartësojnë (temxhid) Ty’. Allahu u thotë:

‘A më kanë parë robërit e Mi?’ Melaiket thonë:

‘Jo, për Allahun, ata nuk të kanë parë!’ Allahu pyet:

‘Çfarë do të bënin, sikur të më shihnin?’

Melaiket thonë:

‘Sikur të të shihnin,ata edhe më tepër do të të adhuronin, do të të falënderonin dhe dotë të lavdëronin’. Allahu thotë:

‘A po kërkojnë diçrobërit e Mi?’Melaiket thonë:

‘Po të lusin për xhenet’.” Allahuthotë:

‘A e kanë parë atë?’ Melaiket thonë:

‘Jo, për Allahun, oKrijues, nuk e kanë parë xhenetin’. Allahu atëherë u thotë:

‘E si do tëluteshin për xhenetin, sikur ta shihnin atë?’ Melaiket thonë:

‘Sikur tashihnin xhennetin, ata edhe më shumë do të lakmonin për të, edhe mëshumë do të kërkonin, e edhe më shumë do ta dëshironin’. Atëherë Allahui pyetata:

‘Nga kush ata kërkojnë mbrojtje dhe strehim?’ Melaiket thonë:

‘Ata kërkojnë mbrojtje nga zjarri’. Allahu thotë:

‘A e kanë parëata zjarrin?’Melaiket thonë:

‘Jo, për Allahun, nuk e kanë parë!’ Allahuthotë:

‘E si do të kërkonin ata mbrojtjen nga zjarri sikur ta shihnin atë?’Melaiket thonë:

‘Sikur ta shihnin zjarrin, ata edhe më shumë do të ikninnga ai, e edhe më shumë do të frikësoheshin nga ai’. Allahu iMadhëruar thotë:

***‘Bëhuni dëshmitarë që po ua fali atyre’.**Një prej melaikeve thotë:*

‘O Krijues, në mesin e tyreështë një që nuk është prej tyre, ai ka ardhur në mesin e tyre për shkaqepivate të tij’.Allahu Teala urdhëron:

*'I tillë është ky grup që, kushdo të jetë ulur me ta –nuk privohet nga rahmeti.'*⁴⁷

Shiko këtë bukuri të miqve të Allahut Teala! Dikush që ulet me ta dhe bën sabër që të gjendet në të njëjtin tubim me ta, edhe nëse aty është për ndonjë punëtë tij, ai merr nga mëshira hyjnore që bie mbi ta dhe pastrohet nga gjynahet. Dikush që iu bashkëngjitet atyre në tubim vetëm për rizanë e Allahut Teala, duhet të mendojë për përfitimet hyjnore dhe rahmetin që dhurohet aty.

Pra, të mendojmë dhe t'i afrohemi asaj sofër të rahmetit. Për të arritur rahmetin e premtuar me hadith, ata që i afrohen këtij tubimi dhe ata që gjinden në aso tubime, nuk bën të jenë mohues, dhe aty nuk duhet bërë as edhe një hap me dyfytirësi. Veçanërisht, duhet të hyjmë me nijet të mirë në tubimet e diturisë dhe dhikrit, të njihet vetja si nevojtar për rahmetin hyjnor, të çelet zemra - kërkimi dhe lutja vijnë nga zemra. Dikush që hyn në tubimin e miqve të Allahut Teala me besim, me dashuri dheme edukim dhe nëse bën atë që i takon për aq sa ka fuqi, për gjërat që fuqia nuk i mjafton arsyetohet dhe inshaallah arrin myzhden e këtij hadithi.

Tregon Ebu Dher r.a.: *Kur e pyeta Resulallahun s.a.v.s.:*

⁴⁷ Buhari, Deavat, 67; Muslim, Dhikir, 35; (transmetim i ngjashëm)

“O Resulallah! Një njeri e do një shoqëri, por nuk ka fuqi të veprojë si ta, si është gjendja e tij? Resulallahu s.a.v.s. tha:

“O Ebu Dher! Ti do të jesh bashkë me ata që i do.”

Unë thashë:

“Padyshim unë Allahun dhe Resulin e Tij i dua.”

Resulallahu s.a.v.s.,tha:

“Padyshim se ti je bashkë me ata që i do.”

Ubade b.Sabit ka thënë seduke vazhduar Ebu Dher me këso lloj pyetjesh, edhe Resulallahu s.a.v.s. ofronte përgjigje të njëjta.⁴⁸

Imam Suhreverdi thotë:

“Në rrugën e sufive shkalla e parë është besimi (iman),e dyta dituria,dhe e treta është arritja e shijes së imanit dhe diturisë me vepra.

‘Muteshebbih’ do të thotë ‘ai që fillon me imitim(taklit)’, dhe në këtë kuptim është në nivelin që posedon iman.Në rrugën e sufive, imaniështë një prej esencave.”

Duke dhënë shenjë drejt kësaj, Xhunejd el-Bagdadi rah. ka thënë:

⁴⁸ Buhari, Edeb, 95; Darimi, Rikak, 71.

“Imani, në rrugën tonë është velajet (evliallëk).”⁴⁹

Themeli i kësaj pune është dashuria dhe imani, çdo gjë realizohet duke u lidhur me dashurinë dhe imanin. Prej udhëheqësve të rrugës së Nakshibendive, Imam Rabbani e shpreh kështu vlerën e dashurisë:

“Të dashuruarit e evliave duhet të njihet si një prej mirësive (nimet) më të mëdhatë Allahut Teala. Kjo dashuri (muhabet) që kërkohet prej Allahut Teala, duhet të jetë eqëndrueshme. Për shkak të lidhjes së këtyre të mëdhenjve, edhe një gjë e vogël që lind, duhet të pranohet si shumë. Sepse ajo sigurisht nuk është e vogël.”⁵⁰

Natyrisht, ashtu si nevojitet imani dhe dashuria, në rrugën e evliave nevojitet edhe durim (sabër) dhe edukim shpirtëror (sejr-u suluk).

Edhe në këtë punë ka një grup që ka ngelë vetëm në fjalë dhe në dukje, qepërbëhet vetëm nga një thirrje e thatë. Një person, nëse vetëm me dukje të jashtme dhe me veshje iu përngjanë sufive, por nuk mundohet me aq sa ka fuqi për të përfituar nga gjendjet e tyre dhe edukimet e tasavvufit, që nuk i bën hapat e parë në këtë rrugë, nuk i përfundon detyrat fillestare, atëherë ai vet nuk është ende sufi.

⁴⁹ Suhreverdi, Tasavvufi i Vërtetë, 82.

⁵⁰ Imam Rabbani, Mektubat, letra 142.

Me këtë gjendje ai u përngjanë më shumë
muteshebbihëve që janë ende në fillim.

Lidhja e tij me këtë xhemat është vetëm në
veshje dhe në dukje. Kurse te sufitetë, së pari vjen
edukimi, e më pas veshja.

Shejh Ahmed b. er-Rufai rah., ata që merren
vetëm me formën e jashtme, kurseharrojnë ibadetin
dhe edukimin,i paralajmëron:

*“Nuk është e përshtatshme që muridi të bartë
veshjen që i takon sufive pa arritur në moral të bukur,
pa e përfunduar punën e edukimit dhe pastërtisë. Të
vishet ajo që i takon Pejgamberit dhe evliave, pa u
edukuar me moralin e tyre, është sikur të përqeshësh
ata.”⁵¹*

Megjithatë, nëse nuk veprohet diçka fshehurazi
për të njollosur këtë rrugë, atëherë ai person ka një dobi
nga një imitim i tillë. Kështu ai së paku nuk bëhet
mohues i evliasë, nuk përbuzë miqtë e Allahut, nuk
shikon me përqeshje dhikrin që bëhet. Edhe kjo mund
të bëhet shkak për teube dhe për të hyrë në rrugën e
edukimit.

⁵¹ Sha'rani, el-Envaru'l-Kudsijje, I, 132-133.

Të dashuruarit e Hakut i fshehin gjendjet e bukura. Ata nuk përdorin ndonjë veshje apo shenjë që i paraqet ata si të veçantë. Ata vishen, hanë e pinë njejtë si njerëzit të cilët ata jetojnë. Ata i japin rëndësi moralit të bukur. Me dhikër dhe meditim, ata arrijnë qetësi shpirtërore ku pastrojnë zemrat nga urrejtja, inati, mburrja, ambicia për botë, gafleti, tradhtia, dashuria ndaj gjërave që janë haram apo të dyshimta, dhe morali i keq.

Ata nuk lakmojnë njerëzit të cilët bëjnë dert gjërat e thjeshta, ditë e natë. Ata nuk frikësohen dhe ndikohen nga frikat e përgjithshme të njerëzve si varfëria, sëmundja, vetmia dhe pleqëria; sepse ata kanë njohur mirë poseduesin e gjithësisë -Allahun Teala, dhe Atij plotësisht i janë dorëzuar.

Nuk është me rëndësi nëse dikë njerëzit e quajnë evlia apo të çmendur. Në esencë, gjykimi i takon Allahut Teala. Nëse ai e do një njeri, edhe sikur tërë bota t'i bëhet armik atij, çka mund të bëhet? Gjithashtu, nëse Ai nuk e do një person, tërë bota po u bënë miq të tij – çfarë dobie sheh ai njeri nga këto miqësi?

Në fund, e që është vdekja e kësaj bote, nuk ka siguri dhe lumturi tjetër përpos të dorëzuarit Krijuesit Madhështor.

NUK BËHESH SUFI VETËM ME LIBËR

Askush nuk mund të bëhet zotëruesi i asnjë fushe apo profesioni të jetës, nëse dituria nuk merret nga zotëruesit e asaj fushe dhe nën mbikëqyrjen e tyre, si dhe nëse kjo dituri nuk nuk zbatohet.

Të pyetët furrtari për farmaci ose rrobaqepësi për mjekësi, është mundim i kotë dhe rënie në pozita qesharake.

Askush nuk mund të bëhet mjek i vërtetë vetëm me lexim të librave të mjekësisë, pa u bërë studimi dhe zbatimi i njohurive nën mbikëqyrjen e poseduesit të diturisë. Një person i tillë, as nuk mund të japë diagnozë të drejtë e as nuk mund të bëjë mjekim të mirë. Nëse ai merret me mjekim, mund të dëmtojë të sëmurin, dhe të bëjë veten të pandershëm. Kjo vlen për secilin profesion.

Duke qenë gjendja e tillë në punët e botës, as në punët e ahiretit gjendja nuk është ndryshe..

Dikush që nuk është shejh i vërtetë, duke menduar se është i tillë, bëhet lodër e shejtanit, duke u munduar të mbajë fenë – humb imantin.

Prandaj, nëse dikush dëshiron të bëhet sufi, ai duhet që për këtë të pyes ndonjë zotërues të kësaj rruge, sufizmin duhet tamësojë nga shkolla e sufive, nga një mësues sufi.

Nëse dikush vërtet me zemër, e jo me dukje, dëshiron të hyjë në rrugë të sufive, atëherë duhet patjetër të hyjë në edukimin e një murshid-i kamil (shejh).

Libri përshkruan të drejtën, e murshidi e prezanton. Libri i drejtohet mendjes, murshidi hyn në zemër. Libri jep vendim, murshidi edukim. Libri të thotë të bësh diçka, murshidi të shtyenta bësh atë. Murshidi ia zbaton muridit vendimet e librit.

Edukimi shpirtëror nuk bëhet vetëm me udhëzime, por me ndikim hyjnor. Ky ndikim është me një nur hyjnor, që i është dhënë shejhut. Me ndikim, zemrat e pavëmendshme (gafil) zgjohen, në zemër mbjellet dashuria hyjnore. Me këtëdashuri zemra zbutet, pendohet, qanëpër gabimet, e doibadetin dhevepron në përputhje me urdhrat e Kur'anit dhe sunnetit.

Shejhue merr zemrën nën vështirim, dhe pasi i di rrugët e shejtanit dhe dëshirat që hyjnë në zemër, sipas kësaj jep ilaçin. Ato i përkrahëme dua dhe zemrën e ushqen me dashuri. I tregon gabimet dhe plotëson mungesat. Bëhet shembull para muridit dhe i çel rrugën.

Një rrugë të gjatë dhe shumë të rrezikshme, a e kalon me siguri dhe arrin në qëllim ai që ka në dorë një hartë të rrugës, apo ai që shkon me një prijës që e di rrugën shumë mirë?

TASAVVUFI ËSHTË MORALII KUR'ANIT DHE SUNNETIT

Shehlerët thonë: Tasavvufi përbëhet prej moralit të bukur.

A thua,çka është morali i bukur?

Për ata që e donë Allahun Teala dhe që dëshirojnë që Ai t'i dojë, që kjo dashuri të bëhet e vërtetëe të ketë shpërblim, është treguar vetëm një rrugë. Kjo rrugë të cilën e shpjegon ajeti më poshtë, është rruga e Muhammedit s.a.v.s.:

“Thuaj: ‘Nëse e doni Allahun atëherë ejani pas meje që Allahu t’iu dojë’.”3-Ali Imran:31.

Dikush që nuk përputhet me sunnetin e Resulallahut s.a.v.s., edhe njëmijë vjet të mundohet dhe ta luftojë nefsën, nuk mund të edukohet.

Shihabuddin Suhreverdipasi tërheq vëmendjen që ky ajët tregon themelin dhe qëllimin e adhurimit,thotë:

“Mes myslimanëve, në çështjen e përputhjesndaj Resulallahut s.a.v.s., në radhët e para janë sufitet; sepse ata u përputhen fjalëve të tij në kuptimin e tyre të plotë - atë që Pejgamberi ka urdhëruar e realizojnë, dhe largohen shumë prej gjërave që ai i ka ndaluar. Ata,në këtëçështje, me mish e me shpirt i janë nënshtruar urdhrin të Allahut Teala:

“Çfarëdo që t’iu japë i Dërguari, merreni atë, e çfarëdo që t’iu ndalojë, hiqni dorë prej saj.”

59-Hashr:7

Sufitë i janë nënshtruar me një sinqeritet të madh Resulallahut s.a.v.s. në të gjitha veprat dhe në ibadetet farz,vaxhib,sunnet dhe nafile.Me bereqetin e nënshtrimit ndaj sunnetit (fjalëve dhe sjelljeve) të Resulallahut s.a.v.s., sufitë përfituan dituritë dhe moralin e bukur të tij.

Duke qenë i pyetur: “Sipas juve, kush është sufi?” Abdulvahid b. Zejd,thotë:

“Sufi i vërtetë është ai që mundohet të kuptojë sunnetin në tërësi, që lidhet me zemër pas sunnetit dhe që prej sherrit të nefsit strehohet te Allahu Teala.”

Kjo,në përgjithësi, është një përshkrim që tregon gjendjen e sufive.

Morali më i lartë i Resulallahut s.a.v.s. ështëqë e dinte që vazhdimishtështë nevojtar për Allahu Teala. Kjo dua (lutje) e tregon këtë:

“Allahu im! Mos më le në dorë të nefsit tim, as edhe sa hap e mbyll sytë. Gjërat e bukura që më ke dhënë, mos i merr nga unë!”⁵²

⁵² Sujuti, el-Xhamiu’s-Sagir, Hadith Nr: 1478; Hejsemi, Mexhmeu’z-Zevaid, X, 181.

Sufi është ai që me përputhjesunnetit të Resulallahut s.a.v.s., prej gjërave më të ndershmepërfiton njohurinë që vazhdimisht është nevojtar për AllahuTeala.

Allahu Teala, me mirësi të madhe, ashtu siç e njoftoi Resulallahun s.a.v.s., edhe sufiun e njofton me gjendjen e nefsit, e ai (sufiu), vazhdimisht strehohet te Allahu prej sherrit të nefsitdhe Atij i drejtohet për ndihmë.

Në këtë gjendje, nefsi bëhet një shkak që dërgon robin te Rabbi. Për këtë arsye, dikush që është sufi, ashtu si nuk është i pavëmendshëm(gafil) prej Rabbit të vet, edhe në kontrollim të nefsit nuk mbetet mbrapa.

“Kush e njeh nefsin (egon e vet), e njeh edhe Rabbin e vet.” Fjalë të mençura që shprehin se si njohja e nefsit është e lidhur me njohjen e Allahut Teala.

“Kur themi sunneti i Resulallahut s.a.v.s., na bie ndër mend personaliteti i tij i lartë që posedonte këtë moral.”⁵³

Sufiu ka vetëm një qëllim – zbukurimin e moralit dhe nderimin me ibadet; e për arritjen e këtij qëllimi nuk ka asnjë dëshmi tjetër përpos Resulallahut s.a.v.s..

⁵³ Suhreverdi,Tasavvufi i Vërtetë, 58-59.

Për këtë arsye, të gjithë shehlerët janë në pajtueshmëri me deklaratën e dijetarit të madhXhunejd el-Bagdadi si princip i përgjithshëm:

“Nuk ka asnjë rrugë tjetër që arrit rizanë (kënaqësinë) e Allaht Teala përveç nënshtrimit sunnetit të Resulallahut s.a.v.s.”⁵⁴

Në qoftë se thuhet diçka e tillë si: *“Për në rrugë të drejtë, Kur’ani dhe mendja imemë mjaftojnë, për sunnetin nuk kam nevojë!”*; kjo nëse thuhet me mosdije – është budallallëk, e nëse thuhet me tradhëti - është kufër. Ashtu siç e bën të qartë Resulallahu s.a.v.s.:

“Askush nuk mund të bëhet mumin(besimtar) i vërtetë, pa ia nënshtruar sunnetit - jo vetëm mendjen, por edhe dëshirat e nefsit (vetes).”⁵⁵

Kur hulumtohet mirë, shihet se tasavvufi është një shkollë që ia mëson njeriut edukimin e Kur’anit dhe sunnetit.

Vërtet është rob besnik sufiu që njoftohet me ajetet në Kur’ani Kerim:

“O ju që besuat! Ta keni në kujdes Allahun dhe të jeni me të drejtë.” 9-Tevbe: 119.

⁵⁴ Kushejri, Risale, I, 117; Sylemi, Tabakatu’s-Sufijje, 159; Sybki, Tabakatu’sh-Shafiiije, II, 263.

⁵⁵ Begavi, Sherhu’s-Sunne, I, 213; Ibnu Rexheb, Xhamiu’l-Ulum, II, 269; Sujuti, el-Durru’l-Mensur, II, 178.

“Ndiqni ata që nuk kërkojnë nga ju asnjë shpërblim, dhe janë udhërrëfyes!”³⁶- Jasinë:21.

Një shejh që ka këtë cilësi, duke u bërë udhëzues në rrugëne devotshmërisë, në ibadet është shembull për secilin. Nëse i përshtatet dikujt, ai i përshtatet Resulallahut s.a.v.s. dhe arrin kënaqësinë hyjnore; sepseshejhu (murshidi kamil) vërtet është trashëgimtar për të cilët është dhënë myzhde me hadithin:

“Alimët (dijetarët), janë trashëgimtarët e Pejgamberëve.”⁵⁶

Shejhu nuk është trashëgimtar i pejgamberllëkut, por është trashëgimtar i diturisë, moralit dhe gjendjeve që Pejgamberi s.a.v.s. i la ummetit të tij.

Një nga dijetarët, Ebu Nasr es-Sarraxh kështu e tregon gjendjen e sufive:

“Sufitë që kanë kompletuar edukimin e tasavvufitjanëtë barabartë me fakihët, muhadithët dhe mufesirët në plotësimin efarzeve, vaxhibeve dhe sunneteve, e në shumëçështje tjerasufitë arrijnë edhe dituri të veçantë dhe një moral të lartë.

⁵⁶ Ebu Davud, ilim, 1; Tirmidhi Ilim, 19; Ibnu Maxhe, Mukaddime, 17; Hakim, Mustedrek, I, 100-101.

Kjo dituri e veçantë dhe moral i lartë është:

- *Braktisja e fjalëve dhe punëve të padobishme;*
- *Nxjerrja nga zemra e çdo gjëje, përpos kënaqësisë së Allahut Teala;*
- *Të kënaqurit me pak - me atë që është e domosdoshme*
- *Me dëshirë të vet, preferon varfërinë ndaj pasurisë, urinë ndaj ngopjes;*
- *Braktisje e lartësisë dhe madhështisë në sytë e njerëzve;*
- *Modesti ndaj të madhit dhe të voglit;*
- *Përkundër nevojës së vet, favorizon të tjerët;*
- *Veprim me sinqeritet në të gjitha punët dhe ibadetet.*
- *Vazhdimishti drejtohet Allahut Teala;*
- *Dorëzim në fatkeqësitë që vijnë prej Allahut Teala, pranim i kaderit hyjnor;*
- *Sabër karshi dëshirave të nefsit; Vazhdimësi në orvatje;*
- *Frikë-respekt ndaj Allahut Teala, për ta bërë zemrën rob në qetësi dhe kënaqësi të plotë dhe për tu pastruar nga mendimet e këqija;*
- *Vetëm për t'u takuar me dashurinë e përhershme, preferon vdekjen ndaj jetës, gjendjen e vështirë ndaj rehatisë.*

Po, dijetarët e kuptueshëm dhe fakihët besojnë se sufitet posedojnë edhe më shumë dituri dhe gjendje shpirtërore, por mjaftohen me deklarin se ata janë të vërtetë (hak), e nuk bëjnë përpjekje për t'i përfituar ato gjendje, siç bëjnë sufitet.

Të gjitha këto gjëra që i përshkruam ekzistojnë në librin e Allahut Teala dhe në sunnetin e Resulallahut a.s.. Këtë e dinë ata që e zotërojnë këtë dijeni. Edhe dijetarët që hulumtojnë mirë nuk e mohojnë këtë.

Të shtojmë edhe këtë se, për dituritë e përshkruara më lartë ka shumë pak njerëz të interesuar; sepse përfitimi i atyre diturive arrihet me mundim dhe me shumë vuajtje shpirtërore. E natyra e njeriut, në përgjithësi, kërkon rehati dhe lehtësim.”⁵⁷

Imam Gazali pasi që hulumtoi degët e tjera të diturisë dhe grupet tjera nëislam, hulumtoi edhe gjendjet e sufive të vërtetë, qëllimet e të cilëve u përshtateshin Kur’anit dhe sunnetit, dhe arriti në këtë përfundim:

“Përfundimisht kuptova që janë vetëm sufritë ata që rrugën e Allahut e mbajnë me të gjitha gjendjet e saj. Qëndrimi i tyre është qëndrimi më i mirë, rruga e tyre është rruga më e drejtë dhe morali i tyre është morali më i pastër.

Për më shumë,sikur të bashkoheshin mendjet e të gjithë të mençurve, tërë urtësia e gjithë urtakëve dhe të gjitha dituritë që posedojnëdijetarët, edhe të provojnë të sjellin gjendje dhe moral më të bukur se ai i sufive, nuk do t’ja arrinin.

⁵⁷ Serraxh, el-Luma; 29-33;

Sepse, të gjitha gjendjet dhe lëvizjet e tyre të dukshme (zahir) dhe të brendshme (batin) janë marrë prej nurit të nubuvetit (pejgamberllëkut). Siç dihet, përveç nurit të nubuvetit që ndriçon në sipërfaqen e tokës, nur tjetër nuk ka.”

“Çka mund të thuhet shkurtimisht në lidhje me rrugën e tasavvufit? Kushti i parë i kësaj rruge është pastrimishpirtëror dhe pastrimi i zemrës prej të gjitha gjërave tjera, përveç Allahut Teala. Çelësi i kësaj rruge, pra esenca e saj, është që zemra, me përkushtim të plotë, të bëj dhikër Allahun. E si përfundim është humbja në dëshirën dhe kënaqësinë e Tij.

Ata që në mënyrën e duhur ndjekin rrugën e tasavvufit, personalisht e shijojnë dhe mësojnë këtë gjendje. E ata që nuk e mësojnë duke e shijuar dhe jetuar personalisht, nëse shpesh bëhen bashkë me sufite që kanë kaluar këtë rrugë, duke i dëgjuar ata dhe nga përvoja e vet, i besojnë pa dyshim ekzistimit të kësaj gjendjeje dhe e kuptojnë atë me ndihmën e gjendjeve shpirtërore që vet i përjetojnë.

Ata që janë bashkë me sufite, që marrin pjesë në sohbetin (bisedat) e tyre, mund të përfitojnë këtë besim dhe dijeni; kjo sepse sufite janë njerëz të tillë që, dikush që gjendet me ta në të njëjtintubim, nuk mbetet i privuar nga mëshira hyjnore.”⁵⁸

⁵⁸ Gazalli, ‘el-Munkëzu Mine’ d-Dalal’ dhe ‘Analizat e Tasavvufit’.

Tasavvufi, me kaq gjendje të bukura dhe me moral që posedojnësufitë, është një shkollë e mësimit të devotshmërisë. Të diplomuarve të kësaj shkolle u thuhet *sufi*, atyre që japin mësimin e devotshmërisë në këtë shkollë, dhe me lejen e Allahut që bëjnë pastrimin e zemrës dhe edukimin e nefsit - u thuhet murshidi kamil/shejh, atyre që kanë njohur hollësitë e rrugës u thuhet *mutasavif*, kurse fillestarëve të kësaj rruge u thuhet *murid i ri*.

Murid i thuhet personit i cili me dashuri dhe vetëdëshirë zgjedh një shejh (murshidi kamil), hyn në rrugë të drejtë dhe kërkon kënaqësinë (rizanë) e Allahut Teala.

TASAVVUFINUK PRANON EMËR TË RREJSHËM

Falënderimi (hamd) i takon vetëm Allahut, Ai na dha emrin 'besimtar'(mumin) dhe 'mysliman'. Por Krijuesi do që ne t'u japim hakun këtyre emrave, dhe na tërheq vërejtjen:

"A menduan njerëzit të thonë: 'Ne kemi besuar', e të mos vihen në sprovë?"29-Ankebutë: 2

Allahu Teala dëshiron që e brendshmja dhe e jashtmjja të bëhen një. Ata, të cilëve fjala nuk u përputhet me vepra, që me zemër nuk kanë besuar, e që me gjuhë thonë që janë mysliman, kështu qortohen:

"Ata thonë:'Ne i kemi besuar Allahut, të dërguarit të Tij dhe u jemi bindur.' Por pas asaj një grup prej tyre devijojnë.Të tillët nuk janë besimtarë."

24-Nurë: 47.

"Beduinët thanë:'Ne kemi besuar'. Thuaj: 'Ju nuk keni besuar ende,por thoni: 'ne jemi dorëzuar', e ende nuk po hyn imani në zemrat tuaja'."

49-Huxhuratë: 14.

Për të qenë afër dhe për tu dashur nga Resulallahu s.a.v.s. është vetëm një rrugë - devotshmëria. Në këtë dashuri, soji (prejardhja) nuk luan rol.

Ja pohimet e Pejgamberit të Rahmetit s.a.v.s.:

“Të gjithë të devotshmit konsiderohen familje e Muhammedit.”⁵⁹

“Disa prej fisit tim mendojnë për vete që janë ndër më të afërtit dhe më të dashurit e mi, e nuk është kështu. Padyshim se miqtë e mi në mesin tuaj janë të devotshmit. Kushdo që janë ata, e kudo që ndodhen, kjo nuk ndryshon.”⁶⁰

Resulallahu s.a.v.s. po dërgonte Muadh b. Xhebel r.a. në Jemen dhe doli ta përcjellë për rrugë. I dha edhe disa këshilla. Muadhi r.a. kishte hipur në deve, ndërsa Resulallahu s.a.v.s. ecte. Kur erdhën deri te vendi i përcjelljes, Resulallahu s.a.v.s. iu drejtua:

“O Muadh! Ndoshta pas këtij viti nuk do të më takosh më këtu, e nuk do të më shohësh.”

Me këtë isharet të Resulallahut s.a.v.s., Muadhi r.a. mori lajmin e vdekjes së Resulit dhe filloi të qante.

Pas kësaj, Resulallahu s.a.v.s. u drejtua për Medine dhe tha:

“Për mua, më i afërmi dhe më i dashuri prej njerëzve, kushdo që është ai, e kudo që ndodhet, është i devotshmi.”⁶¹

⁵⁹ Teberani, el-Mu'xhemu's-Sagir, Nr: 318, el-Evsat, IV, 204.(Nr: 3356); Hejsemi, Mexhmau'z-Zevaid, X, 269.

⁶⁰ Taberani, el-Mu'xhemu's-Sagir, Nr: 318; shik. Buhari, Edebu'l-Mufred, Nr: 896; Bejhaki, Kitabu'z-Zuhd, Nr: 882.

⁶¹ Ahmet, Musned, V, 235; Ibnu Hibban, Sahih, II, 414-415.

Njeriu duhet të jetë i mëshirshëm; ai nuk duhet të mashtrohet nëse disa atij i thonë sufi, murid, kamil (i përkryer), alim (dijetar), myttaki (i devotshëm). Në qoftë se nuk ka cilësitë që u përmendën, nuk duhet të sillet sikur i ka. Allahu na ruajt, njeriu që pretendon diçka, e të njëjtën nuk mundet ta dëshmojë edhe tek Haku, edhe te njerëzit, poshtërohet. Të hyrit nën edukimin e shejhut dhe të bërit pjesë e tyre është vërtetë diçka shumë e ndershme, por, shikoni çka thotë një sufi: *“Nuk është murid ai që lavdërohet me shejhun e vet; murid i vërtetë është ai me të cilin lavdërohet shejhu i tij.”*⁶²

Shejhui Imam Sharanit, Ibrahim ed-Desuki kështu tregon gjendjen e një muridi të vërtetë:

*“Kush nuk është i ndershëm, i nderuar dhe me moral të bukur, ai nuk është evladi im, edhe në qoftë nga gjaku im. Ekush përqafon urdhrat e fesë, edukimet e tarikatit, ruhet prej gjynahut, largohet prej dëshirave të kësaj bote dhe gjërave të dyshimta, dhe fiton sa për nevoja të veta, ai është vërtetë evladi im, edhe nëse vjen nga ana tjetër e botës.”*⁶³

I vetmi shkak që lidh udhëtarët e rrugës së drejtë me njëri-tjetrin është lidhja shpirtërore dhe dashuria hyjnore.

⁶² Sh’rani, el-Envaru’l-Kudsijje, I, 200.

⁶³ Sh’rani, a.g.e. I, 99.

Dëshmisë në vepra të kësaj dashurie i thonë *takva* (devotshmëri), dhe prej atyre që thonë “*unë e dua Allahun Teala*” kërkohet vetëm sinqeritet dhe devotshmëri. Pa këto, gjithçka për të cilën supozohet se është arritur, është gënjeshtër ose e mangët. Dashuria e shejhut i është nënshtruar dashurisë hyjnore.

Piri i rrugës së nakshive, Shah-i Nakshibend kur është pyetur “*Deri ku arrin prejardhja e juaj?*”, ka dhënë këtë përgjigje me shumë domethënie: “*Askush me prejardhje nuk mund të arrijë në një vend.*”⁶⁴

Tahiru’l- Mevlevi sqaron hollësitë e kësaj përgjigje:

“*Çdokush le të shikojë veprat që ka bërë në përputhje me shariat, e jo prejardhjen që i takon, ose pozitën në këtë botë.*”⁶⁵

Shejh Sejjid Sibgatullah Ervasi ka thënë:

“*Fëmijët e vërtetë të shehlerëve janë ata që i trashëgojnë shpirtërisht. Lidhja me një shejh është lidhje shpirtërore, që ka për qëllim ecjen rrugës së tij. Nuk çmohet të bërit bashkë me shejhun vetëm në formë.*”⁶⁶

⁶⁴Xhami, Nefahatu’l-Uns, 532

⁶⁵Tahiru’l-Mevlavi, Përmbledhje e Mesnevisë, I, 75

⁶⁶Sejjid Sibgatullah, Mina, 70

Paralajmërimi që Resulallahu s.a.v.s. i bëri Fatimesë r.ah., është i mjaftueshëm për çdo njeri, që të zgjohet:

“O Fatime! Mbështjellu me veprime që të shpëtojnë prej zjarrit. Dije se unë nuk mund të largoj nga ti diçka që vjen prej Allahut.”⁶⁷

Resulallahu s.a.v.s. ka këshilluar Fatimen r.anha. që t’i drejtohet veprave të drejta, e jo të mbështetet në atë që është e bija e Pejgamberit. Një paralajmërim tjetër i Resulallahut s.a.v.s. është edhe ky:

“Atë që vepra e lëmbropa, nuk e çon përpara prejardhja familjare.”⁶⁸

Duke ditur këtë hollësi, Imam Rabbani kështu paralajmëron ata që hyjnë në rrugën e edukimit shpirtëror:

“Nuk duhet të mashtrohemi se, edhe nëse braktisim veprimin, ose jemi të dobët në të, ndihma shpirtërore e shejhut na mjafton.”⁶⁹

Njeriu duhet t’i bëjë ibadet Allahut Teala me dashuri dhe dëshirë.

Ibadeti vazhdohet deri në vdekje. Çdokush është përgjegjës për veprat e veta.

⁶⁷ Buhari, Vasaja, 11; Nesaji, Vasaja, 6; Darimi, Rikak, 23.

⁶⁸ Ebu Davud, Ilim, 1; Tirmidhi, Kur’an, 10; Ibnu Maxhe, Mukaddime, 17

⁶⁹ Imam Rabbani, Mektubat, I, Letra 148.

Në ibadet, shehlerët bëhen shembull dhe forcë për njerëzit; u ndihmojnë zemrave të dobëta, ringjallin dashurinë e shuar në zemra.

Tasavvufi është ecja në rrugë të Allahut me xhemat dhe në bashkim.

Tasavvufi është bërja e përbashkët eteubes.

Tasavvufi është që në bashkësi t'i bëhet dhikër Allahu Teala.

Tasavvufi është të drejtuarit së bashku dhe mbështetja njëri-tjetrit në rrugën e drejtë.

Tasavvufi është mbështetja e përbashkët, nën mbikëqyrjen e murshidi kamilit, në litarin e Allahut Teala, do të thotë në Kur'an, sunnet, devotshmëri dhe sinqeritet.

Tasavvufi është që bashkë me vëllezërit besimtarët mundohemi të ruajmë fenë, karshi dëshirave të këqija dhe shejtanit armik.

Tasavvufi është i tillë që mund të kuptohet vetëm duke shijuar mirësitë dhe lumturinë hyjnore.

SEJR-U SULUK DHE METODAT E EDUKIMIT

Edukimi merret nga të gjitha veprimet, gjatë gjithë jetës. Njeriu i mençur, prej kohës së adoleshencës e deri në vdekje është përgjegjës ndaj Allahut Teala dhe ndaj njerëzve.

Ibadeti dhe morali i bukur nuk kanë fund. Me ibadet, besimtariçdo ditë i afrohet Rabbit të tij. Kjo quhet *ngritje*. Kjo ngritje bëhet me zemër.

Ngritja është përparim shpirtëror, lartësim në botën e melaikeve dhe përjetim i pranisë hyjnore.

Duke u edukuar dhe pastruar shpirtërisht, njeriubëhet vërtet njeri; kuptohet hakikati i fesë, Islami jetohet me tërë bukuritë dhe hollësitë e Tij, dhe kështu del në shesh urtësia (hikmet) se njeriu është halife i Allahut Teala në sipërfaqen e tokës.

Në tasavvuf, ky procesemërtohet me termin *edukim shpirtëror* ose *sejr-u suluk*.

ÇKA ËSHTE SEJR-U SULUK?

Sejr(ecje, udhëtim) në tasavvuf është kalimi nga padituria në dituri, nga vesi i keq në vese të mira.

Ndërsa *suluk*(ndjekje e një rruge/ngritje shpirtërore) është edukim moral dhe ngritje shpirtërore për të arriturte Haku, eparaprirë nga një udhërrëfyes dhe nën kontrollin e tij.⁷⁰

Sejr-u suluk, përbëhet prej edukimit të zemrës dhe nefsit. Ky edukim është i tillë që fillon nga zemra dhe përfshinë çdo pjesë të jetës. Qëllimkryesor është që njeriu të njoh veten dhe Rabbin e vet. Hapi i parë është të zgjuarit nga pavëmendja. Hapi i dytë, është që personi të bëhet njeri i përkryer.

Ajo që në Kur'an përmendet si 'tezkije' dhe 'muxhahede' është e njëjtë me atë që sufite e përdorin si *sejr-u suluk*.

Tezkije është pastrimi nga ndyrësitë shpirtërore.

Muxhahede është përpjekja me të gjitha kapacitetet për të hyrë në këtë rrugë dhe stolisja me edukatë morale hyjnore. Krejt çështja është që të merret vendimi dhe të niset në rrugë për tu bërë mik i Allahut.

⁷⁰ Ankaravi, Minhaxhu'l-Fukara, 51; M. Ali Ajni, Historia e Tasavvufit, 105; Tehanevi, Keshafu Istihati'l-Funun, II, 686

Kjo rrugë nuk është aq e lehtë dhe e rehatshme, për t'u nisur i vetmuar në të. Përpara njeriut janë tri pengesa të mëdha: shejtani,nefsi (ego) dhe bota. Përpos kësaj,ekzistojnë një varg rreziqesh që e rrethojnë njeriun. Në këtë rrugë, gjynahet, e nganjëherë bile edhe ibadetet, mund të bëhen një fatkeqësi për njeriun.

Ka aq shumë njerëz që në përfundim janë dëmtuar, për shkak të vet-pëlqimit për namazet që falin dhe dhikrin që bëjnë, duke rënë në mendjemadhësi dhe duke nënçmuar njerëzit, dhe duke menduar për vete që ekanësiguruar xhenetin.

Qëllimi kryesor nuk arrihet nëse nuk dihet edukata e ibadetit. Njeriu sipërfaqësor, duke thënë 'Allah' me gjuhë, me zemër largohet prej Allahut.

Në qendër të edukimit shpirtëror është shejhu. Ai përcakton dhe përcjell mënyrën e edukimit. Edukimi i njeriut është punë e pejgamberit. Për këtë arsye edukimi shpirtëror bëhet mbi edukimin që e solli Resulallahu s.a.v.s.

Qëllimi i edukimit nuk është ndryshimi i natyrshmërisëpor orientimi i saj kah e mira.Ndryshimi nga karakteri i keq në karakter të mirë te njeriu, është i mundur. Nga mesi i njerëzve të përkryer zgjidhetshejhu i përkryer, dhe me lejen e Allahut Teala aifillon punën, në fillim duke zgjuar muridinprej gafletit me një teube të singertë, e pas teubes, detyra më e rëndësishme në edukim shpirtëror është dhikri.

Të shohim tani shkurtimisht shpjegimin e dhikrit, vendin dhe dobritë e tij në edukimin shpirtëror.

ÇKA ËSHTË DHIKRI?

Në edukimin dhe udhëtimin shpirtëror, qëllimi i parë është zgjimi i zemrës. Në fillim vjen pastrimi nga ndyrësitat shpirtërore pastaj vjen zbukurimi me moral të bukur me të cilin është i kënaqur Allahu Teala. Pas kësaj, zemra është e gatshme për miqësi hyjnore. Krejt *sejr-u suluk* bëhet për këtë arsye. Rezultat i muxhahedes (luftës me vetveten) është të bërit dashuri i Allahut dhe hyrja nën mbrojtjen hyjnore.

Në edukimin shpirtëror, së pari trajtohet zemra. Sipas përvojës dhe dokumentimit të të gjithë shehlerëve, ilaçi më efektiv për zemrën është të bërit teube dhe të bërit dhikër Allahun Teala.

Dhikri, kuptim fillestar ka të përmendurit, përkujtimin, mos-harrimin dhe kujtimin e kuptimeve. E kuptimi i fshehtë është të dashuruarit, lartësimi, përmallimi.

Në fakt, dhikër është nxjerrja e *masivës* nga zemra. *Masiva* është gjithçka tjetër pos Allahut Teala.

Dhikri është fryt i mendimit. Mendimi është vepër e dashurisë. Dashuria është dhunti nga Allahu Teala.

Mevlana Halid Bagdadi në një letër që i shkruan muridit të tij besnik Shehu'l-Islam Meki Zade Mustafa Asim-it, kështu e përshkruan shkurtimisht dhikrin:

"Përatë që posedon besim të drejtëdhe i përshtatet njërit prej medh'hebevetë Ehl-i sunnetit, pasi që t'i plotësojë farzet, ndër ibadetet më të larta është vazhdimi i dhikrit të fshehtë.

Gjatë dhikrit, njeriu duhet ta dijë se Allahu Teala e sheh dhe e dëgjon atë, dhe asgjë nuk mbetet e fshehur nga Ai. Kjo dijeni nuk duhet të jetë imitim, por duhet të fitohet duke hulumtuar. Kësaj i thuhet dituri me bindje(ilmul jekîn).

Për të arritur në bindje, njeriu duhet të heq interesimin nga çdo gjë tjetër pos Allahut Teala, dhe të përqafojë sunnetin me sinqeritet dhe dashuri. Rruga më e mirë për këtë është të hyrit nën edukimin dhe ndikimin e njërit prej miqve të Allahut Teala që është i obliguar me irshad.

Në ditët e sotme kur thuhet dhikër, nuk mendohet në vepratfarz por në ibadet nafile. Ata besimtarë që falin pesë vaktet namaz, lexojnë Kur'an, merren me dituri, largohen prej haramit, zaten dhikër janë duke bërë; mendojnë se nuk kanë nevojë për dhikër të veçantë.

Po, këto ibadete dhe vepraqë u përmendën janë një mënyrë e dhikrit, por nga të gjithë veprat, dhikri veçohet si i tillë që mund t'i bëhet ilaç zemrës dheqëe qetëson atë. Miqtë e Allahut Teala, dhikrin që është ilaçditor i zemrës, e kanë cilësuar si *virde*. Në këtë mënyrë dhikri u ka mbështjellë atyre gjithë personalitetin, është përhapur në tërë kohën e tyre dhe është bërë një pjesë e pandashme e jetës së tyre. Kësaj i thuhet *dhati dhikër*.

Për këtë, dhikri i Allahut Teala është jetë, qetësi, gëzim dhe ilaç për zemrën. Pa dhikër zemra vdes.

Së pari të përkujtojmë këtë fakt: Kur'ani na lajmëron që tërë gjithësia është duke bërë dhikër Allahun Teala:

“Lartmadhëri të merituar i shprehin Atij shtatë qiejt dhe toka e çka ka në to, e nuk ka asnjë send që nuk e madhëron (nuk i bën tesbih), duke i shprehur falënderim Atij, por ju nuk e kuptoni atëlartësim të tyre (se nuk është në gjuhën tuaj). Ai është i butë dhe fal shumë.”17-Israë:44.

Kur'ani, në mënyrë të veçantë neve po na mëson këtë: çdo krijesë e posedon një dua të posaçme dhe tesbih; me lejen e Allahut Teala ata e dinë se si t'i luten Atij dhe si ta madhërojnë.

“A nuk e vëren ti, se Allahun e lavdëron çdo krijesë që ndodhet në qiej dhe në Tokë, madje edhe shpezët krahëhapur? Çdokush e di se si t'i falet e ta lavdërojë. Allahu e di mirë çfarë bëjnë ata.”

Allahu Teala i dha një dhikër të veçantë secilës krijesë që e krijoi, që ta bëjë dhikër Atë.

Ne nuk mund të dallojmë mënyrën e dhikrit të krijesave pa shpirt, por që ato bëjnë një lloj dhikri, kjo është e sigurt.

Çdo qenie e gjallë, patjetër merr dhe jep frymë, me ose pa dëshirë. Kjo frymëmarrje, në gjendje natyrore, duke dalë nga fyt i gjallë bën ‘*hu... hu...*’, bën dhikër. *Hu* tregon Atë, Krijuesin Madhështor. Ky është dhikri më esencial. Por, pjesa më e madhe e njerëzve nuk është në dijeni për këtë.

Dhikri është obligim për edukim; sado të bëhet dhikër është pak.

ESENCA DHE QËLLIMI I IBADETEVE ËSHTË DHIKRI

Pse falet namazi, pse jepet zeqati, pse shkohet në haxh, pse mësohet dituria, pse duhetpejgamberi, libri, Qabeja, xhamia, nëna e babai, pse theret kurban, pse bëhet xhihad? Me mijëra pyetje të tilla të bëhen, dhe nëse kërkohet përgjigje për to – përgjigja kishte me qenë: për të bërë dhikër, për të përkujtuar/për të përmendur.

Asnjë ibadet nuk është qëllim në vete. Namazi, agjërimi, zeqati, haxhi, hizmeti, morali, dituria, irfani, ihsani - të gjitha janë për përkujtim/dhikër Krijuesit Madhështor.

Ibadeti më i madh është namazi. I vetmi qëllim në namaz është që me tërë trupin të përkujtohet, të përmendet, të bëhet dhikër Allahu Teala.

“... fal namazin për të më kujtuar Mua!”

20-Ta-Ha:14

Qëllim kryesor në namaz nuk është që të bëhen lëvizjet e njohura. Duke bërë ato lëvizje, qëllimi është të bëhet dhikër Allahu Teala, me gjuhë dhe me gjendje të lartësohet Allahu, dhe të pranohet pafuqia jonë karshi Tij.

Ta mendojmë edhe këtë ajet:

“Ti lexo atë që të shpallet nga libri (Kur’ani),fal namazin. Vërtet namazi largon nga të shëmtuarat dhe të pezmatuarat,përmendja e Allahut është adhurimi më i madh.”29-Ankebutë:45.

Kur Allahu Teala përmend robin që bën dhikër, kjo nuk mund të matet me asgjë, është një lumturi e papërshtueshme për robin. Allahu Teala thotë:

“Më kujtoni Mua, që edhe Unë t’u kujtoj juve.”

2-Bekare:152.

Kjo myzhde është e mjaftueshme për të bërë dhikër Allahun Teala. E përfitimin që ka njeriu nga dhikri, Resulallahu s.a.v.s. kështu e shpjegon:

“A doni t’iu jap lajmin se cila nga veprat tuaja është më e mirë te Rabbi juaj, e cila ngrit gradën tuaj më së shumti, ecila është edhe më e mirë se ndihmat e arit dhe të argjendit që i jepni, se vrasja e armiqve përballë jush ose të bërit shehid në luftë me ta? Kjovepër është të bërit dhikër Allahun Teala.”⁷¹

Me një rast, kur e pyetën Resulallahun s.a.v.s.:
“Cili xhihad, cili namaz, cili agjërim, cili zeqatë, cila sadaka, cili haxh është me vlerën më të lartë?”,
Resulallahu s.a.v.s., dha përgjigjen:

“Ibadeti me vlerën më të lartë është ai brenda të cilit më së shumti bëhet dhikër Allahu Teala.”⁷²

Në qoftë se shtrohet pyetja:

“Cili dhikër është me vlerën më të lartë?”,
përgjigja është kjo: *“Dhikri me vlerën më të lartë është dhikri që e mban zemrën zgjuar dhe që me sinqeritet lartëson Allahun Teala.”*

Një ibadet, edhe nëse është i kushtëzuar nga mjetet financiare, nuk e ndërron qëllimin - që është dhikri. Përkundrazi, kjo tregon se dhikri është i përhapur në çdo hapësirë të jetës. Ky hadith është i mjaftueshëm për të kuptuar temën:

⁷¹ Trmidhi, Deavat, 6; Ibnu Maxhe, Edeb, 53; Ahmet, Musned, I, 190; Hakim, Mustedrek, I, 496.

⁷² Ahmed, Musned, III, 438; Ibnu Mubarek, Zuhd, Nr: 1429; Tabarani, el- Kebir, XX, 186.

“Të bëhet tavaf në Qabe, të vrapohet mes Safa dhe Merve, të gjuhët shejtani me gurë, janë urdhëruar vetëm e vetëm për të bërë dhikër Allahun Teala.”⁷³

Në fillim u bëe qartë se të përmendet Allahu Teala është një lloj obligimi. Kjo përmendje nuk ka ndonjë numër të caktuar a kufi. Urdhri që u është dhënë besimtarëve, është ky:

“Përmendni çdo herë Allahun që të arrini fitoren e dëshiruar.”^{8-Enfalë:45.}

“Edhe meshkujve që përmendin shumë Allahun, edhe femrave që përmendin shumë Allahun, Allahu atyre u ka përgatitur falje dhe shpërblim të madh.”^{33-Ahzab: 35.}

“O ju që besuat, përkujtoni Allahun sa më shpesh.”

“Dhe madhëroni Atë mëngjes e mbrëmje.”

33-Ahzab: 41-42.

Gafili (i pavëmendshmi) nuk mund të bëhet mik i Allahut, dhe ai që e do Allahun Teala nuk mund të jetë gafil.

⁷³ Ebu Davud, Haxh, 50; Tirmidhi, Haxh, 64.

Nëse besimtaripërmend më shumë paratë, pozitën dhe veten se sa Rabbin e gjithësisë, duhet ta dijë se zemra e tij është e sëmurë. Kurse, gjithçka në këtë botë është krijuar si amanet për të na ndihmuar neve në përkujtim.

Dhikri është veprae parë e udhëtarit të rrugës së drejtë. Krejt çështja është te zgjimi i zemrës. Personit të cilit zemra nuk i është zgjuar, nuk mund të lirohet nga një lloj imitimi. Në këtë gjendje, zemra nuk mund të merr shijen e vërtetë të ibadetit, nuk mund të kuptojë të vërtetën (hakikat)dhe hollësitë e urdhrave hyjnorë.

Allahu Teala, për gjendjen e miqve të Tij,dhe si janë të dashuruar ata në dhikër, kështu na lajmëron:

“Ata janë njerëz që nuk i pengon as tregtia e largët e as shitblerja në vend për ta përmendur Allahun, për ta falur namazin dhe për ta dhënë zeqatin, ata i frikësohen një dite kur do të tronditen zemrat dhe shikimet.”24-Nurë: 37.

“Për ata që Allahun e përmendin me përkujtim kur janë në këmbë, kur janë ulur, kur janë të shtrirë dhe thellohen në mendime rreth krijimit të qiejve e të tokës.”3-Ali Imran: 191.

Sufitë, kësaj gjendje i thonë ‘*dhikr-i sultan*’, dhe kështu e shpjegojnë:

“Dhikr-i sultan’ është kur dhikri përhapet në tërë trupin, dhe merr me vete të gjitha ndjenjat dhe mendimet. Në këtë gjendje, personi është në pozitë të dëgjojë dhikrin e të gjithakrijësave.”⁷⁴

Lidhur me këtë temë, Imam Rabbani bën këtë paralajmërim të rëndësishëm:

“Humbja e zemrës në dhikër dhe arritja në shkallëku ajo harron gjithçka pos Allahut, arrihet vetëm me akiden e Ehli Sunnetit dhe duke vepruar sipas urdhrave të medh’hebeve që janë hak (Hanefi, Shafi, Maliki dhe Hanbeli). Ky është qëllimi më i madh që duhet të ndiqet.

Zemra e pastruar që ka arritur kënaqësinë e Allahutkur i shikon gjërat, nuk ngjitet e të ngel në to, por vazhdimisht e kujton Krijuesin e tyre. Në gjithçka vështron reflektimet hyjnore. Kjo zemër është e humbur në dashuri ndaj Allahut dhe në dhikër. Kësaj i thuhet “fená-i kalbi” (humbja e zemrës). Në tarikat kjo është shkalla e parë, kurse nivelet tjera të evliallëkut zhvillohen mbi këtë shkallë.”⁷⁵

⁷⁴ Mevlana Halid, Mektubat, Letra 32.

⁷⁵ Imam Rabbani, Mektubat, I, Letra 278.

PIKA E PARË NË DHIKËR

Pika e parë në dhikër është të besohet në nevojën për të. Dhikrin nuk duhet shikuar si vlerë të lartë, por si obligim! E më pas duhet bërë hapin e parë. Përfundimi nuk vjen nëse nuk ka fillim. Edhe si imitim nëse bëhet, dhikri duhet filluar. Për zgjimin e zemrës, kushti është t'i drejtohem dhikrit! Vazhdimësia në dhikër është esencë. Dhikri duhet vazhduar me qëllim që trupi të mësohet me dhikër, të ngrohet, dhe të arrijë dhikrin në gjendje natyrore – si frymëmarrje.

Njëri nga shehlerët emëdhenj, Shibliu, në ditët e para të hyrjes në edukim shpirtëror, afër vetes mbante thupra të holla, e kur binte në gaflet, ai thyente thuprën duke e goditur veten. Kështu mundahej të zbuste zemrën e pavëmendshme dhe nefsën që largohej nga dhikri.⁷⁶

Të mëdhenjtë e tasavvufit, atyre që janë duke e bërë hapin e parë në edukim shpirtëror, menjëherë i japin mësimin e dhikrit. Ky mësim fillon me një numër të dhikrit dhe vazhdohet hap pas hapi.

⁷⁶ Kushejri, Risale, II, 465.

Dhikrin e kontrollon shejhu. Ai bën ndërhyrjet e duhura në zemër, kujdeset nëse ka mbyllje dhe mërzitje, qel rrugën e zemrës. Shejhui di vesveset dhe pengesat që mund të vijnë nga shejtani, ai i bëhet muridit ndihmës për t'i tejkaluar ato.

Kontrollimi i shejhut vazhdon deri sa dhikri në trup vjen në *gjendje të melaikes*.

Dhikri në gjendje të melaikes do të thotë që dhikri është bërë pronë e trupit, nuk ndahet prej tij, e kjo gjendje nënkupton një cilësi.

Pika e fundit në dhikër është kur gjithë trupi i bashkëngjitet dhikrit të zemrës. Kjo është gjendja që arrihet me dhikrin që sqarojnë ajetet. E kjo është kur jemi duke bërë dhikër derisa ecim, kur jemi ulur, shtrirë; do të thotë ditë e natë, në të gjitha gjendjet, dhimbshëm dhe ëmbël, bëjmë dhikër Allahun Teala.

Dhikër në vazhdimësi do të thotë nënshtrim dhe edukim në vazhdimësi. Përhapja e dhikrit në tërë trupin dhe bashkimi i të gjitha pjesëve të trupit në dhikër arrihet vetëm me ibadet. Nuk është posedues i vërtetë i dhikrit e as mendimtar i zgjuar ai që derisa me gjuhë bën dhikër, me dorë bën zullum, me sy shikon haram, me ecje krekoset.

Fundi i dhikrit dhe mendimit të mirë është nënshtrimi. Çdo besimtar që i nënshtrohet urdhreve të Allahut Teala është duke bërë dhikër.

Një besimtar që përdor nimetin me bismilah, që thotë elhamdulillah pas përdorimit, ai besimtar është duke bërë dhikër.

Ai që frikësohet nga Allahu Teala nuk i afrohet haramit, ai që me dëshirë dhe dashuri heq dorën, gjuhën, syrin prej hameve, në atë moment është duke bërë dhikër Allahun Teala.

Besimtari është në gjendje të dhikrit kur çdo gjë që sheh e sheh si burim të mësim, e sheh si një vepër hyjnore arti, e për këtë arsye sillet butë me çdokënd dhe ruan edukimin.

Shkurtimisht, fillimi e fundi i dhikrit është edukatë.

Dhikri është vepra më e madhe ebesimtarit.

Dhikri është një sir (hakikat i fshehtë) dhe amanet, të cilin Allahu Teala e vendosi në zemrat tona. Qofshin të lumtur ata që arritën këtë sir dhe që e mbrojnë këtë amanet. Sepse ata janë miqtë e vërtetë të Allahut Teala.

Ata përmendin Allahun Teala, e edhe Allahu Teala përmend ata!Sa lumturi e madhe është kjo!

LLOJET DHE MËNYRAT E TË BËRIT DHIKËR

Kur'ani dhe sunneti përmendin dhe përshkruajnë lloje të ndryshme të dhikrit. Resulallahu s.a.v.s. i ka bërë të gjitha llojet e dhikrit. Ai, siç ka bërë dhikër vetë, ashtu ka bërë edhe dhikër me xhemat, në hallkë. Bashkë me dhikrin e fshehtë, Pejgamberi ka bërë edhe dhikër haptas. Ai, as'habëve u ka mësuar dhikrin e përshtatshëm për ta, varësisht prej natyrës/karakterit të tyre. Disave iu ka këshilluar dhikrin e fshehur, e disave atë të hapur. Pos kësaj, secilit i ka sqaruar llojin e dhikrit që personi duhet të bëjë.

Sasia, vendi dhe koha e dhikrit që zbatohet sot janë ashtu siç i ka përcaktuar Resulallahu s.a.v.s.. Përshembull, pas namazit farz të thuhet nga 33 herë '*Subhanallah*', '*Elhamdulillah*' dhe '*Allahu ekber*' e më pas edhe '*La ilahe ilallah vahdehu la sherike lehu*' me çka dhikri plotësohet në 100.

Sasia, vendi dhe mënyra e këtij dhikri janë të njohura, dhe askush nuk ka kompetencë të shtojë ose të pakësojë nga to.

Edhe duatë që lexohen në ruku, sexhde dhe në ulje të namazeve, janë dhikre të tilla. Edhe dhikret në *namazin etesbihut*, kur thuhet telbije (*lebbejk*), *tekbiret teshrik* (tekbiret në Kurban Bajram), *ezani* dhe *ikamet* zbatohen njëjtë siç janë përcaktuar.

Pos këtyre, ekzistojnë edhe shumë dhikre tjera për të cilat Kur'ani dhe sunneti nuk kanë përcaktuar numër, mënyrë ose kohë, e që janë inkurajuar dhe rekomanduar. Hapësira dhe koha e dhikreve të këtij lloji është e gjerë.

Dhikër mund të bëhet një fjalë a fjali, kuptimi i të cilës përkujton/përmend dhe lartëson Allahun Teala. Këto dhikre u përshtaten në themel ajeteve dhe haditheve. Brenda këtyre dhikreve mund të bëhet zgjedhje me ixhtihad. Kompetent është ai që në këtë fushë është dijetar (alim) dhe arif, d.m.th. shejhu.

Për dhikër më shumë janë preferuar fjalët '*Allah*', '*La ilahe ilallah*' dhe '*Hu*'.

Këto janë fjalë të dhikrit të lavdëruara në ajete dhe hadithe.

Lloje të ndryshme të dhikrit janë leximi i Kur'an-it, salavatet, të bërit istigfar, përmendja e *Emrave të Bukur* (Esmā-i Husnā) të Allahut Teala ose zgjedhja e njërit nga këta emra për vird.

Dhikri bëhet në tri mënyra: me zemër, me gjuhë, dhe me të dyja.

Llojin e dhikrit që do t'i bëhet zemrës ilaç, e caktojnë dijetarët (alim) që posedojnë përvojë dhe zotësi në këtë fushë. Këta dijetarë quhen *shejh*.

Një dhikër që përcaktohet nga shejhu, i përngjanë ilaçit. Shejhështë ai që e di se cilës zemër cili dhikër i përshtatet. Ai bën një zgjedhje dhe kombinim mes këtyre dhikreve. Ky kombinim bëhet me dituri, mendje-zgjuarsi, vëzhgim dhe përvojë. Mënyra dhe sasia e ilaçit që jepet ndërron, varësisht nga natyra e përdoruesit.

Qëllimi kryesor i tasavvufit është që zemrën të rindërtojë, zbukurojë dhe lulëzojë me dhikrin dhe dashurinë ndaj Allahut Teala.

Secili tarikat ka preferuar njërin nga dhikret, qoftë të hapur apo të fshehtë, për të zgjuar zemrat dhe për të përmirësuar njeriun. Ka edhe të tillë që përdorin të dy llojet, paralel.

Çdokush zgjedh dhikrin që i përshtatet natyrës së vet. Dhikri që i përshtatet natyrës së njeriut, edhe nëse është pak, kur bëhet me singeritet dhe në vazhdimësi, është dhikri më i dobishëm dhe me vlerat më të larta.

Tani do të njoftojmë për karakteristikat e përgjithshme të këtyre dy llojeve dhikre.

DHIKRI I FSHEHTË

Në dhikër esencë është fshehtësia, sepse përkujtohet Allahu. E për robin, Ai është më afër se damari i qafës së tij.

Në një rast, kur gjatë udhëtimit, As'habët kënduan *Tekbir*-in me zë të lartë, Resulallahu s.a.v.s. e dëgjoi, dhe kështu i paralajmëroi:

“Mos u lodhni duke ngritur zërin kështu. Ju nuk po thirrni në vesh të shurdhër, e as dikë që është larg. Ju po e bëni dhikër Allahun, i cili dëgjon çdo gjë, të hapur apo të fshehur, është shumë afër juve dhe Ai është me ju kudo që jeni.”⁷⁷

Allahu Teala, duke vështruar zemrën e robit, i di edhe mendimet që kalojnë brenda tij. Në këtë gjendje, nuk ka nevojë të ngritet zëri për t'i shpallur atij diçka. Me rëndësi është që zemra të zgjohet dhe t'i drejtohet Allahut. Dhikri i fshehtë bëhet në dy mënyra. E para - bëhet vetëm me zemër, e dyta - me zemër dhe me gjuhë. Vetëm se, në dhikrin me gjuhë nuk ngritet zëri, pos në atë masë që e dëgjon vetë.

Dhikri i fshehtë është cilësuar nga ana e Resulallahut s.a.v.s. si dhikri më i dobishëm:⁷⁸

⁷⁷ Buhari, Deavat, 50; Muslim, Dhikër, 44; Ebu davud, Salat, 361.

⁷⁸ Ahmed, Musned, I, 172; Ebu Ja'la, Musned, II, 82; Ibnu Hibban, el-Ihsan, Nr: 809.

Edhe *hadithi kudsî* tregon vlerën e veçantë që gjendet në dhikrin e fshehtë.

“Robi që më përmend Mua fshehtas në vete, edhe Unë atë e përmendi në Qenien Time (*dhat*).”⁷⁹

Shehlerët që kanë preferuar dhikrin e fshehtë, kanë filluar punën prej zemrës.

Në etapën e parë bëhet vetëm dhikri me zemër. Për dhikër preferohet fjala ‘*Allah*’. Dhikri bëhet duke mbajtur gjuhëngjitur për qiellzë, dhe me zemër duke thënë ‘*Allah, Allah*’.

Emri ‘*Allah*’ është emri i veçantë i Madhësisë së Krijuesit tonë. Të gjithë *Emrat e Bukurtë* Allahut Teala, si dhe të gjitha kuptimet e tyre përfshihen nën emrin e lavdishëm ‘*Allah*’. Të bëhet dhikër me emrin e lavdishëm ‘*Allah*’ është sikur të bëhet dhikër me të gjithë *Emrat e Bukur*. Pasi që ky dhikër vendoset plotësisht në trup, kalohet në dhikr edhe më të vlefshëm -‘*la ilahe ilallah*’. Vetëm se, dhikri ‘*la ilahe ilallah*’ bëhet me zemër dhe me gjuhë, së bashku, dhe kështu prapë tërë trupi merr pjesë në dhikër.

⁷⁹ Buhari, Tevhid, 15; Muslim, Dhikër, 19,21.

RRUGA E MËSIMIT TË DHIKRIT TË FSHEHTË

Njëri nga të mëdhenjtë e rrugës së nakshive, Shejh Abdulhalik Guxhduvani, në rini merrte mësim tefsiri nga hoxha i tij, Sheh Sadreddin Efendiu. Kur mbërrijtën në ajetin:

“Lutni Rabbin tuaj të përulur e në heshtje, se Ai nuk i do ata që e teprojnë.”⁷-A’rafë:55

Guxhduvani e pyeti hoxhën:

“Efendi! Si bëhet duaja dhe dhikri i fshehtë që përmend ky ajet? Kur dikush bën dua dhe dhikër haptas, njerëzit e dëgjojnë dhe shohin. Por, shejtani e dallon edhe nëse je duke bërë dhikër në vete. Sepse në hadith thuhet:

“Shejtani qarkullon brenda njeriut ashtu si qarkullon gjaku nëdamarë.”⁸⁰*Si i bëhet dhikër fshehtas, e të mos u shfaqesh as njerëzve e as shejtanëve?”*

Hoxha i tij pranoi me habi pyetjen dhe tha:

“O biri im! Ajo është dituri hyjnore (ilmi ledun). Në qoftë se Allahu Teala dëshiron, të takon me ndonjërin nga miqtë e Tij, e ai ta mëson këtë dhikër të fshehtë.”

⁸⁰ Buhari, Ahkam, 21; Ebu Davud, Savm, 78; Ibnu Maxhe, Sijam, 65; Darimi, Rikak, 66; Ahmed, Musned, III, 156, 285.

Abdulhalik Guxhduvani filloi ta pres atë mik. Në fund të pritjes, Allahu Teala e takoi fillimisht me Hidrin a.s., e më pas edhe me arifin e madh Jusuf Hemadanin.

Hidri a.s. ia mësoi Guxhduvanit me rrugë të fshehtë dhikrin *nefj-u isbat: 'la ilahe illallah'*. Ndërsa Jusuf Hemadani punoi në edukimin e tij shpirtëror. Në fund, atë e ngritën të merret me *irshad* të njerëzve.

11 METODAT THEMELORE(USUL)

Abdulhalik Guxhduvani dhe të mëdhenjtë e tjerë që kanë ardhur pas tij, kanë themeluar 11 principe të cilat shërbejnë për edukim shpirtëror, dhe për të mbajtur zemrën vazhdimisht në gjendje të dhikrit.

Këto principe janë cak i moralit për çdo mysliman dhe janë metoda që nevojiten për të gjithë udhëtarët e rrugës së drejtë. Këto metoda, me anë të të cilave fitohet zgjuarsia shpirtërore, janë fryt i dhikrit dhe rezultat i edukimit të bukur.

Ai që zbaton këto metoda sigurisht ka kuptuar esencën e ajeteve që urdhërojnë dhikrin dhe ka arritur myzhden për kuptimin e tyre. Në këtë mënyrë ai ka arritur kënaqësinë e Allahut.

Këto 11 metoda janë:

VUKUF-I ZAMANI

Të jesh i vetëdijshëm për çdo moment që e jeton

Udhëtari i rrugës së drejtë duhet ta kontrollojë çdo sjellje. Në çdo moment duhet të dijë se cila vepër është më e vlefshme dhe ta bëjë atë vepër. Kohën e vet ta kalojë me një lloj të dhikrit. Në qoftë se bën punë të dobishme dhe vepra të mira, atëherë duhet të bëjë shukër (të falënderojë). Shukri është një lloj dhikri. Në qoftë se është zhytur në punë të këqija e të turpshme, menjëherë të bëjë teube-istigfar (të pendohet dhe të kërkojë falje). Edhe istigfari është gjithashtu një lloj i dhikrit.

Të mundohet t'i kompensojë mangësitë e kaluara.

Në mënyrë të veçantë të vështrojë gjendjen e zemrës gjatë frymëmarrjes. Të ketë kujdes se gjatë frymëmarrjes, a është i vëmendshëm në dhikër apo është në pavëmendje. Sufitë e kanë quajtur këtë gjendje *Sahv*(zgjimi), d.m.th. zgjimii gjendjes shpirtërore.

Udhëtari i rrugës së drejtë duhet vazhdimisht ta mendojë veten se gjendet nën shikimin dhe kontrollin e Allahut Teala. Çdo moment të jetë i vetëdijshëm se po i afrohet vdekjes. Të mundohet të zgjohet nga pavëmendja. Nëse nuk mund të zgjohet, ta dijë se një ditë do të zgjohet patjetër.

VUKUF-I ADEDI

Kur bën dhikër, të jetë i vetëdijshëm si bëhetaj, dhe të ruaj numrin (e dhikrave të bërë)

Udhëtari i rrugës së drejtë duhet të kujdeset për numrin e dhikrit që bën. Dhikri duhet të bëhet përshtatshëm mësimit. Duke e ruajtur numrin, një ndër gjërat kryesore është të jetë i vëmendshëm ndaj qetësisë së zemrës. Zemra të mblidhet në dhikër, veçanërisht gjatë dhikrit ‘*La ilahe ilallah*’. Vetja dhe çdo gjë tjetër pos Allahut Teala të harrohet dhe çdo gjë ndërmjet të largohet dhe të mundohet të arrihet shijimi i dhikrit. Gjatë dhikrit të tejkalohetvetjadhe të mundohet të arrihet në tërheqje dhe dalldi hyjnore (xhezbe).Kjo dashuri, kjo tërheqje dhe dalldi hyjnore janë shkalla e parë e diturisë shpirtërore.

VUKUF-I KALBI

Zemra përqendrohet në dhikër dhe lidhet për qenien të cilës i bëhet dhikër

Udhëtari i rrugës së drejtë, brenda kohës së dhikrit të mundohet të përfitojë gjendjen e kënaqësisë së Allahut dhe qetësisë shpirtërore, ashtu që në zemër të mos ketë dashuri apo anim ndaj asgjëje pos Tij. T’i pengojë mendimet e kësaj bote që të shëtisin brenda zemrës. Të arrijë në fshehtësi dhe në thelbin e dhikrit. Vazhdimisht t’i drejtohet zemrës dhe dashurisë brenda zemrës.

Shah-i Nakshibend ka parë se gjëja më e rëndësishme dhe më e nevojshme është përqendrimi i zemrës në dhikër si dhe lidhja e zemrës për Atë të cilit i bëhet dhikri (përkujtohet), pra për Allahun Teala. Shah-i Nakshibendi pa se kjo është më e rëndësishme se vet sasia e dhikrit.

NAZAR BER-KADEM

Shikimi të jetë mbi këmbën e vet

Udhëtari i rrugës së drejtë duhet vazhdimisht të ecë dhe të shikojë përpara. Gjithmonë të jetë i preokupuar me punët e veta. Të ruaj syrin prej haramit dhe zemrën prej gjërave që mund ta turbullojnë. Mos t'i kushtojë vëmendje gjërave që nuk i hyjnë në punë. Ai që syrin nuk e ruan, edhe zemrën e ka të përzier. Kanë thënë: *“Në këtë rrugë ai i cili nuk është serioz, as punët nuk do t'i dalin serioze”*.

Udhëtari i rrugës së drejtë ta ketë në sy vetëm një cak dhe ta përqendrojë zemrën vetëm në atë cak, ndërsa në rrugën që ka hyrë ta japë tërë mundin. Pos Allahut Teala, gjërave tjera mos t'u kushtojë shumë vëmendje. Dikush që shkon drejt cakut duke vrapuar, vazhdimisht duhet të shikojë përpara. Përndryshe këmba merr në thua dhe rrëzohet.

Imam Rabbani thotë:

“Nazari Ber-Kadem - Udhëtari i rrugës së drejtë duhet ta kuptojë figurativisht shprehjen se shikimi i syrit nuk kalon përtej këmbëve të veta. Prej saj është e nevojshme të kuptohet kjo:

Syri vazhdimisht duhet të shikojë përpara ndërsa këmba ta përcjell, sepse në nivelet e larta së pari syri e vendos cakun, pastaj këmba hedh hapin. Njeriu duhet ta vendos syrin në nivelet e larta si dhe ta jep mundin që kërkon ai nivel. Ai që me pak kënaqët, pak fiton. Ai që nuk fluturon, detyrohet të ecë.”

Fjala dhe puna e udhëtarit të rrugës së drejtë duhet të jenë në përputhje me njëra-tjetrën. Ai duhet të flet dhe të sillet brenda gjendjes në të cilën gjendet. Të mos flet për atë që nuk e posedon dhe nuk e di, të mos bisedojë për ato gjendje dhe dituri të cilat nuk i ka shijuar dhe mos t'i konsiderojë këto gjëra si pronë të veten. Duhet ta dijë kufirin e vet dhe t'ia dijë hallin vetes.

Udhëtari i rrugës së drejtë duhet të merr si shembull ata të cilët shkojnë para tij. Ai duhet të falënderohet për gjendjen e vet, atëherë kur sheh të dobëtit dhe ata që janë prapa tij. Po ashtu duhet atyre t'iu tregojë mëshirë dhe t'iu ndihmojë.

Besimtari duhet të jetë modest. Mos të ecë me mendjemadhësi dhe kryelartë. T'i përputhet sunneteve. Të shikojë përpara dhe me shikime të panevojshme mos të shqetësojë askënd.

*Të jetë i zgjuar në çdo frymëmarrje dhe të mos jetë në
gaflet*

Çdo frymë që e merr dhe e lëshon një udhëtar i rrugës së drejtë, duhet ta bëjë me vetëdije dhe i vëmendshëm ndaj Allahut Teala. Tërë kohën e tij ta përdorë në një lloj ibadeti, sepse çdo frymë që kalohet në dhikër bën që robi të jetë në lidhje me Allahun Teala dhe atëherë çdo frymë është e gjallë, jeton, është e ëmbël dhe përplot njohuri. Frymët që harxhohen në pakujdesi dhe në kryengritje janë të vdekura, pa njohuri, pa nur dhe pa shije.

Shah-i Nakshibend thotë:

"Edukimi i rrugës sonë është themeluar në kalimin e çdo momenti, e të çdo frymëmarrjeje në gjendje të zgjuar. Sufiu i zgjuar bile e kalon kohën në mes të dy frymëmarrjeve me dhikër."

Sufitë thonë se kjo punë është shumë e vështirë, mirëpo vetëm ata të cilët janë këmbëngulës dhe ata të cilët kalojnë në dhikrin e qenies (dhikri dhat), e kuptojnë se kjo me të vërtetë mund të ndodhë, për shkak se ata vet e jetojnë këtë gjendje.

Udhëtari i rrugës së drejtë duhet ta vlerësojë çdo moment. Ai nuk duhet të humbas kohë duke u preokupuar me të kaluarën dhe duke ushqetësuar për të ardhmen, por duhet të vlerësojë të tashmen. Puna më e drejtë është të bëjë shpesh istigfar (të kërkojë falje).

SEFER DER VATAN

Të ikësh prej njerëzve, e të shkosh drejt Hakut

Udhëtari i rrugës së drejtë është vazhdimisht në gjendje të lëvizjes dhe të udhëtimit.

Ai duhet të jetë në gjendjen e përshkruar në ajetin

“Unë po shkoj aty ku më urdhëroi Rabbi im, e Ai më udhëzon’.”37-Safatë:99.

Vendi që shkohet është xheneti ndërsa ajo që kërkohet është kënaqësia (rizaja) e Allahut. Për këtë arsye udhëtari i rrugës së drejtë duhet të braktis veset e këqija e të zbukurohet me sjellje të bukura, të braktis haramin e të vrapojë pas hallallit, të kalojë prej kundërshtimit në devotshmëri (takva).

Ky udhëtim bëhet me zemër. Kjo rrugë kalohet me zemër. Pa u zgjuar zemra, nuk mund të shihet përpara, pa u edukuar ajo, nuk mund të njihet Rabbi dhe pa u pastruar zemra nga ndyrësitë shpirtërore, Haku nuk mund të soditet shpirtërisht.

Për këtë arsye, ai që do t'i shkojë Hakut, më parë duhet të gjejë një prijës të besueshëm. Gjëja e parë që duhet ta ketë është murshidi. Nën kontrollin dhe edukimin e tij, të realizojë ngritjen shpirtërore të zemrës.

Udhëtari shpirtëror dhe zemra e tij pastrohen me edukim shpirtëror. Zemra forcohet me dashuri hyjnore dhe zgjuarsi. Cilësitë e këqijandërrohen me ato të mira. Kështubëhethapi prej syfaqësisë-në sinqeritet, prej pakujdesisë - në dhikër, prej zullumit - në drejtësi, prej kundërshtimit - në adhurim. Kësaj në të vërtetë i thuhet *'hixhret'* apo *'të shkosh drejt Allahut Teal'*.

Realizimi i këtij hixhreti është pikërisht qëllimi i tasavvufit.

Gjithashtu duhet të dihet se udhëtari i rrugës së drejtë nuk duhet të qëndrojë vetëm në një gjendje. Vazhdimisht duhet të merr rrugë në të mira, të përparojë në moral të bukur dhe të ngritët shpirtërisht. Në rrugën e drejtë, udhëtimi është i vazhdueshëm dhe nuk bën të ndalet, të mërzhitet apo të ulet.

HALVET DER- ENXHUMEN

*Duke qenë në mesin e njerzëve të jesh bashkë me
Hakun*

Kësaj i thuhet: të jesh në të jashtmen (zahir) me njerëzit e në të brendshmen(batin) me Hakun.

Udhëtari i rrugës së drejtë duhet ta ketë zemrën përplot me shije të dhikrit hyjnor dhe çdo gjë t'i bëhet shkak për ta përkujtuar Allahun Teala. Mos të lejojë që krijesat të bëhen perde e zemrës, porçdo gjë të jetë në vend të vet sipas vlerës që ka.

Kur zemra e njeh Rabb-in e lartë dhe i soditë shpirtërisht manifestimet e Tij, asnjë krijesë tjetër nuk mund t'i bëhet perde, nuk mashtrohet, nuk humb kohë dhe nuk gjen rehati me gjëra të tjera.

Shejh Nexhmeddin Kubra thotë:

“Dy dhikra në një vend nuk mund të gjenden. Ai që vazhdimisht bën dhikër (përmend) një send apo një dert, ai në të vërtetë nuk mund ta bëjë dhikër Allahun Teala. Ndërsa zemra e atij që e bën Allahun dhikër, nuk ka vend për gjëra të tjera.

Pejgamberi s.a.v.s. vazhdimisht e bënte dhikër Allahun Teala. Për pejgamberët dhe velitë, dhikri është një punë normale, për shkak se të gjitha sjelljet dhe punët i bëjnë me Hakun dhe i përshtaten urdhrave të Hakut. Qëllimi i dhikrit është që zemra të gjejë kënaqësi me Allahun.”⁸¹

Piri i rrugës nakshiShah-i Nakshibend thotë:

“Esenca e rrugës tonë është halvet der-enxhumen” dhe shton: “Themeli i tarikatit tonë është sohbeti -bashkëbisedimi. Largimi prej njerëzve sjell famën ndërsa në famë gjendet shkatërrimi. Mirësia është të jesh në mesin e njerëzve dhe t’u bësh njerëzve hizmet. Veçanërisht, hizmeti me sohbet bëhet më i mirë. Hizmeti dhe sohbeti duhet ta forcojnë dhe plotësojnë njëri-tjetrin. Edhe udhëtarët e kësaj rruge duhet ta duan njëri-tjetrin, në atë mënyrë që të shkrihet/humbet në atë dashuri.”

⁸¹ Nexhmeddin-i Kubra, Jeta në Tasavvuf, faqe 58.

Ky moral i miqve të Allahut është shpjeguar në Kur'an- i Kerim me këtë ajet:

"Ata janë njerëz që nuk i pengon as tregtia e largët e as shitblerja në vend për ta përmendur Allahun, për ta falur namazin dhe për ta dhënë zeqatin."24-Nurë:37.

YADKERD

Të bësh dhikër

Me këtë synohet të tregohet se pasi të përvetësohet mësimi i vetëkontrollit, vazhdohet të bëhet dhikri '*la ilahe ilallah*' në mënyrë që të arrihet në kuptimin e tehvidit. Allahu Teala vazhdimisht duhet të mbahet në kujtesë dhe dhikri i zemrës me atë të gjuhës të bashkohen.

Udhëtari i rrugës së drejtë në çdo moment duhet ta ketë zemrën e zgjuar. Me vëmendje të plotë të vazhdojë dhikrin me fjalën '*Allah*' ose '*la ilahe ilallah*'.

Shah-i Nakshibend kështu e shpjegon kuptimin e dhikrit tevhid:

'La ilahe' është shprehje e *nefij-it*. *Nefij* do të thotë mohim apo refuzim. Me këtë dhikër bëhet e ditur se në gjithësi nuk ka asnjë 'ilah'. Pas kësaj vjen shprehja '*ilallah*'. Kjo shprehje është *isbat* e që do të thotë vërtetim apo dëshmi. Me anë të kësaj dëshmohet se 'ilah'i vërtetë dhe që i bëhet ibadet është vetëm Allahu Teala.

Në fund thuhet ‘*Muhammedu’r Resulullah*’. Me anë të kësaj bëhet nijet që t’i përshtatemi Resulullahut s.a.v.s. në mënyrë që të duhemi nga Allahu Teala si dhe të tregojmë dashurinë ndaj Tij. Kjo për shkak se pa iu përshtatur Resulullahut s.a.v.s. as tevhidi nuk merret vesh e as dashuria (muhabeti) i Allahut Teala nuk shijohet.

BAZ GESHT

Kthimi

Me këtë dëshirohet të tregohet se duke bërë ‘*nefijisbat*’– pra dhikrin ‘*lailahe ilallah*’, në momentin që lëshohet fryma, të gjitha mendimet duhet të përmbliidhen në kuptimin e fjalisë ‘*ilahi ente maksudi ve ridhake matlubi*’ (Allahu im, qëllimi im je Ti dhe kënaqësia Jote është kërkesa ime).

Më pastaj, duke i parë mangësitë gjatë dhikrit, kërkohet strehim tek Allahu Teala dhe bëhet istigfar.

NIGAHDASHT

Të ruhet

Udhëtari i rrugës së drejtë duhet të jetë zotërues i zemrës gjatë dhikrit. Gjatë dhikrit duhet të mendohet kuptimi i *nefjit* dhe *isbatit*, si dhe duhet të ruhet zemra nga dëshirat e mendimet e këqija, apo nga brengat e shqetësimet e ndryshme. Duhet ta pengojë zemrën prej mendimeve dhe dëshirave të tjera pos Allahut Teala.

JAD DASHT

Kurrsesi mos të harrohet, vazhdimisht të bëhet dhikër

Udhëtari i rrugës së drejtë në çdo moment dhe në çdo vend të jetë bashkë me kënaqësinë (rizanë) e Allahut Teala. Asnjëherë nuk duhet të ndahet prej kënaqësisë hyjnore. Zemra duhet të mbahet zgjuar duke soditur shpirtërisht manifestimet hyjnore në çdo gjë.

Të gjitha këto shpjegime janë cilësi të besimtarëve të vërtetë. Ata kanë jetuar dhe ende jetojnë.

Sufitë kanë thënë:

Nëse një njeri për një javë mundohet të bëjë dhikër me zemër për 15-30 minuta në ditë, të mos bëjë gjynahe të mëdha dhe të mos hajë kafshatat haram, pas një jave patjetër se e sheh dobinë; heton se në zemër bëhet një zgjim.

Shejh Sejid Abdulbaki el-Hysejni thotë:

"Vazhdoni të përmendni Allahun Teala, dhe të jeni të zgjuar kur bëni dhikër. Qëndisni dhikrin e Allahut brenda zemrës. Pasi të vendoset dhikri në zemër, edhe nëse nuk mendoni për këtë, zemra e bën Allahun dhikër. Lukthi juaj punon edhe kur ju nuk doni. Edhe në gjumë kur jeni, ai vazhdon punën e vet. Edhe me zemër ndodh e njëjta, atëherë kur dhikri të jetë vendosur në zemër."

SQARIMI I DISA METODAVEBAZË

Disa nga metodatqë shkurtimisht i shpjeguam më lartë, e interesojnë çdo mysliman, në çdo kohë. Për këtë arsye duam t'i hapim ato me dëshmidhe me shembuj.

NË ÇDO MOMENT TË VËREJMË SE AI ËSHTË ME NE

“Ne jemi më afër tij se damari i qafës së tij.”

50-Kaf:16.

Allahu veçanërisht pona paralajmëron:

“Ai është me ju kudo që jeni, Allahu sheh gjithçka që punoni.”57-Hadidë:4.

Pse ne nuk e dallojmë kur Rabbi jonë është aq afër? Çka është shkaktar i pavëmendjes (gaflet)tonë dhe si largohet ky gaflet?

Mos të harrojmë se dhikritregon vlerën e dashurisë, e dashuria tregon nivelin e mendjes.

Dikush që humb kohë me dashurinë e një krijese që vdes, dhe mundohet me dertin e asaj krijese, zemra e tij vdes. Më i mençuri dhe më i ndershmi prej njerëzve është ai që e do Allahun Teala, që preferon dashurinë dhe dhikrin e Tij ndaj çdo gjëje tjetër; sepse ai ka zgjedhur një dashuri të përjetshme, një mik të përhershëm.

Ju lumtë këtyre njerëzve! Allahu Teala kështu na njofton për këta njerëztë mençur:

“Për ata që Allahun e përmendin me përkujtim kur janë në këmbë, kur janë ulur, kur janë të shtrirë dhe thellohen në mendime rreth krijimit të qiejve e të tokës (duke thënë) Rabbi ynë, këtë nuk e krijoje kot, i lartësuar qofsh, ruana prej dënimit të zjarrit.”

3-Ali Imran: 191.

Fahruddin Radhiu r.ah. thotë:

“Një zemër vetëm me dashurinë e Allahut Teala ringjallet, me atë dashuri gjen jetë, me dhikër arrin në qetësi”, dhe shton:

“Nëse njeriu me gjuhë bën dhikër, me gjymtyrët e trupit bën shukër (falënderohet), me zemër thellohet në mendime, dhe me tërë qenien e vet vazhdimisht adhuron Allahun atëherë ai bëhet kamil (i përsosur)”⁸²

Në një ajet tjetër, Allahu Teala kështu i përshkruan ata që janë në çdo moment në këtë gjendje:

“Ata janë njerëz që nuk i pengon as tregtia e largët e as shitblerja në vend për ta përmendur Allahun, për ta falur namazin dhe për ta dhënë zeqatin, ata i frikësohen një dite kur do të tronditen zemrat dhe shikimet.”²⁴-Nurë:37.

⁸² Razi, Mefatihul-Gajb, IX, 110.

Në komentimin (tefsirin) e këtij ajeti, Allame Alusi thotë:

“Shumica nga tarikatet, e sidomos të mëdhenjtë e tarikatit Nakshibendi, kanë arritur gjendjen e dhikrit të vazhdueshëm, të përmendur në këtë ajet, ndërsa arritjen e kësaj ia kanë vënë vetes si qëllimin më të madh. Aq fuqishëm është vendosur ky dhikër në zemrat e tyre sa që në asnjë moment nuk kanë qenë të pavëmendshëm (gafil) ndaj përmendjes (dhikrit) të Allahut Teala.”⁸³

Ky edukim nuk bëhet pa shejh dhe pa përkrahje. Nuk mësohet vetëm duke lexuar libra.

Kjo lumturi dhe ky nder, nuk përfitohet pa besim dhe pa e bërë atë që kërkohet.

⁸³ Alusi, Ruhu’l-Meani, xhild: IX, Xhyz: XVIII, 378.

NAZAR BER KADEM
Shikimi të jetë mbi këmbën e vet

Sufitë i kanë dhënë shumë rëndësi syrit dhe zemrës. Qëllimi kryesor i çdo njeriu, dashuria e vërtetë, caku që dëshiron të arrijë, është i fshehur në zemrën e tij.

Zemra, është ajo, vlera e të cilës nuk mund të matet. Sepse zemra është një vend shumë i veçantë në gjithësi, të cilin e vështroi Allahu Teala.

Njeriu, me zemër e njeh Allahun Teala, e dodhe e ndjen afërsinë e tij.

Syri është dritare e hapur e zemrës dhe lajmëtari i saj. Zemra ndikohet më së shumti nga syri. Çdo lëvizje e syrit bën që të interesohet zemra. Për shkak të syrit zemra fiton dhe humb shumëçka. Zemra gëzohet ose pikëllohet nga gjërat që vijnë prej syrit. Për këtë arsye, ai që mendon për zemrën, duhet ta ruajë syrin.

Miqtë e Allahut Teala kanë paralajmëruar të gjithë udhëtarët e rrugës së drejtë me këtë çështje. Miqtë e Allahut ju kanë mësuar atyre disa metodapër të arritur në këtë cak. Këto metoda janë marrë nga edukimi i Kur'anit dhe sunnetit. Të gjitha këto, për qëllim kanë kënaqësinë e Allahut Teala, e interesojnë secilin prej së afërmi. Njëra nga këto metoda është edhe *Nazar ber Kadem*.

Nazar ber Kadem është një shprehje persisht, që ka kuptimin: shikimi mbi këmbën, syri të shikojë përpara.

Nazar është shikimi i zemrës. *Nazar* është ndryshe nga natyra e shikimit të syrit. Në *nazar* ka nijet dhe sinqeritet. *Nazar* është një drejtim me qëllim në zemër.

Ky drejtim, nëse bëhet mirë jep përfundim të mirë, e nëse bëhet keq jep përfundim të keq.

Përshebull, shikimi i miqve të Allahut ringjallë zemrën, e shikimi i ziliqarit shkrinë eshtrat. Njëra lumturi, e tjetra fatkeqësi.

Kadem do të thotë këmbë dhe hap. Ecja, hapi – e tregon sjelljen. Kjo ka kuptimin të vendoset hapi me kujdes, të kemi kujdes në ecurinë e punëve dhe sjelljeve, të mos bëhen punë të dyshimta. Ajeti në vazhdim ka këtë kuptim:

“Mos ndiqni hapat e shejtanit.”2-Bekare:208.

Kadem sjell kuptimin edhe të fatit edhe të bereqetit. Për dikë që bëhet sebeb (shkak) për bereqet dhe rehati, thuhet ‘*i erdh kademi me fat*’.

Kadem sjell ndër mend edhe drejtpeshimin, sigurinë dhe durimin. Për dikë që nuk e kthen fjalën, që është i sigurt dhe i durueshëm në punë, që është i besueshëm, thuhet ‘*ai është një njeri në kadem konstant*’.

Shehlerët, me shprehjen *Nazar ber Kadem* dëshirojnë t'i tregojnë udhëtarit të rrugës së drejtë edukatat që i takojnë, si të brendshme ashtu edhe të jashtme.

Kjo mund të përmbliidhet në këtë mënyrë:

Nazar ber Kadem është- të ecësh vazhdimisht me edukim. Udhëtari i rrugës së drejtë duhet të ketë kujdes shikimin e vet, të jetë i edukuar, të bëj hapa të qetë, dhe të ikë nga gjendjet dhe lëvizjet e papëlqyera dhe nga mendjemadhësia.

Resulallahu s.a.v.s., që është rahmet për gjithësinë, duke ecur nuk shikonte majtas e djathtas. Ai shikonte përpara dhe ecjen e kishte shumë stabile dhe të drejtë. Nuk ecte duke u tundur. Ai ecte sikur të kishte zbritur nga një vend i lartë.

Kur i drejtohej dikujt, ai nuk kthente vetëm kokën, por i drejtohej atij me tërë trupin.

Nuk thërriste askënd nga mbrapa dhe nga largësia, por bisedonte me ta kur vinte afër.

‘Nazar ber Kadem’është të hiqet syri dhe zemra nga harami. Udhëtari i rrugës së drejtë duhet të ruajë syrin nga harami dhe nga gjërat që mund ta tundin zemrën.

Nuk duhet dhënë rëndësi gjërave që nuk i interesojnë zemrës.

Atij që nuk mund të mbrojë syrin nga harami, zemra i mbetet e varfër nga dashuria hyjnore. Ai që nuk është serioz në këtë rrugë, nga ai punë serioze nuk del. Allahu Teala neve na ka dhënë këtë urdhër:

“Thuaj besimtarëve të ndalin shikimet prej haramit, të ruajnë pjesët e turpshme të tyre se kjo është më pastër për ta. Allahu është i njohur hollësisht për atë që bëjnë ata.” 24-Nurë:30-31.

Resulallahu s.a.v.s. na ka përshkruar se të shikohet harami është sikur shejtani të vendos një shigjetë me helm në zemër. Ka vetëm një rrugë të mbrohet zemra nga helmi dhe dëmi i këtyre shigjetave – me mbrojtjen e syrit/shikimit. Për këtë arsye, duhet mbrojtur syri nga ekspozimet dhe format e ndryshme që bëjnë zemrën gur. Ai që nuk mund të mbrojë syrin dhe gjuhën nga harami, ai nuk mund të bëhet evlia.

Nazar ber Kademështë të drejtuarit mikut të përherëshëm. Udhëtari i rrugës së drejtë, duhet ta dijë me kë të bëhet shok i gjendjes dhe rrugëtimit. Udhëtari duhet ta njoh mirë atë pas të cilit shkon. Për shok duhet të zgjedh atë që ka zemrën e zgjuar, që është i edukuar dhe i moralshëm. Duhet të largohet prej fitnexhiut, xhahilit dhe prej atyre që haptas bëjnë haram.

Nazar ber Kadem është të merresh me gjendjen e vetvetes.Udhëtari i rrugës së drejtëduhet vazhdimisht të kontrollojë rrugën e vet dhe moralin e vet. Ai duhet të kërkojë gabimet dhe të metat në punët e veta, të shikojë se si vepron ai në ibadet.

Kur shikohen gabimet e tjetërkujt, zemra shpërndahet dhe njeriut i mbyllet rruga shpirtërore.

Ai që lyp kënaqësinë e Allahut Teala, sapo i bie në sy një gabimi një vëllaibesimtar, menjëherë duhet t'i drejtohet vetes, sa herë që është dëshmitarduhet të mendojë për gabimet e veta, të bëj istigfar për gjendet e këqija, të zgjohet nga gafleti dhe të merret me përmirësimin e gjendjes së vet.

Kur shihet gabimi te vëllaibesimtar, duhet të mendohet se ka ndoshta një arsyetim. Në qoftë se ai besimtarvazhdon në gabim, ai duhet të paralajmërohet me mëshirë, dhe t'i lutet Allahut Teala për falje.

Nazar ber Kadem është të orientohe mi vetëm te një qëllim.Udhëtari i rrugës së drejtë syrin dhe zemrën duhet t'i fokusojë në një pikë, të intensifikojë punën, të kyçet në qëllim.

Çdobesimtar që dëshiron të ketë sukses në dynja dhe në ahiret, duhet ta përfitojë këtë gjendje. Përndryshe mbetet në rrugë. Nëse mendja, mendimet, zemra dhe trupi/kallëpi nuk orientohe në të njëjtën pikë, gjithë puna e besimtarit mbetet pa fryt. Nëse zemra dhe trupi nuk bashkohen, as ibadeti nuk bëhet i ëmbël, shërbimi nuk ka sukses, puna nuk jep përfundim të mirë.

Qëllimi i vetëm i udhëtarit të rrugës së drejtë duhet të jetë kënaqësia (rizaja) e Allahut Teala. Tërë vullnetin dhe mundin duhet ta përdorë në këtë rrugë. Përpos Allahut Teala, ai nuk duhet t'i japë rëndësia të ketë interesim në gjëra tjera. Ai nuk duhet të pres ndonjë gjë nga njerëzit për shkak të ibadetit, dhikrit dhe shërbimit të vet. Bile, as për mirësitë e ahiretit nuk duhet të mendojë! Dhe çdo bamirësi që bën, duhet ta bëjë vetëm për kënaqësinë dhe dashurinë e Allahut Teala.

Nazar ber Kadem - e brendshmja dhe e jashtmjaduhet të jenë një. Fjala dhe puna e udhëtarit të rrugës së drejtë duhet të jenë një (të njëjta).

E brendshmja e miqve të Allahut Teala është e bukur, siç është e bukur e jashtmjja e tyre. Bile, e brendshmja e tyre është edhe më e bukur dhe ata posedojnë një gjendje të veçantë. Ata që preferojnë këtë botë në vend të Ahiretit, të jashtmen e kanë të zbukuruar, kurse të brendshmen të shkatërruar.

Nazar ber Kadem - vazhdimisht në lëvizje dhe në ngritje. Udhëtari i rrugës së drejtë duhet të ngritet hap pas hapi në ibadet, në detyrë dhe hizmet, e nuk duhet të ngel në një pikë.

Hadithi **“Është dëm që dikush të mbetet i njëjtë nëdy ditë të ndryshme”** është paralajmërim për ata që rrugëtojnë në rrugën e së vërtetës dhe që dëshirojnë të fitojnë lumturinë e përhershme. Sepse, në njohjen e

Allahut Teala, nuk ka fund për gradat shpirtërore(makam) dhe edukimet e bukura.Ky udhëtim vazhdon deri në vdekje, e në ahiret vazhdon në tjetër mënyrë.

Ibadeteve që bëhen çdo ditë nuk u ndërrohet sasia vazhdimisht, por dashuria në zemër, qetësia, kënaqësia, edukimi, mënyra e drejtimit Allahut Teala, në çdo moment mund të ndryshohen dhe shtohen.

Të gjitha detyrat, edhe nëse janë pak, duhet të bëhen vazhdimisht. Puna nuk përfundon pa u filluar, pa e bërë hapin nuk mund të vrapohet.

Udhëtari i rrugës së drejtë duhet të merr si shembull ata të cilët shkojnë para tij. Ai duhet të falënderohet për gjendjen e vet atëherë kur sheh të dobëtit dhe ata që janë prapa tij. Po ashtu duhet që atyre t'iu tregojë mëshirë dhe t'iu ndihmojë.

‘Nazar ber Kadem’ - hapi duhet tëbëhetsigurt.Udhëtari i rrugës së drejtë duhet të ketë shumë kujdes se a përputhen a jo veprimet dhe gjendjet e tij shpirtërore me Kur'an dhe sunnet, pra me shariat. Sepse, asnjë mendimi, pune, gjendje dhe ecurie nuk i del përfundimi te Allahu Teala, nëse nuk i përputhet edukimit të Muhammedit s.a.v.s.. Pa besim të bindur nuk bëhen as veprat e pastra.

Udhëtari i rrugës së drejtë nuk duhet të ketë ndonjë besim tjetër pos besimit të Ehl-i Sunnetit. Të gjitha gjendjet shpirtërore që përfiton në kohën e sejr-u

suluk, mund t'i pranojë vetëm kur i kontrollon ato me Kur'an dhe sunnet. Të gjitha gjendjet shpirtërore, kuptimet, shpjegimet, përshkrimet që nuk përputhen me Kur'an dhe sunnet duhet të hidhen.

Nazar ber Kadem -duhet t'i përshtatet udhëzuesit. Gjatë edukimit shpirtëror, Udhëtari i rrugës së drejtë duhet të drejtojë shikimin dhe zemrën kah shejhu (murshidi kamil). Ai duhet të përcjellë mirë hapat e tij, duhet të përmbush urdhrat dhe këshillat e tij, dhe nuk guxon të dalë nga metodat dhe rruga që i ka përcaktuar shejhu.

Muridi duhet ta dijë se pa ndjekur vijën e shejhut, ai vetë nuk mund të arrijë në qëllim.

Kademi i muridit duhet të përshtatet me kademën e shejhut. Kademi i shejhit është gjendja dhe morali i tij. Kësaj i thuhet edhe *meshreb*.

Meshrebdo të thotë *burimi ujit*. Për udhëtarin e rrugës së drejtë, i vetmi burim ku mund të merr ujë është shejhu i tij. Edhe po të ishte gjithë bota plot shehlerë, udhëtari i rrugës së drejtë zemrën duhet ta orientojë vetëm kah shejhu i vet. Dikush që e orientojnë zemrën herëte një shejh, e herë te tjetri, që i drejtohet cilit do shejhpër çdo gjë që dëgjon dhe shikon, nga asnjëri nuk mund të përfitojë si duhet, vetëm se zemra i shpërndahet, mbetet në rrugë.

Shah-i Nakshibend deri sa ishte në edukim teshejhui vet Sejid Emir Kulal, një ditë shejhu e dërgoi për një punë. Në rrugë, përpara i doli Hidri a.s., dëshiroi

të bisedojë me të dhe t'i bëhet shok në rrugëtim. Shah-i Nakshibend nuk tregoikurrfarë interesimi për të, dhe nuk iu afrua për shoqëri në rrugë. Hidri a.s. i tregoi se kush ishte, e Shah-i Nakshibend i tha:

“Unë e di që ti je Hidri. Por unë nuk mund të bëj muhabet me ty. Unë kam vetëm një zemër, dhe atë ia kam dorëzuar murshidit tim, Sejjid Emir Kulalit. Unë nuk kam tjetër zemër dhe dashuri, që t'i jap dikujt tjetër. Ti shiko punën tënde, e unë timen.”

Në kthim, ia tregoi këtë gjendje shejhut, i cili mbeti i kënaqur.

Nazar ber Kadem është të mbesësh me edukim dhe modesti në të gjitha gjendjet.Udhëtari i rrugës së drejtë, duke ecur përpara shpirtërisht, duhet të mbrohet nga të këqijat. Për këtë arsye ai duhet të mbështetet në edukim në çdo gjendje,ta ul kokën, të strehohet te Allahu Teala prej mendjemadhësisë. Sa koka janë ulur kur, pas një suksesi,ia kanë përshkruar atë suksesvetes dhe janë ngritur lartë para njerëzve.

Shehlerët thotë qëatij që i shtohet dituria, por jo edhe edukimi, atij i shtohet largësia prej Allahut Teala.Atij që, duke iu shtuar ibadeti nuk i shtohet modestia, ai mund të mbytet në lumin e mendjemadhësisë.

Njeriu duhet të mendojë përfundimin, qysh prej fillimit. Për këtë arsye duhet të jetë vazhdimishtnë lutje. Zemra duhet të jetë në frikë dhe shpresë. Mirë është që shpresa të jetë më e madhe se frika, mirëpo të thuhet

‘unë shpëtova, xhenetin e kam të garantuar, e të tjerët u shkatërruan’, është një rrezik i vërtetë.

Udhëtari i rrugës së drejtë nuk duhet t’i besojë ibadetit dhe punëve të tij, por duhet t’i besojë rahmetit të Allahut Teala. Duhet të dihet se një rrugë nuk mund të merret i vetëm, pa ndihmën hyjnore. Në këtë rrugë, është pasuri e vërtetë të mos shihet vetja si një ekzistencë. Ka shumë mësim për ata që shkojnë pas të dërguarit për të gjitha botët, Muhammedit s.a.v.s., i cili për çdo ditë bënte istigfar nga njëqind herë. Rruga që shkon te Allahu Teala, fillon me këtë edukim, dhe me këtë edukim vazhdon. Ky edukim nuk braktiset në asnjë kohë. Ai që e braktis edukimin, mbetet i pa-edukuar.

Mësuesi ynë, Muhammedi s.a.v.s., gjatë udhëtimit të Miraxhit, për çdo çështje i është mbështetur këtij edukimi.

Imam Suhreverdi kështu tërheq vëmendjen për këtë edukim të rëndësishëm:

“I gjithëedukimi mësohet prej Resulallahut s.a.v.s.; sepse Resulallahu s.a.v.s. është burimi i të gjitha edukimeve të jashtme dhe të brendshme.”

Allahu Teala, për edukimin e tij në prani hyjnore në natën e Miraxhit, kështu na lajmëron:

“Shikimi (i Muhammedit) as nuk lakoi eas nuk tejkaloi.”53-Nexhm:17.

Duke u ngritur në prani hyjnore, zemra e shenjtë e Muhammedit s.a.v.s. ka qenë plotësisht e lidhur me

Allahun Teala. Në ato grada të larta, syri nuk i rrëshqiti as majtas e as djathtas, vazhdimisht duke shikuar përpara, nga modestia dhe edukimi, vazhdimisht është djersitur karshi bukurive që arriti, kokën ka mbajtur të ulur përpara, dhe duke kaluar të gjitha makamet në këtë gjendje, është marrë në prani hyjnore. Gradat shpirtërore dhe bukuritë që arriti, vetëm se ia shtuan modestinë dhe edukatën e tij.

Kështu janë edhe sufitet që shkojnë rrugës së tij.

Dikë që nuk e ruan edukimin, ata e kthejnë në vendin nga ka ardhur.

Udhëtari i rrugës së drejtë, me edukim i afrohet Hakut. Në çdo kalim dhe stacion të kësaj rruge, vetëm një shkrim gjendet i varur:

‘Edeb Ja Hu’

HALVET DER ENXHYPHEN

Në mesin e njerëzve - me Hakun

Halvet Der Enxhymen. është një shprehje persisht. *Halvet* do të thotë *vetmi, i vetmuar*, kurse *Enxhymendo* të thotë *shumë njerëz, kallaballëk, popull*. Kuptimi është që, duke qenë në mesin e njerëzve të jesh bashkë me Hakun Teala. Kësaj i thuhet të jesh në të jashtmen me njerëzite në të brendshmen me Hakun.

Kjo është një shprehje e shkurtë, por me shumë kuptime të fshehura brenda. Me këtë shprehje, dijetarët kanë tërhequr vërejtjen se te udhëtari i rrugës së drejtë

duhet të gjinden edukimet, si të brendshme, ashtu edhe të jashtme.

Halvet do të thotë të tërhiqesh në vetmi, të largohesh nga njerëzit dhe të drejtohesh kah bota jote e brendshme.

Ka dy lloje të halvetit: i jashtëm dhe i brendshëm.

Halveti i jashtëm është mbyllja në një vend duke u larguar nga njerëzit, tërheqja në vetmi për të zgjuar zemrën dhe për të gjetur afërsinë e Allahut.

Halveti i brendshëm është kur prej njerëzve largohemi me zemër, por jo edhe me trup, zemrën e lidhim me dhikrin e Allahut Teala, në çdo veprim kërkojmë kënaqësinë hyjnore dhe tërë kënaqësinë e gjejmë në dhikër.

Në fillim, të qartësojmë këtë: principi që në mes të njerëzve të jemi me Hakun është një detyrë që na mëson Kur’ani dhe sunneti. Kjo është një cilësi e besimtarëve të përkryer, miq të Allahut Teala. Është moralii vërtetë i të mençurve. Mashkull a femër, secili besimtar është i ftuar në këtë edukim, sepse në të janë të fshehura dashuriadhe miqësia hyjnore. Resulallahu s.a.v.s., para nesh ka vendosur këtë kriter:

“Ndokush që dëshiron të dijë se sa është i dashur dhe i çmuar tek Allahu Teala, le të shikojë se sa i

bën dhikër dhe sa e lartëson ai Allahun Teala. Allahu e vlerëson robin e tij sipas gjendjes së zemrës.”⁸⁴

Allahu Teala kështu lavdëron zemrat e ngjallura të robërve Tij:

“Ata janë njerëz që nuk i pengon as tregtia e largët e as shitblerja në vend për ta përmendur Allahun, për ta falur namazin dhe për ta dhënë zeqatin.”24-Nurë:37.

Allahu Teala,këtë e pret nga të gjithë ne:

“O besimtarë, përmendeni shpesh Allahundhe lavdërojeni Atë në mëngjes dhe në mbrëmje!

Është Ai që ju bekon, ndërkohë që melaiket e Tij luten për ju,me qëllim që Ai t’iu nxjerrë nga errësira në dritë.Ai ështëMëshirues ndaj besimtarëve.”

33-Ahzabë:41-43.

As’habi i madh dhe prijësi i komentuesve të Kuranit, Ibn Abbas r.a.,kështu e qartëson të bërit shpesh dhikër, që përmend ajeti më lartë:

“Allahu Teala ka caktuar një kohë dhe formë për të gjitha ibadetet që janë farz. Për mosbërjen e tyre Ai ka pranuar disa arsye time.Por dhikri nuk është i tillë.

Allahu Teala nuk ka caktuar një kufizim për dhikrin. Vetëm ata që kanë humbur mendjen mund ta

⁸⁴Hakim, Mustedrek, I, 494; Ebu Ja’la, Mysned, Nr: 1866; Bejhaki, Shuabu’l-Iman, Nr:528

braktisin dhikrin, të tjerëve nuk iu pranohet ndjesa. Allahu Teala, për të gjithë neve urdhëron:

“Kur të kryeni namazin përmendni Allahun, kur jeni në këmbë, ulur, të mbështetur.”4-Nisaë:103.

Kjo ka këtë kuptim: Ditën,natën,në tokë,në det, në vendbanim, në udhëtim, në pasuri, në varfëri, në rehati, në gjendje të shëndetit të mirë dhe në sëmundje, haptas dhe fshehtas, në çdo gjendje bëni dhikër Allahun.Lartësoni Atë mëngjes dhe mbrëmje. Nëse kështu veproni, Allahu Teala ju mëshiron, ju fal gjynahet, dhe melaiket vazhdimisht bëjnë dua dhe istigfar për ju.”⁸⁵

Ta përkujtojmë edhe hadithin që preferon dhikrin në çdo gjendje:

“Kush ulet në një vend, dhe aty Allahun e Madhëruar nuk e bën dhikër, kjo është një mangësi e tij, dhe tek Allahu është një shkak për vërejtje.

Kush shtrihet në një vend, dhe aty Allahun e Madhëruar nuk e bën dhikër, kjo është një mangësi e tij, dhe tek Allahu është një shkak për vërejtje.

Kush ecë në një rrugë, dhe gjatë ecjes Allahun e Madhëruar nuk e bën dhikër, kjo është një mangësi e tij, dhe tek Allahu është një shkak për vërejtje.”⁸⁶

⁸⁵ Ibnu Kesir, Tefsir, VI, 433; Sujuti, er-Dyrry’l-Mensur, VI, 619.

⁸⁶ Ahmed,Mysned, II, 432; Ibnu Hibban, Sahih, Nr:589.

Pra,kjo është gjendja e të qenit në mesin e njerëzve e me Hakun, siç e shpjegojnë ajetet dhe hadithet. Shehlerët kësaj i kanë shkuar pas, dhe kanë përdorur të gjitha mundimet për ta arritur këtë gjendje. Muridi ka nevojë për këtë edukim, e jo për tëzbuluar fshehtësitë(keshf) dhe për mrekulli hyjnore (keramet).

Ebu Said Harradh thotë:

“Nuk do të thotë që nga njeriu i përkryertëshfaqen keramete të ndryshme. Njeriu i përkryer i vërtetë ulet në mesin e njerëzve, bën tregti me ta, martohet e bëhet me fëmijë, përzihet me njerëz, por për asnjë çast nuk është i pavëmendshëm(gafil)ndaj Allahut Teala.”⁸⁷

Shehlerët që kanë preferuar dhikrin e fshehtë, janë ndalur shumë në këtë princip. Sipas tyre, të jesh me Hakun në mesin e njerëzve realizohet në dy mënyra; e para me zemër dhe e dyta me trup. Kjo nuk mund të kuptohet nëse zemra nuk zbukurohet me dhikër e trupi me edukim. Me qëllim që zemra vazhdimisht të bëjë dhikër Allahun Teala, ajo duhet të zgjohet nga gafleti dhe të mësojë dhikrin.

Për këtë arsye, pasi të bëhet një teube e singertë, duhet vazhduar dhikri sipas metodës së caktuar.Duke insistuar në dhikër, zemra mësohet me të e dhikri vendoset në zemër. Pastaj dhikri zgjerohet në tërë trupin. Edhe pa i përdorur fjalët e dhikrit, zemra fillon të bëjë dhikër Allahun Teala. Nuri i dhikrit e

⁸⁷ Abdulmexhid el-Hani, el-Kevakiby’d-Dyrrijje, 364

mbështjellë zemrën. Kështu që robi, me gjithë qenien e tij e ndien Madhësitinë e Allahut, e sheh fuqinë, manifestimet dhe rahmetin e tij. Këtë dhikër, shehlerët e quajnë '*dhikri dhati*' ose '*dhikri sulltan*'. Pa arritur zemra në këtë gjendje, ajo nuk mund të përfitojë dituritë shpirtërore.

Me dhikrin në zemër, fshihen dhe largohen mendimet boshe, dyshimet dhe vesveset. Brendësia e zemrës ndriçon me nurin e dhikrit. Zemra begatohet me begatitë e dhikrit, shijohet me shijen e tij. Më në fund, gjithçka bëhet shkak për një lloj dhikri.

Kur zemra e njeh Rabbin e Lartë dhe i bën suditje shpirtërore manifestimeve të Tij, asnjë krijesë tjetër nuk mund t'i bëhet perde.

Një zemër që është ngjallur me dhikër dhe është shkëlqyer me nurin hyjnor, ngado që sheh dhe këdo që takon, Allahun e bën dhikër. Në çdo veprim në jetë, zemra bën dhikër Allahun. Edhe po të dojë, nuk do të mund të harrojë Allahun Teala.

LLOGARIA ËSHTË KUSHT

Çdo besimtar duhet të përcaktojë një kohë gjatë ditës për të kontrolluar situatën e zemrës së vet, dhe gjendjen. Duhet të ketë një kohë për llogaritjen e veprimeve ditore. Siç ka barku të drejta, duhet të pranohet se edhe zemra ka detyra dhe të drejta. Duke menduar se sikur barku, edhe zemra ka nevojë për ushqim, duhet caktuar koha e përshtatshme për dhikër.

Ai që nuk ndanë kohë në këtë mënyrë, duhet ta dijë se vetëm me pesë kohët e namazit dhe me leximin e Kur'anit një herë në javë zemra nuk ngjallet, nefsi (egoja) nuk edukohet, ai nuk bëhet si ata që bëjnë shumë dhikër Allahun Teala.

Një mënyrë tjetër për tu bërë bashkë me Hakun duke qenënë mesine njerëzve është të ruhet edukimi. Shehlerët, çfarëdo që trajtojnë, trajtojnë me drejtësi që i përshtatet urdhërave hyjnorë. Nga punët dhe sjelljet e tyre del në shesh që ata janë miqtë e Allahut. Si serioziteti, edhe shakatë e tyre janë të mira, me edukatë. Çdokënd e trajtojnë ashtu siç është e nevojshme. Siç i mbrojnë të drejtat e miqve, as armiqve nuk ju bëjnë të padrejtë. Trajtimi i njerëzve e qet zemrën në shesh dhe është matja më e mirë për imanin e njeriut dhe nivelin e mendjes së tij. Ai që zemrën e ka lidhur për Allahun Teala, çdo punë bën me modesti, besnikëri dhe edukim. Edukimi i brendshëm reflektohet jashtë. Dashurinë në zemër e zbukurojnë sjelljet.

Shejh Alauddin Attar kështu tërheq vëmendjen rreth kësaj teme:

“Duhet të jemi brenda me Allahun, e jashtë me urdhrat e Tij. Kush i bashkon në vete këto dy gjendje, bëhet i përkryer.”

Shejh Safi këtë fjali e shpjegon kështu:

“Udhëtari i rrugës së drejtë duhet ta lidh zemrën me Hakun. Qëllimi i tij duhet të jetë vetëm kënaqësia e Allahut. Përveç kësaj, në dukje të gjitha punët duhet

bërë në përputhje me Kur'an dhe sunnet. Ai duhet të largohet prej çdo gjëje që është kundër sheriatit. Ai që e përfiton këtë gjendje, nga brenda dhe nga jashtë, quhet 'Sadik'(besnik).⁸⁸

Nuk është besnik dhe i singertë ai që në dukje është njeri i drejtë, por brenda vetes pret përfitim nga njerëzit. Ai është ose xhahil (i paditur) ose munafik(përçarës).

Udhëtari i rrugës së drejtë, si në familje, me fqinjët, në lagje, me kolegët e punës dhe me tërë shoqërinë, duhet të sillet si besimtar që zemrën e ka të lidhur për Allahun Teala, qëjton për kënaqësinë e Allahut dhe që është njeri i drejtë. Me mënyrën e sjelljeve karshi njerëzve duhet ta masë se sa është ngjallur zemra, sa ka përfituar nga dhikri që e bën dhe sa është i edukuar.

Të dashurit e Hakut nuk merren me kërkimin e mangësive të të tjerëve, nuk bartin thashetheme, nuk përqeshin, fyejnë, e as nuk flasin fjalë boshe. Ai që merret me gjëra boshe, e ka edhe zemrën bosh. Zemra që ka njohur Allahun Teala nuk ka shqetësim për ushqimin dhenuk ka frikë se çka do të ndodhë nesër.

Ai që ka gjetur kënaqësi me dhikrin e Allahut Teala, prej askujt nuk kërkon dashuri as interes, gjithçka që bën, e bën për kënaqësinë e Allahut. Ai nuk di lajka, nuk i afrohet gënjeshtëris dhe e mban fjalën e dhënë. Ai

⁸⁸ Reshahat, 109-110.

bëhet dëshmi e Hakut në mesin e njerëzve. Ata që e shikojnë – shijojnë edukatën, e njohin të drejtën, e kuptojnë besimtarin e vërtetë, i orientohen mirësisë, dhe e përkujtojnë Allahun.

Me fjalinë *“në mesin e njerëzve, me Hakun”*, shehlerët gjithashtu kanë nënkuptuar që njerëzve t’iu bëhethizmet për kënaqësinë e Allahut. Shehlerët për shërbim kanë preferuar të hyjnë në mesin e njerëzve, dhe të përhapin diturinë, thirrjen dhe edukatën e mirë. Ata kanë marrë hadithin në vazhdim si princip për këtë:

“Ai që hyn në mesin e njerëzve për bamirësi dhe shërbim, dhe mundimeve të tyre u bën sabër (i duron), është besimtar më i dobishëm se ai që nuk hyn në mesin e njerëzve dhe nuk i bën sabër (nuk duron) mundimet e tyre.”⁸⁹

Një kuptim tjetër i të qenit me Hakun në mesin e njerëzve është edhe preferimi i modestisë dhe thjeshtësisë.

Udhëtari i rrugës së drejtë, në dukje i përshtatet njerëzve, vishet njëjtë si të tjerët. Por, në brendësi jeton në një gjendje ndryshe nga ta.

Trupi në tokë, zemra dhe shpirti në qiell!

Dora në tregti dhe fitim, zemra në dhikër!

⁸⁹ Trmidhi, Kijame, 55; Ibnu Maxhe, Fiten, 23; Ahmed, Mysned, III, 43.

I tilli, fsheh brenda zemrës dashurinë, dhikrin, dhe marifetin.

Ai duket si njëri prejmasës së njerëzve; nuk zgjedh ndonjë veshje të posaçme për të reflektuar gjendjen e tij.

Ai nuk dëshiron të njihet dhe të lavdërohet.

Për të mjafton që për çdo gjendje të tij e di Allahu Teala.

Allahu është i kënaqur me njeriun e drejtë dhe ky është i kënaqur me Allahun. Kjo kënaqësi është më e ëmbël se sa bota dhe ahireti.

Inshaallah Allahu Teala me Rahmetin e Tij na ëmbëlson edhe neve me këtë shije.

SEFER DER VATAN

Në çdo moment udhëtim drejt Hakut

Edhe një princip i rëndësishëm është *Sefer Der Vatan*.shkurtimisht ka kuptimin '*udhëtim në vatan*(atdhe)'. Këtij udhëtimi mund t'i themi edhe *udhëtim në vatanin e vërtetë, burimor*.

Vatan do të thotë vendqëndrim i vazhdueshëm. Vatani kryesor i njeriut, ku ai vazhdimisht do të qëndrojë, është Xheneti. Udhëtimin në Xhenet e realizon zemra. Për njeriun, as Xheneti nuk është qëllimi kryesor. I vetmi qëllim që ekziston është kënaqësia e Allahut Teala! Por Xheneti është i çmuar sepse është

vendtakimi me bukurinë e Allahut Teala, dhe soditja e asaj bukurie.

Shehlerët, kur thonë sefer (udhëtim), mendojnë udhëtimin drejt Allahut (*sejir ilallah*), sepse ky është udhëtimi kryesor. Lumturia e vërtetë është takimi me Allahun Teala. Të gjithë erdhëm prej Tij, dhe Atij do t'i kthehemi.

Ky kthim ka dy mënyra. Njëra me detyrim, e tjetra me dashuri.

Kthimi i detyruar realizohet me vdekje. I gjithë njerëzimi, besimtarë a qafirë, me vdekje mbledhen në ahiret para Allahut Teala, të gatshëm për llogarinë e madhe. Nuk është e mundur të iket nga kjo. Vetëm se, në këtë takim, disa gjenden në cilësi të miqve, e disa në cilësi të armiqve. Miqtë përgjithmonë në Xhenet, armiqtë në vuajtje përgjithmonë në Xhehenem.

Kthimi me dashurite Allahu Teala bëhet në këtë botë. Kësaj i thuhet '*iman*' dhe '*inabe*'.

Inabe është drejtimi i robit me tërë qenien Allahut Teala, dhe dorëzim Atij me sinqeritet. Ky drejtim bëhet në botën e brendshme; ai realizohet me zemër.

Kjo në vete i ka metodat e veçanta. Allahu Teala na ka mësuar se në çfarë mënyre të bëhet ky udhëtim shpirtëror, dhe si të arrihet në prani hyjnore. Në këtë udhëtim, Allahu Teala vendosi përpara Muhammedin s.a.v.s., si udhëzues për gjithë njerëzimin. Nuk ka rrugë tjetër që arrin te Allahu Teala pos rrugës së Muhammedit s.a.v.s.

Muhammedi s.a.v.s., kështu na shpjegon mënyrën e afrimit:

“Allahu Teala lajmëron: Robi Im, me asgjë tjetër nuk më afrohet si me ibadete farz, që janë më të dashurat për Mua.Pastaj, robi Im vazhdimisht më afrohet me ibadete nafile. Në fund, atë e dua.

Kur e dua robin, atëherë bëhem syri me të cilin sheh,veshi me të cilin dëgjon, gjuha me të cilën flet, dora me të cilën mban, këmba me të cilën ecë.Ai sheh me Mua, dëgjon me Mua, flet me Mua, mban me Mua, ecë me Mua. Çka kërkon, atë i jap. Te Unë strehohet, atë e mbroj.”⁹⁰

Allahu Teala urdhëron që:

Kur një rob i Imi më përmend mua, Unë jam me të. Nëse robi Im më përmend në vete(fshehtë),Unë do ta përmendi atënë Qenien Time(Dhat)në mënyrë të veçantë. Nëse më përmend Mua në një shoqëri, Unë do ta përmendi në një shoqëri edhe më të mirë.

Po të më afrohet robi Im Mua, një pëllëmbë, Unë afrohem atij një kut.

Po të më afrohet robi Im një kut, Unë atij i afrohem një pash.

Po të vijë robi Im kah Unë duke ecur, Unë shkoj kah ai duke vrapuar.”⁹¹

‘Veprat janë sipas qëllimit, dhe çdokujt i takon ajo që e ka për qëllim. Prandaj, kush shpërngulet

⁹⁰ Buhari, Rikak, 38; Ibnu Maxhe, Fiten, 16.

⁹¹ Buhari, Tevhid, 15; Muslim, Zikir, 19,21.

(hixhret) për shkak të Allahut dhe të dërguarit të Tij, shpërngulja e tij është për Allahun dhe të dërguarin e Tij. Ndërsa, shpërngulja e kujt është sa përtë fituar disa të mira të kësaj boteapo për tu martuar, i atilli nuk do të fitojë tjetër përveççka ka pasur për qëllim.”⁹²

Luftëtar(muxhahid) i vërtetë është besimtari që lufton me veten në çështjetë dorëzimit ndaj Allahut.⁹³

I shpërnguluri vërtetë (muhaxhir)është besimtari që largohet nga punët e haramit të cilat Allahu Teala i ka ndaluar.”⁹⁴

Udhëtimet që përshkruajnë dhe stimulojnë ajetet dhe hadithet,disa shehlerëi kanë shpjeguar me shprehjen ‘*Sefer der Vatan*’.Në tasavvuf, udhëtimit në këtë rrugë, prej fillimit deri në fund, i thuhet *sejr-u suluk*.

Për njeriun udhëtimi te Allahu Teala ka filluar në botën e shpirtave, në *el-est bezmi*, me marrëveshjen hyjnore.Atij që neve na pyet: “*Prej kur je mysliman?*”, ne i përgjigjemi: “*Unë jam mysliman prej kalu belas!*”.

Nëse pyetja është: “*Çka është kalu bela?*”, atëherë përgjigja është kjo:

Kalu bela është marrëveshja e shpirtave me Allahun Teala. Domethënia e saj është: “*Po, dëshmuam,*

⁹² Buhari, Iman, 41; Ebu Davud, Talak, 11; Tirmidhi, Xhihad, 16; Nesai, Teharet, 59.

⁹³Tirmidhi, Fezailu’l-Xhihad, 2; Bejhaki,Shuabu’l-Iman, VII, 499

⁹⁴ Buhari, Iman, 4; Ebu Davud, Vitir, 2; Nesai, Iman, 9; Ibnu Maxhe, Fiten, 2

ti je Rabbi ynë". Para se t'i krijonte trupat, Allahu Teala krijoi shpirtrat, i mblodhi ato, i mori në praninë e Tij dhe i bëri dëshmues së vetes së tyre duke u thënë: *"A nuk jam Rabbi (krijuesi, zotëruesi) juaj?"*. Ata thanë: *"Po, dëshmuam!"*

"Përkujtoje kur Rabbi yt nxori nga kurrizi i bijve të Ademit pasardhësit e tyre dhe i bëri dëshmues të vetes së tyre, u tha: 'A nuk jam Unë Rabbi juaj?' Ata thanë: 'Po, dëshmojmë se Ti je!' Kështu bëri Ai, në mënyrë që ju (o njerëz) të mos thoni në ditën e kiametit: 'Ne nga ky dëshmim ishim të panjohur'."

"Ose të mos thoni: 'Prindërit tanë më parë ishin idhujtarë, e ne ishim pasardhës të tyre. A do të na shkatërrosh ne për atë që bënë ata asgjësues të së vërtetës?'".7-A'rafë: 172-173.

Allahu Teala në këtë marrëveshje i mbajti për dëshmitarë edhe melaiket. Kjo është marrëveshja e parë ndërmjet Allahut Teala dhe robërve të Tij. Edhe pse nuk na kujtohet neve, për këtë marrëveshje na tregon dhe na përkujton Allahu Teala në Kur'an.

Këtijtubimi në të cilin është bërë kjo marrëveshje i thuhet *'Elest Bezmi'*.

Ata që sot janë besimtarë dhe myslimanë, në atë tubim me singeritet thanë: *"Po, ti je Rabbi ynë"*. Prej aty

fillon besimi në Allahun Teala. Prandaj edhe thuhet:
“*Mysliman jam prej Kalu Belasë*”.

Kjo marrëveshje është duke vazhduar edhe në këtë botë dhe do të vazhdojë përjetësisht në ahiret.

Udhëtimi shpirtëror realizohet në faza.

Faza e parë është largimi nga çdo lloj gjynahu dhe gafleti. Kjo fazë është të penduarit me një *teube të singertë (nasuh)* dhe zgjimi i zemrës nga gafleti.

Kjo është të drejtuarit Allahut Teala me zemër dhe trup. Pa u bërë kjo, përparimi nuk fillon, nuk arrihet në cak. Është e mundur që *teube e singertë* mos pranohet menjëherë, por duhet të punohet, dhe duhet sabër (durim) deri sa kjo të përfitohet.

Faza e dytë është pastrimi i zemrës nga ambiciet e kësaj bote, siç janë pasuritë e tepërta, pozita dhe reputacioni. Kështu që asgjë nuk i bëhet pengesë dhikrit të Allahut Teala, nuk e dëmton dashurinë hyjnore dhe nuk e mbush zemrën me frikë dhe brenga. Kësaj i thuhet *zuhd*. Zuhd nuk është të braktisurit fizik të kësaj bote, por të braktisurit e kësaj bote me zemër.

Faza e tretë është shpëtimi prej sëmundjeve shpirtërore dhe largimi i cilësive të këqija që kanë zënë vend në zemër. Këtij pastrimi shpirtëror i thuhet *tezkije*.

Tezkije është shpëtimii zemrës ngapavëmendja (gafleti), egoizmi, urrejtja, madhështia, xhelozia – nga të gjithasëmundjet efshehta. Ky pastrim ndiqet me zbukurimin me moral të bukur. Në edukimin shpirtëror një herë vjen pastrimi, e më pas bukuria. Nëse njeriu e realizon këtë, ai ka hyrë në rrethin e devotshmërisë, dhe ka bërë hapin në miqësi të veçantë me Allahun Teala.

Faza e katërt është kur zemra arrin në gjendje të soditjes. Kjo është grada ihsan (ata të cilët i bëjnë ibadet Allahut Teala sikur ta shihnin Atë) që përshkruhet në hadithe.

Sipas shehlerëve, grada e ihsanit është kur në çdo gjë shihen manifestimet e Allahut Teala (texheli); kur nga kjo botë, me syrin e zemrës, shikohet bota e melaikeve; kur në çdo vend, në çdo gjë, në çdo lëvizje posedohet një zemër që mund ta sheh manifestimin dhe artin e Allahut Teala. Është kuptimi i fshehtësisë së ajetit:

“Kah do të drejtoheni, Allahu është aty”.

VUKUF-I ZAMANI

I vetëdijshëm për çdo moment që jeton

Vukuf-i Zamani, është të jesh i vetëdijshëm për kohën në të cilën gjendesh. Me një shprehje tjetër, të jetohet me zemër të ngjallur, të larguarit nga gafleti për çdo moment, të dihet ajo që na takon dhe ajo që duhet bërë në secilin moment që gjendemi. Kësaj shehlerët i thonët'ia kushtosh jetën Allahut Teala. Ky moral i lartë, kjo dashuri hyjnore, është përmbledhur në ajetin:

“Thuaj: ‘Në të vërtetë, namazi im, kurhani im, jeta ime dhe vdekja ime, i përkasin vetëm Allahut, Rabbit të botëve’.”6-En’amë:162.

Sepse në çdo kohë, e drejta për lavdërim, dashuria dhe dhikri, i takojnë Allahut Teala. Kjo e drejtë nuk hiqet për asnjë moment. Sepse çdo moment i njeriut është një jetë e veçantë, dhe burim i kësaj jete është Allahu Teala. Njeriu është nevojtar për Allahun Teala, në botë edhe në ahiret.

Krijuesi i Lartë sqaron se të gjitha kohërat që përbëhen nga nata dhe dita, janë krijuar për dy arsye; tedhekur (përkujtim) dhe shukur (falënderim).

“Ai krijoi natën dhe ditën që të vijë njëra pas tjetrës, si argument për ata që duan ta kujtojnë ose ta falënderojnë.”25-Furkanë: 62.

Dijetarët, *tedhekurit* i kanë dhënë kuptimin e nxënies së mësimiit përmes vrojtimit dhe dituri.

Dituri është të njihet poseduesi i gjithësisë, ndërsa përmes nxënies së mësimiit duke shikuar paraqitjen e artit hyjnor në çdo kohë, zemra lidhetpër Krijuesin.

Shukur(falënderim) është të dihet se prej kujt vjen nimeti(mirësia), të gëzohemi me nimet, dhe të duhet Ai që e jep nimetin.

Shukur është që njeriu të kuptojë se gjithçka e vetja është pronë e Allahut Teala dhe të jetë i kënaqur me Allahun në çdo moment.

Resulallahu s.a.v.s. na ka njoftuar se kohërat që kalojnë në gaflet janë kohëra tëpërmallimitdhe të gjithë njerëzit që hyjnë në Xhenet,do të mërziten vetëm për kohën që kanë kaluar pa dhikër dhe shukur.”⁹⁵

KOHA ËSHTË PASURIA MË E MADHE

Të mëdhenjtë thonë që koha është pasuria më e madhe në gjithësi. Koha ia fiton njeriut të mirat, por edhe po të jepen gjithë të mirat e botës nuk mund të kthehet një moment që ka kaluar.

⁹⁵ Tebarani, el-Kebir,XX,Nr: 182; Ibnu’s-Sinni,Ameli’l-Jevmi ve’l-Lejle, Nr:3; Hajsemi, Mexhmau’z-Zevaid,X, 84; Mynziri,et-Tergib,II, 401

Në botë, secili moment jetohet vetëm një herë, dhe nuk kthehet më. Për këtë, shehlerët çdo moment e kanë shikuar si momentin e fundit dhe çdo frymë e kanë vlerësuar si frymën e fundit.

Në të vërtetë, jeta e njeriut është periudha në mes të dy frymëve. Nëse fryma që merret nuk nxirret mbrapa, jeta mbaron, dhe e kundërta. Këto fryma janë të numëruara, dhe numri i fundit është fshehur nga njeriu. Askush nuk mund të thotë *‘kaq fryma më kanë mbetur’* dhe *‘edhe kaq kohë do të jetoj’*.

Jeta e njeriut ndahet në tri pjesë. Njëra është koha e kaluar. Kjo periudhë, bashkë me të mirat dhe të këqijat, ka mbetur mbrapa. Periudha tjetër është ajo që ne nuk e posedojmë, e që e quajmë koha e ardhme. Njeriu nuk e di se a do të arrijë këtë kohë. Ekziston edhe periudha e tretë – ajo që njeriu e jeton për çdo moment, e tashmja; kjo është koha që e kemi në posedim. Kësaj kohe i thuhet rast. Çka ka nevojëtë bëhet në këtë kohë, do të bëhet. Sepse edhe kjo kohë është duke kaluar. Në punët e ibadeteve, të thuhet *‘e bëj më vonë, jo tani’*, është inspirim prej shejtanit.

Resulallahu s.a.v.s. ka lajmëruar se njerëzit janë mashtruar nga dy nimete të mëdha: shëndeti dhe koha e zbrazët.⁹⁶

Xhunejd Bagdadi thotë:

“Përdore mirë pasurinë e kohës, se ajo një herë tëvjën në dorë. Nëse e humb, ajo nuk kthehet për jetë të jetëve. Nuk ka pasuri më të çmueshme në gjithësi se koha.”

Hasan Basriu kështu i shpjegon gjendjet e sahabëve:

“Unë u takova me aso njerëz që, aq sa e ruani ju arin dhe argjendin që posedoni, ata edhe më shumë e ruanin kohën e tyre, dhe nuk e harxhonin në kotësi. Ashtu siç dikush nuk harxhon arin dhe argjendin në një punë që nuk ka fitim, edhe ata e ruanin kohën me kujdes, as edhe një frymëkot nuk e harxhonin. Ata nuk e harxhonin kohën në asgjë tjetër pos në përshtatje ndaj urdhrave të Allahut Teala.”

Hazreti Alia r.a. bashkëshortes së tij të ndershme, Hazreti Fatimes r. anhai ka thënë:

“Fatime! Kur e bën gjellën, bëje të lëngshme dhe të lehtë, që mos të kemi dert për typjen. Sepse gjella e lëngshmehahet shpejt, e gjellët e thata duhet të përtypen gjatë. Ndryshimi mes të dyjave është pesëdhjetë herë tespih dhe dhikër. Të mos ngelim

⁹⁶ Buhari, Rikak, 81.

mbrapa me vepra të mira, duke pritur gjatë përfundimin e gjellës.”

KOHA DUHET TË KUPTOHET MIRË

Çdo njeri që jeton brenda kohës, takohet me këto katër gjendje: nënshtrim, kryengritje, mirësidhevështirësi.

Nënshtrimi e bën të nevojshëm falënderimin Allahut Teala.

Ai që kryengritet i nevojitet istigfari dhe teubeja (pendimi).

Mirësitëkërkojnë modesti dhe falënderim.

Koha e vështirësisë është koha e durimit, duasë dhe lutjes.

Shkurtimisht, qëllimi është që njeriu ta përfitojë kënaqësinë (rizanë) e Allahut Teala dhe tëpërgatitet për ahiret.

Edhe të qeshurit edhe të qarit, është prej Allahut Teala. Është Allahu Teala Ai që kohën e rrotullon andej-këndeje, si të dojë, dhe që neve na vendos ballë për ballë me çdo lloj gjendje.

Duke na provuar në gjendje dhe situata të ndryshme, Allahu Teala dëshiron që ne të tregojmë

fuqinë e imanit, nivelin e kuptimit/perceptimit, nivelin e dashurisë.

Puna më e rëndësishme e udhëtarit të rrugës së drejtë është llogaria.

Llogaria është kontrollimi i zemrës se në çfarë gjendje është. Çdokush që i orientohet Allahut Teala dhe ahiretit pas një teube të sinqertë, duhet të llogarisë.

Çdo mbrëmje, udhëtari i rrugës së drejtë duhet të bëjë vlerësimin ditor: *‘Çka bëra unë për Allahun sot, çka dërgova në ahiretin tim? Çka më nevojitet mua në këtë gjendje? Çka është nijeti im, në çfarë gjendje është zemra ime’, duke pyetur veten ‘vallë, a nuk mund të bëhem më i mirë se gjendja në të cilën jam sot?’*

Shah-i Nakshibend principet e *vukuf-i zamani* kështu shpjegon:

“Ai që e njeh kohën, ai i njeh gjendjet e veta. Udhëtari i rrugës së drejtë, duhet t’i kontrollojë mirë nijetin dhe veprimet. Në qoftë se nijeti (qëlimi) dhe veprimet i përputhen me mësimin e edukatës së Kur’anit dhe sunnetit, Allahu Teala në atë moment është i kënaqur me robin. Duke iu gëzuar kësaj gjendje, rob i duhet të falënderojë. Në qoftë se në nijetin e robit nuk është kënaqësia e Allahut Teala, dhe veprimet e tij nuk përputhen me mësimet e fesë, ai menjëherë duhet t’i përvishet teubës dhe istigfarit. Në gjendje mangësie, rob i nevojitet teubeja.

Kjo rrugë është mbështetur në kontrollimin e secilit moment. Personi i zgjuar e dallon çdo frymëmarrje, se a ebbn me dhikër apo në gaflet.”

Shejh Ebu Muhammed el- Xherir thotë:

“Tasavvufi është të bërit e një pune në mënyrën më të mirë, në kohën e duhur.”⁹⁷

Shehlerët e marrin parasysh interesimin dhe nevojën e kohës në të cilën jetojnë. Ata e dinë mirë se cila mënyrë e edukimit është më e dobishme për nxënësin (muridin) e tyrevarësisht nga koha kur ai jeton, cilametodënevojitet, në cilin nivel është ky njeri, dhe prej cilës mënyrë të veprimit ai njeri kupton. Ai analizon mirë se në çfarë kushte jetojnë njerëzit; i pasur a i varfër, udhëheqës a punëtor, i pa-martuar apo i martuar, shkurt –me të gjithë njerëzit veprojnë sipas kushteve të tyre.

Ashtu siç e di hallvaxhiu derisa e pjekë miellin se kur duhet shtuar sheqeri, ashtu edhe shejhue di se në cilën kohëgjendet personi që ai e edukon, dhe për cilën vepër ka ardhur koha. Siç nuk lulëzon e nuk jep fryte pema pa ardhur koha, ashtu edhe njeriu nuk mund të bëhet i përkryerpa u ngjallur zemra, pa arriturnë pjekuri edukimi dhe morali i tij. Sikur fryti që është i idhët nëse nuk i ka ardhur koha e duhur natyrore për t’u pjekur,

⁹⁷ .” Kushejri, Risale, 356; Suhreverdi, Tsavvufi i Vërtetë, 70

edhe njeriu që nuk e plotëson procesin e edukimit – mbetet i pa kompletuar, nuk jep vlerë.

DHIKRI ME ZË (I HAPUR)

Lloj tjetër i dhikrit është ai me zë - dhikri i hapur. Ky dhikër bëhet me gjuhë.

Në dhikrin me zë, qëllimi nuk është që zërin ta dëgjojë Allahu Teala, por ta dëgjojë nefs i cili është zhytur në gjumin e thellë të gafletit. Për këtë arsye, nefs merret si cak. Fillohet me edukimin e nefsit, e në fund radha i vjen zemrës.

Për dhikër preferohet *kelime-i tevhid-i*: 'la ilahe ilallah'. Sepse dhikri i *kelime-i tevhid-i* është me vlerat më të larta. Pos kësaj, dhikri me zë bëhet edhe me shprehje/fjalë tjera të dhikrit.

Ky dhikër bëhet vet ose me xhemat. Të bësh dhikër me xhemat është sikur kur fal namazin me xhemat; ka më shumë sevape dhe është më i dobishëm.

Siç po shihet, të dy llojet e dhikrit kanë për qëllim ngjalljen e zemrës, edukimin e nefsit, përfitimin e kënaqësisë dhe lartësimin e Allahut Teala duke arritur në kuptimin e vërtetë të tehidit.

Të gjithë sufite janë në një mendim se dhikri merret vetëm nga një shejh (murshidi kamil), dhe është i dobishëm vetëm nën mbikëqyrjen e tij.

Dobia e parë e kësaj është përkrahja e shejhut me dua dhe njohuri.

Dobia e dytë është që zemra, si dhe dhikri që bëhet, janë nën kontroll. Shejhupërcjell kohën se kur duhet të shtohet ose ndërrohet diçka në dhikrin që ai ka preferuar për shërimin e zemrës. Ai kontrollon gjendjet dhe ndryshimet në trup, dhe bën ndërhyrjet e duhura.

Të bësh vet dhikër, sigurisht që është sevap, por në fazat e mëvonshme paraqiten edhe mashtrimet e shejtanit. Shumë njerëz kanë rënë në rreziqe duke iu pëlqyer vetja, duke parë si qëllim kryesor vetëm marrjen e kënaqësisë nga dhikri, duke iu paraqitur shejtani gjoja se është nga melaiket, duke u mjaftuar me dhikër e duke lënë ibadetet farz.

Nxënësi (murid)në edukim shpirtëror dhe në shërim duhet t'i përshtatet shejhut. Të zgjedhurit e dhikrit nga muridi, të ndërruarit e dhikrit që i është dhënë, të dëshiruarit e ndonjë dhikri tjetër; të gjitha këto janë prej shejtanit. Kjo me qëllim që muridit t'ia shpërndajë zemrën dhe ta ftohë atë nga dhikri (i përcaktuar). Ai që dëshiron të shtojë ose ndërrojë dhikrin, këtë duhet bërë duke u këshilluar me shejhun. Në të kundërtën, muridi bëhet si ai që vet e bën diagnozë sëmundjes së vet, veti përshkruan barnat, vet e zbaton shërimin.

Ata që nuk janë nën mbikëqyrje të edukimit nga një shejh, bëjnë mirë nëse bëjnë dhikret që kanë propozuar dhe preferuar dijetarët e Islamit. Për dhikër nevojitet shejhu, por ata që s'kanë shejh, nuk është e drejtë të mbesin larg nga dhikri.

ÇKA ËSHTË VIRDI?

Vird do të thotë detyrë ditore. Vird quhet edhe dhikri i rregullt ditor.

Ky dhikër mund të bëhet nëse lexohet një pjesë e Kur'anit, nëse bëhen salavate dhe istigfar.

Virdi është për zemrën si ilaçditor. Është e nevojshme që zemra të merr këtë ilaç çdo ditë, me qëllim që ajo të zgjohet nga gafleti dhe të gjejë shërim.

Virdi duhet të hyjë në jetën e myslimanit, sikur edhe pesë kohërat e namazit.

Të mëdhenjtë kanë thënë: *“ai që nuk ka vird, nuk ka as varid”*.

Varid dotë thotë njohuri dhe dhuratë hyjnore. Virdi është pasuria kryesore e udhëtarit të rrugës së drejtë. Virdi është pranuar si një esencë e miqve të Allahut. Virdi është rruga për të arritur miqësinë e Allahut Teala. Njeriu nuk mund të arrijë miqësinë e Allahut Teala pa dhikër.

Virdin duhet bërë edhe duke qenë në gaflet. Dhikri në gaflet është më i dobishëm dhe fitimprurës se sa të mos bëhet dhikër fare. Sepse, edhe nëse njeriu nuk e vëren, trupi në atë moment është izënë me dhikrin e Allahut.

Virdi mund të bëhet brenda 24 orësh, vetëm se koha më e mirë për dhikër është koha e sabahut dhe e akshamit.

Duke qenë i zënë me vird nuk duhet lënë pas dore e as të vonohenibadetet farz dhe sunnetet.

Muhamedi s.a.v.s. dëshiron që ummeti i tij të ndalet në çështjen e dhikrit, dhe kështu urdhëron:

“Bëni aq shumë dhikër Allahun, sa që njerëzit të thonë për juve se jeni çmendur!”⁹⁸

⁹⁸ Ahmed, Musned, III, 68; Hakim, Mustedrek, I, 499; Ibnu Hibban, Sahih, Nr: 817, Mexhmau’z-Zevaid, X, 75.

DOBITË E DHIKRIT

Ekzistojnë shumë ajete dhe hadithe që urdhërojnë dhikrin. Një numër kaq i madh i ajeteve dhe haditheve që flasin për dobitë e dhikrit, për sevapet dhe vlerat e tij të larta, tregojnë se dhikri është arsyeje jetës së besimtarit. Miqtë e Allahut, që ringjallin zemrat me dhikër, duke vështuar nimetet dhe dobitë e dhikrit, ia kanë rekomanduaratë fuqishëm të gjithë njerëzve.

Tani, të mundohemi të bëjmë përmbledhjen e sihariqeveqë janë dhënë në ajete dhe hadithe për dhikrin.

“Pra më kujtoni Mua, që Unë t’iu kujtoj juve.”

2-Bekare:152.

Ky sihariq mjafton për të treguar nderin dhe vlerën e lartë të dhikrit. Sufitë thonë se ky ajet është i mjaftueshëm që njeriu të vrapojë në dhikër!

Resulallahu s.a.v.s.,thotë:

“Kur qëndroni në bahçet e xhenetit,shfrytëzoni nga aty sa më shumë; hyni brenda, hani, pini.”

Kur as’habët pyetën: *“Ku janë këto bahçe tëxhenetit?”* Pejgamberi s.a.v.s. tha:

“Janë hallkat e dhikrit.”⁹⁹

⁹⁹ Tirmidhi, Deavet, Ahmed,Musned, III, 150.

Në bahçet e dhikrit gjinden fruta shpirtërore si dashuria hyjnore, muhabeti, mëshira, qetësimi, nuri, dituria, sinqeriteti, edukimi, teubeja, loti, vizita të melaikeve— istigfari dhe dua e tyre për ne.

Dhikri e afron njeriun Allahut Teala. Dhikri ia shton njeriut diturinëdhe dashurinë,ia lartëson atij gradën shpirtërore. Dhikri që bëhet me sinqeritet heq të gjitha perdet mes robit the Rabbit të tij, i kapërcen pengesat. Siçna e bëri të qartë, Muhammedi s.a.v.s., këto veçori të dhikrit nuk i ka asnjë ibadet tjetër:

“A doni t’iu jap lajmin se cila nga veprat tuaja është më e mirë te Rabbi juaj, e cila ngrit gradën tuaj më së shumti, e cila është edhe më e mirë se ndihmat e arit dhe të argjendit që i jepni, se vrasja e armiqve përballë jush ose të bërit shehid në luftë me ta? Kjo vepër është të bërit dhikër Allahun Teala.”¹⁰⁰

Dhikri është lustrimi zemrës, e pastron atë nga ndyrësitë shpirtërore dhe e zhduk gafletin brenda saj. Me nurin e dhikrit, zemra ndriçon dhe shkëlqen. Ky nur zgjerohet në tërë trupin e njeriut, çdo organ merr një pjesëndriçimi, trupi ëmbëlsohet me dashurinë e Allahut. Ai që humbet në nurin e dhikrit, fytyra i bëhet e bukur e fjala e ëmbël. Nga shikimi i tij rrjedh bereqet. Buzëqeshja e tij jep qetësi, çdo gjendje e tij reflekton

¹⁰⁰Trmidhi, Deavat, 6; Ibnu Maxhe, Edeb, 53; Ahmet, Musned, I, 190; Hakim, Mustedrek, I, 496

rahmet. Ky person është dëshmi e gjallë e Allahut Teala në sipërfaqen e tokës. Ai që e shikon këtë personpërkujton Allahun, bën dhikër, e do mirësinë.

Dhikri i hap dyert e kënaqësisë shpirtërore. Sufiu i madh, Ibrahim b. Ed'hem rah., këtë kënaqësi e shpjegon kështu:

“Allahu Teala ka vendosur aso kënaqësie në zemrat e miqve të tij, të atyre që e bëjnë dhikër Allahun shumë, sa që, sikur sulltanët e botës ta dinin se sa e ëmbël është ajo kënaqësi, do të sulmonin këto zemrame të gjitha ushtritë që kanë, për të marrë këtë kënaqësi. Por, miqtë e Allahut Teala këtë e fshehin, e sulltanët nuk janë në dijeni.”

Dhikri heq nga zemra hidhërimin, brengat, stresin. Frika dhe mërzia largohen nga zemra që ka gjetur qetësi me Rabbin e botëve. Zemra e gëzuar me dhikër për asnjë moment nuk përjeton frikë prej vetmisë, nuk mërzitet se çka do të ndodh me të, nuk shqetësohet për riskun. Edhe në një qeli të burgut po të ishte, do të ndihej si në pallate.

Dhikri forcon imanin në zemër, i fshinë dyshimet nga aty; i dorëzohet plotësisht Allahut, i shtohet bindja, përfiton ihlasin (sinqeritetin).

Atëherë, ibadetet bëhen të ëmbla dhe të lehta. Çka është uji për peshkun, dhikri është për zemrën. Pa dhikër, zemra vdes. Nga një njeri të cilit i ka vdekur zemra, nuk dalin punë të mira dhe të shijshme.

Dhikri shpëton nga vesveset, mashtrimet dhe dominimi i shejtanit në zemër. Allahu Teala, në suren ‘*Nas*’ përkthyer shejtanin me cilësinë ‘*hannas*’.

Hannas është tinëzar, frikacak, që futet aty ku gjen zbrazëti, e ikë sapo të kundërshtohet.

Shejtani, sapo ta gjejë zemrën bosh, futet në të. Mirëpo, sapo të vazhdojë zemra dhikrin, ikë e largohet. Deri sa vazhdon dhikri, shejtani nuk gjen rrugë për në zemër. Ai mundohet të hyj në zemër, por nuri i dhikrit e djeg shejtanin. Kështu, njeriu shpëton nga armiku i tij më i madh.

Dhikri që e djeg shejtanin është dhikri që bëhet me singeritet dhe edukim, që është larg nga gafleti. Dhikri që nuk ka edukatë dhe kënaqësinë e Allahut brenda vetes, nuk e largon shejtanin, por e largon rahmetin hyjnor.

Në qoftëse dëshirojmë të largojmë shejtanin nga zemra jonë, nga puna, shtëpia, familja dhe sofa jonë, rruga e vetme është dhikri me singeritet.

Dhikri është një kala e sigurtë karshi të keqes, ai shpëton njeriun nga harami. Një zemër dhe një gjuhë që është e okupuar me dhikër, nuk ka kohë për telendisje, gënjeshtër, thashetheme, përhapje të intrigave me haram dhe punë boshe.

Ruajtjanga punët boshe nuk është e mundur për atë që nuk merret me një lloj ibadeti, hizmet ose dhikër. Me dhikër është e mundur të shuhen kërkesat haram që i vijnë zemrës dhe të orientohet zemra kah mirësia. Zemra që përkrahet me dhikër mund të dallojë të mirën dhe të keqen.

Dhikri mund të bëhet kudo dhe kurdo. Për çdo ibadet është një kohë e caktuar, por për dhikër nuk ka kufizim kohor. Edhe nëse nuk bëhet dhikër me gjuhë në ndonjë vend apo kohë të caktuar, nuk ka asnjë pengesë që të bëhet dhikër me zemër.

Njeriuqë bën shumë dhikër Allahun Teala, me nurin e dhikrit e njeh veten e tij, zbulon zemrën, shpirtin dhe esencat tjera shpirtërore. Me këto dituri të reja qëpërfiton robi, i hapet syri i zemrës, e sheh anën e vërtetëtë kësaj bote dhe të ahiretit. I shikon manifestimete Allahut Teala në gjithësi, artin dhe mjeshtërinë e Tij. Kështu, i shtohet imani dhe dashuria ndaj Allahut Teala. Ai e adhuron me dashuri Allahun dhe i dorëzohet Atij.

Dhikri ia hap njeriut dyert e rahmetit. Gjatë kohës që robi bën dhikër Allahun, ai gjendet nën vështirimin dhe rahmetin e Tij. Allahu Teala nuk e lë vetëm në kohët e vështirarobin që bën dhikër për shumë kohë. Lutjet dhe dëshirat e tij nuk kthehen bosh. Ai rob ka përkrahjen e veçantë të Allahut.

Dhikri ia hap njeriut dyert e qiellit. Në tubimet e dhikrit zbret rahmet hyjnor, nur dhelumturi e brendshme. Melaiket vijnë në tubimet e dhikrit, dhe lusin Allahun për faljen e tyre. Ai qëpërmend Allahun, Allahu e përmend atë në mesin e melaikeve, melaiket e njohin atë, dhe bëhen mik me të. Kështu që emri i robit përmendet në qiell, personaliteti i tij njihet dhe respektohet.

Dhikri ia hap njeriut dyert e xhenetit:

“Për ata që kanë përmendur shumë Allahun, Allahu ka përgatitur falje gjynahesh dhe shpërblim të madh.”³³-Ahzabë:35.

Ky shpërblim është xhenetidhe Bukuria e Allahut të Madhërishëm (xhemalullah).

Dhikri, në ditën e *mahsherit* është bileta e fitimit. Ata që bëjnë shumë dhikër në këtë botë, në ahiret janë gjithmonë të buzëqeshur. Në *mahsher*, Allahu Teala i merr në mbrojtje të veçantë njerëzit e dhikrit, i strehon ata në hijen e rahmetit. Si në lajmin e gëzueshëm që e solli Resulallahu s.a.v.s., atyre që përmendin shumë Allahun, llogaria ubëhet e lehtë.¹⁰¹

¹⁰¹ Muslim, Dhikër, 4; Tirmidhi, Deavet, 128, Ahmed, Musned, II, 323.

Dhikri e shpëton njeriun nga fatkeqësia më e madhe, që është zjarri i xhehenemit. Resulallahu s.a.v.s. ka dhënë myzhden se vepra më e mirë për të shpëtuar njeriun nga zjarri është dhikri.¹⁰²

“Allahu i forcon besimtarët me fjalë të qëndrueshme në këtë botë dhe në botën tjetër.”

14-Ibrahim:27.

Fjala e qëndrueshme që Allahu Teala ka vendosur në zemrat e besimtarëve është *kelime-i tehvid* dhe dhikri. Kur robi bën dhikër Allahun Teala, kjo është një pasuri aq e madhe, sa që edhe vetëm një herë në jetë të thotë me sinqeritet ‘*la ilahe illallah*’, me bereqetin e këtij dhikri, nuk do të mbes përgjithmonë në zjarr, dhe do të hyj në xhenet.¹⁰³

Këto lajmetë gëzueshme lidhur me dhikrin janë për të gjithë. Mashkull a femër, i ri apo i vjetër, i varfër apo i pasur – të gjithë janë të ftuar në nimetet e dhikrit.

Aq sa bën robi dhikër me gjuhë e me zemër, aq arrin në dhurata hyjnore dhe sihariqe. Pas imanit dhe namazit, miqtë e Allahut më së shumti janë fokusuar në dhikër. Sepse ata personalisht kanë shijuar nimetet që përfitohen me dhikër, dhe kanë kuptuar që dhikri është ilaçi më i mirë për sëmundjet e zemrës, prandaj edhe i kanë preferuar dhikrin të gjithëve.

¹⁰² Tirmidhi, Hadithi Nr: 3377; Ibnu Maxhe, Nr: 3790.

¹⁰³ Buhari, Iman, 34; Muslim, Iman, 325; Tirmidhi, Sifatu Xhehennem, 9; Ahmed, Musned, V, 236; Ibnu Hibban, Sahih, Nr:200.

Shkurtimisht, të bërit dhikër Allahun Teala është jeta e zemrës, shija e saj, ilaçi dhe ushqimi i saj, është shkëlqimi i zemrës. Pa dhikër, zemra dobësohet, sëmuret, thahet, mbyllet, bëhet gur, dhe në fund vdes.

SOHBETI

Për edukimin e njeriut, metoda më me ndikim e preferuar në tasavvuf është *sohbeti* (biseda fetare).

Sohbeti është puna e as'habëve.

Sohbeti është ndihma dhe përkrahja njëri-tjetrit me gjendje, gjuhë dhe zemër.

Në tasavvuf, sohbeti më i dobishëm është sohbeti i shejhut. Sohbeti i shejhut përbëhet nga hyrja nën shikimin e tij, të dëgjuarit e fjalëve të tij, të përfituarit nga gjendja dhe ndikimi i tij.

Se sa është i nevojshëm dhe sa ka ndikim sohbeti i shejhut, Shah-i Nakshibend kështu e përshkruan:

*“Esenca e rrugës tonë është themeluar mbi sohbetin. Sohbeti i vazhdueshëm me shejhunbëhet ndihmë për arritjen e imanit të vërtetë.”*¹⁰⁴

¹⁰⁴ Xhami, Nefahatu'l-Uns, 533; Imam Rabbani, Mektubat, II, Letra 481.

Ka shumë ajete dhe hadithe lidhur me shoqërimin me njerëz të drejtë:

“O ju që besuat! Ta keni në kujdes Allahun dhe të jeni me ata të drejtë.” 9-Tevbe:119.

Si ndikon sohbeti në edukimin e njeriut, mund të kuptohet nga këto hadithe:

“Ai që gjendet në tubimin e njëjtë ma ata njerëz të mirë, është si ai që viziton shitësin e erërave të miskut. Ose blen nga ai erë të mirë, ose mbetet nën ndikimin e erës së mirë.

E ai që është bashkë me persona të këqij, është si ai që rritefarkëtar i -ose kërcen ndonjë gacë dhe e djeg, ose mbushet me erë të rëndë.”¹⁰⁵

“Personi merr shembull atë që e do, atëherëçdo kush le të ketë kujdes se me kë shoqërohet.”¹⁰⁶

Eshref Ali et-Tanevi rah. kështu e shpjegon shoqërimin me miqtë e Allahut, si dhe mënyrën dhe dobinë e sohbetit:

“Ruga për të shijuar vazhdimisht dashurinë e Allahut është vazhdimi i sohbetit me miqtë e Tij. Një herë në javë, ose së paku një herë në muaj, gjithsesi duhet marrë pjesë në këto sohbe. Duhet bërë bashkë me njerëzit e përkryer.

¹⁰⁵ Buhari, Zebaih, 31; Muslim, Birr, 146; Ebu Davud Edeb, 16

¹⁰⁶ Tirmidhi, Zuhd, 45.

Qëllimi i vazhdimeve të sohbetitështë kalimi i gjendjeve të mira që i posedojnë evliatë, dalëngadalë te ju.

Nuk duhet hequr dorë nga punët e domosdoshme vetëm për të vazhduar sohbetin. Për sohbet, mjaftojnë kohërat e lira. Nëse nuk jepet rast për këtë, duhet lexuar libra për jetën e evliave. Këto libra duhet lexuar duke i analizuar ato, si çdo vepër tjetër diturie. Qëllimi duhet të jetë që nga ato libra të përfitohen gjendjet dhe karakteri i evliave.”¹⁰⁷

Shkurtimisht, ashtu si njerëzit e këqij e përkeqësojnë njeriun, ashtu edhe njerëzit e mirë e shpëtojnë atë nga përkeqësimi. Për tu bërë i përkryer (kamil), duhet bërë bashkë me njerëzit e përkryer (kamil). Njeriu nuk ngritet duke qenë me njerëz të nivelit të vet.

Ebu Ali ed- Dakkak thotë:

“Pema që rritet vetë, fletët i qelin, por fruta nuk bën, e edhe nëse bën, ato fruta nuk hahen. Njeriu nuk mund të arrijë vet në gjendje të mirë, ai nuk mundet aq lehtë të ndërrojë veset e këqija. Pa shejh, njeriu bën ibadet sipas dëshirës së vet, por rrugë të shpëtimit nuk mund të gjejë.”¹⁰⁸

¹⁰⁷ Abdulbari en-Nedevi, et-Tasavvuf dhe Jeta, 135.

¹⁰⁸ Kushejri, Risale, II, 735.

Në rrugën e miqësisë me Allahun Teala, Aina urdhëron të jemi bashkë me miqtë e Tij, me ajetin:

“Ndihmojeni njëri-tjetrin në punë të mira dhe në të ruajturit nga të këqijat, e jo në gjynahe dhe armiqësi .”5-Maide:2.

RABITA -URA NGA ZEMRA NË ZEMËR

Rabita është një metodë e rëndësishme e edukimit në tasavvuf. Pa rabbitë, edukimi është shumë i vështirë.

Rabita është njoftimi i shpirtave, takimi dhe bashkimi i zemrave në të njëjtën dashuri. Një njeri që niset në rrugën e Allahut me një shejh si mund të përfitojë nga ai nëse nuk e njeh shpirtërisht prijësin që ka para vetes, në qoftë se nuk u bashkohen zemrat, në qoftëse nuk takohet në të njëjtën dashuri me të? Njeriu që nuk posedon një rabbitë dhe dashuri për Allahun, a thua, me çfarë lloj rabite zemra dhe dashuria e tij do të edukohen dhe ringjallen?

Rabita që bëhet duke iu përshtatur edukatës dhe qëllimit, është ilaçi më me ndikim për të zgjuar zemrën nga gafleti.

Në kuptimin gjuhësor, *rabitado* të thotë fije që lidh dy gjëra mes vete, pra – rabita është interesim, dashuri, lidhje, marrëdhënie.

Në tasavvuf, *Rabita* është të lidhet zemra e muridit me zemrën e shejhut që ka arritur në bindje (jekîn), është ngritur në gradën e soditjes shpirtërore (mushahede), është zbukuruar me edukatën e Muhammedit s.a.v.s. dhe është zhytur me të gjitha esencat shpirtërore (letaif) në dhikër.

Një kuptim tjetër i rabitës është kur njëmurid, duke lidh zemrën e vet me shejhun e tij, merr nga ai dituri, dashuri dhe nur.¹⁰⁹

Kështu, rabita është një rrugë për të ngjallur zemrën, për ta tërhequr atë në dhikër, për ta mbrojtur nga sulmi i shejtanit.

Rabita është një masë e bukur sigurie për të penguar shigjetat e vesveses që janë hedhurnë zemër, për të dëbuar mendimet e këqija që sulmojnë atë.

Rabita është që të ruajmë zemrën tonë, duke lidhuratë me murshidin. Rabita është forcimi i zemrës me ndihmën e shejhut duke tërhequr nga ai dashurinë, njohurinë, dhe nurin, si dhe të bëhet zemra e qëndrueshme në rrugën e Allahut.

Gjithë dashuria, dituritë, njohuritë, dhe nuri hyjnor që vijnë nga shejhu, në të vërtetë janë rahmet dhe pronë e Allahut Teala. Nëse dikush këto mund t'i merr drejtpërdrejtë nga Allahu Teala, atëherë nuk ka nevojë për ndonjë ndërmjetësim.

¹⁰⁹ Imam Rabani, Mektubat, I, 252-253. Ibrahim Fasih, Mexhid-i Talid.

Vetëm se, për të tërhequr këtë rahmet, për ta ruajtur atë, dhe për t'i dhënë hakun, zemra duhet të kalojë nëpër një edukim tepër serioz dhe duhet të arrijë në gjendjen e gatishmërisë për bartjen e amaneteve hyjnore. Përndryshe, zemra gafil dhe shpirtërisht e sëmurë, nuk mund të arrijë këto nimete. Zemra e sëmurë ka nevojë për edukim dhe përkrahje.

Pra, rabita është edukimi dhe pastrimi i zemrës në dorën e një shejhut, si dhe forcimi i saj me përkrahje të veçantë nga ana e tij.

SECILI MUND TË BËJË RABITËN

Rabita mund të quhet secila lidhje me të cilën zemra i jep rëndësi një subjekti.

Një lidhje e tillë mund të bëhet edhe me të keqen, edhe me të mirën.

Ky subjekt me të cilin zemra lidhet dhe të cilin e do mund të bëhet njeriu, kjo botë, një send, ose paratë. Në këtë kuptim, rabitë bëjnë të gjithë njerëzit, me emra të ndryshëm, në mënyra të ndryshme, në shkallë të ndryshme.

Të mohosh rabitën do të thotë të mohosh njeriun. Sepse në esencë, rabita përbëhet nga të menduarit, të imagjinuarit, dashuria, malli, përkujdesja dhe të ndikuarit. Në vend se të mohohet rabita tërësisht, duhet punuar në përmirësimin e përdorimit të gabuar të saj.

RABITA ËSHTË NJË LLOJ MEDITIMI

Të përkujtojmë këtë fakt të rëndësishëm – rabita nuk është një ibadet, por është metodë që përdoret për të përgatitur zemrën për ibadet. Është një lloj meditimi që e urdhërojnë Kur’ani dhe sunneti, është një mënyrë e vetëkontrollit.

Çdo gjë mund të imagjinohet, përpos Qenies së Allahut Teala (Dhat). Resulallahu s.a.v.s., na ka ndaluar të paramendojmë Qenien e Allahut Teala. Kështu na ka përcaktuar se çka mund të paramendojmë:

“Mos meditoni mbi qenien e Allahut Teala, por meditonimbi nimetet e Tij dhe krijesat që Ai i ka krijuar, sepse ju nuk keni fuqi të meditoni mbi qenien e Tij, nëse bëni këtë shkatërroheni.”¹¹⁰

Nga ana tjetër, është obligim që, kur meditohet mbi krijesat dhe gjithësinë, të njihet edhe Pronari, Krijuesi, dhe të përmendet - të bëhet dhikër Ai.

¹¹⁰ Ebu Nuajm Hilje, VI, 67; Tebarani, el-Vasit, Nr: 631; Hejsemi, Mexhmua’z-Zevad I, 81; Ebu;sh- Sheh, Kitabu’l-Azamet; Nr; 4-5.

Meditim është të njohurit e mjeshtërisë së Allahut dhe të bërit adhurues i Tij, duke shikuar artin e Tij hyjnor në gjithësi.

Meditim është të shikuarit me syrin e zemrës të bukurive të fshehta hyjnoredhemanifestimeve në ekzistenca.

Pronari i vërtetë i të gjitha bukurive në gjithësi, mbizotërues i tyre, është Allahu Teala. VërtetëMadhështia është vetëm e Tij. Gjithçka që posedojnë njerëzit dhe melaiket është e Tij.

Misioni i mendjes është të njihet Ai.

Detyra e zemrës është të kërkojë Atë dhe të shijojë dashurinë e Tij.

Krijuesi Madhështor, ka fshehurqenien(dhat) me nur,si dhe e ka bërë perde me manifestime (texheli). Pastaj secilës mendje i dërgoi lajmin:

‘Ejani te Unë, njihmëni Mua, bëhuni miqtëe Mi’.

Aiqë dëshiron dashuri hyjnore, në çdo vend, prej çdo sendi, në çdo dashuri kërkon një dituri që i takon Atij.

Për ata që dëshirojnë të njohin Krijuesin e Lartë dhe të shijojnë dashurinë e Tij, rruga më e mirë është rruga ebesimtarit të përkryer.

Ata që janë bërë miq të Allahut janë dijetarët – shehlerët. Për të arritur dituritë hyjnore dhe dashurinë e tyre, duhet futur në thesaret e zemrës.

Për t'u futur në zemër, duhet përdorotë. Zemrën duhet orientuar kah shejhu, me singëritet duhet kërkuar ndihma, me sabër dhe edukim duhet pritur në derën e zemrës.

Në këtë mënyrë zemra i hapet zemrës; nga njëra zemër në tjetrën rrjedh nur, kalon dituri dhe përhapet dashuri. Ja, kësaj i thuhet rabita.

Shejhi (Murshidi kamil) është kriter matës për një murid, është pasqyrë për të, është shembull, është burim i dashurisë dhe diturisë. Muridi, duke shikuar në fytyrën e shejhut, sheh reflektimin e dashurisë hyjnore dhe edukimin nga zemra e tij. Çfarë dëmi ka të kujtosh një besimtar të tillë, ta marrësh atë në zemër, dhe takaloshkohën me të?

Një zemër e pavëmendshme (gafil) qëmerr dashuri nga një zemër e ngjallur, me këtë dashuri ushqehet, përkrahet, merr dituri, ngjallet dhe drejtohet kah veprat e mira për rizanë e Allahut; cila dëshmi ose logjikë mund të jetë kundër kësaj?

Kjo zemër është ringjallur me dashurinë hyjnore dhe me dhikër. Edhe zemrat tjera që lidhen me këtë zemër përfitojnë nga kjo dashuri dhe dituri, forcohen dhe ringjallen.

Prandaj, rabita është formë e shoqërimit me zemër, me mendje, me dashuri dhe me trup me shejhun– robin e drejtë dhe mikun e vërtetë të Allahut Teala.

Shejhut të cilit i bëhet rabita (lidhje me zemër) duhet të jetë trashëgimtar i Resulullahut s.a.v.s..qëposedon ndikim shpirtëror dhe që posedon leje(ixhazet).

Pra duke e lidhur kështu zemrën me shejhun, si në prezencë ashtu edhe në mungesë, paramendohet pamja dhe shpirtnia (*ruhanijeti*) i tij, paramendohet se është bashkë me të apo afër tij; sjelljet qëmuridi i ka gjatë kohës kur është me shejhun duhet t'i ketë edhe gjatë kohës kur është larg tij. Kësaj i thuhet rabita.

Qëllimi i rabbitës është që muridin ta ngrit në nivelin '*fenáfillah*'. Ky nivel është grada e ihsanit, e ajo është adhurim Allahun sikur jemi duke e parë Atë. Kur shejhue dërgon muridin në këtë nivel, ai tërhiqet.Atëherë rabita kalon në murakabe.

Murakabe është soditje shpirtërore ku në çdo vend dhe në çdo gjë shihet madhështia e Allahut Teala.

KRITERI BAZË NË RABITA

Kjo është shumë e rëndësishme: duke menduar shejhun, nuk duhet harruar se edhe ai është rob, posedon cilësitë e robit dhe nuk i duhet të përshkruar cilësitë që nuk i takojnë atij.

Një dashuri që kalon kufijtë e shndërron dashurinë në tradhti. Detyrë e muridit nuk është të lartësojë shejhun, por të përfitojë nga ai cilësi dhe edukatë të lartë morale, me çka arrin dashurinë e Allahut Tealadhe lartësohet tek Ai.

Mostaharrojë këtë muridi: nëse zemrën dhe përditshmërinë nuk e mbush me shejhun, zemra i gjen vetes një dashuri tjetër e cila e pushton. Por, me çfarëdo dashurie nuk arrihet kënaqësia e Allahut, çfarëdo dashurie nuk bëhet shkak i lumturisë.

DOBITË E RABITËS

Ka dy dobi që përfitohen me rabitë: e para është dhikri, dhe e dyta edukimi.

Sëmundja më e rrezikshme për njeriun është pavëmendshmëria (gaflet) dhe mendjemadhësia. Rabita e kthen gafletin në dhikër, mendjemadhësinë në modesti dhe edukatë të bukur morale.

Qëllimi i rabitës është të përfitohet kënaqësia e (rizaja) e Allahut.

Muridi i edukuar i cili përkrahë zemrën me rabitë, mësohet të veprojë mbi sunnet në çdo punë, bëhet i suksesshëm në ibadet.

Të mëdhenjtë kanë qartësuar që nëse muridi me edukim i përshtatet kushteve, për të rabita është e mjaftueshme që të arrijë përkryerje. Sa më shumë dashuri, aq më mirë e më bukur bëhet rabita (lidhja).

Shejhu është miku i vërtetë i muridit, është prijësi më i besueshëm në rrugën e drejtë. Kush e vendos atë para vetes në secilën punë, nuk ndahet nga e drejta dhe nga drejtësia. Shpirtnia (*ruhanijeti*) i murshidit ndikon dhe ndihmon sipas dashurisë dhe interesimit të muridit.

Kjo ndihmë dhe ky ndikim realizohen me lejen e Allahut Teala. Vetëm se, muridi duhet që me dashuri, singëritet dhe edukim t'i drejtohet zemrës së shejhut. Pengesa më e madhe për muridin në këtë rrugë është t'i pëlqejë vetja dhe ta sheh mendjen e vet si të mjaftueshme. Dashnori që nuk merret me veten e tij, lehtë arrin atë që e do. Ai që bie në dashuri, nuk thotë '*unë*'.

Një besimtari drejtë, me zemër mund të arrijë në çdo vend të kësaj bote. Zemrat me singëritet dhe me edukim mund të tërheqin rahmet prej *Arsh-iAzam*, ato mund të përfitojnë prej melaikeve në qiell dhe prej evliave në tokë, e edhe duhet të përfitojnë.

Në një mënyrë, rabita është të kërkuarit ndihmë nga ushtria e Allahut Teala, në tokë e në qiell. Si melaiket ashtu edhe evliatë, janë ushtarë të Allahut Teala. Me anë të tyre, Allahu Teala mbështetë dhe ndihmon kë të dojë.

Ai që e ka rabetën e fortë dhe vazhdimisht ruhet nga mendjemadhësia dhe egoja, me miqtë e Allahut përfiton sinqeritet. Veprat e mira që i bën, nuk i sheh si të mëdha, nuk e ka veten në huj, nuk bëhet kryengritës me pasuri, nuk lavdërohet me gradat dhe pozitat që arrin, nuk i nënçmon njerëzit. Në fund të çdo ibateti që bën dhe në fillim të çdo mirësie që përfiton, ai mban zemrën të zgjuar dhe tërheq veten në llogari-dhënie.

Kësaj gjendje i thuhet rabita e vazhdueshme. Fokusi dhe puna duhet të jenë në drejtim të përfitimit të kësaj gjendje. E ai që fiton këtë gjendje, në fakt ka fituar një lumturi të madhe. Sepse ai, është përkrahur me nur, është ushqyer me dashuri hyjnore, është lidhur me një udhërrëfyes në rrugëtimin *sirat-i mustekim*(rrugë të drejtë).

Në fakt, kuptimi i vërtetëi lidhjes me shejhunëstë të merretrruga e njëjtë me të, karakteri i njëjtë, edukata e njëjtë, veprat e njëjta, dashuria e njëjtë.

EDUKATA NË LIDHJE ME RABITËN

Muridi duhet ta shoh shejhun si një prijës besnik në rrugë të drejtë. Nuk duhet harruar se shejhu është mjeti më i mirë dhe shkak që arrit në kënaqësinë e Allahut Teala.

Fakti që shejhuprej së largundikon në zemra dhe jepnjohuri nur, është një kompetencë e veçantë që Allahu Teala u ka dhënë evliave. Atij që e do mikun e Allahut Teala dhe që e lidh zemrën me nurin që gjendet në zemrën e tij, Allahu Teala i jep dhurata shumë të veçanta. Largësia këtu nuk është pengesë. Ka plot shembuj për këtë.

Përshembull: Vejsel Karani, me dashuri dhe me rrugë shpirtërore ka marrë një edukim të veçantë dhe dituri nga Muhammedi s.a.v.s, edhe pse nuk e ka parë. Muhammedi s.a.v.s. u ka treguar as'habëve për Vejsel Karanin, ia ka përmend emrin, ka folur për cilësitë e tij. Posaçërisht, ka urdhëruar Hz. Omerin dhe Hz. Aliun që ta vizitojnë, dhe i ka këshilluar:

“Kur të takoheni me të, kërkoni që ai të bëjë *istigfar* për ju, që Allahu t’iu falë.”¹¹¹

Kësaj gjendje i thuhet njoftim, bashkim dhe ndihmë e shpirtrave të pastër. Zaten, rabita përbëhet nga dashuria e shpirtrave për njëri-tjetrin dhe përmallimi i tyre.

Me lejen e Allahut Teala, është e mundur që shejhunga larg të shikojë dhe të njoh gjendjen e muridit. Por, mënyra e shikimit dhe dijes është e kufizuar.

Është haram dhe shirk të mendohet se shejhusheh dhe di çdo gjë, sikur Allahu Teala. Të gjitha kompetencat, nuri, dashuria, dituria eshejhut janë dhuratë e Allahut Teala. Shejhu posedon vetëm atë që i jep Allahu Teala dhe në masën që i jep Ai.

Shah-i Nakshibend kështu sqaron se si një evlia e sheh muridin nga larg:

“Evliatë, çdo gjë që shohin, e shohin me nurin e shikimit të zemrës, që Allahu Teala u ka dhuruar. Kur ata shikojnë me këtë nur, distanca nuk është pengesë.”

¹¹¹ Ebu Nuajm, Hijetu’l-Evlija, II, 96-100; Hakim, Mustedrek, III, 403-404.

PËRFUNDIM:TASAVVUFI ËSHTË SHËRBËTOR I FESË

Edukimi i tasavvufit është i ndërtuar mbi esencat e Kur'anit dhe sunnetit.

Tema e tasavvufit është njeriu,zemra e njeriut.

Qëllimi është qënjeriu të ngritet në edukatëtë bukur morale.Metoda është ajo që ka preferuar Resulallahu s.a.v.s.,– metoda e sohbetit(biseda). E pasuria e tasavvufit është dashuria hyjnore, sinqeriteti, dhikri, lutja, edukata dhe loti.

Mënyrën për edukim që e preferon tasavvufi mbështetet në dëshmitë dhe shkaqet e pranuar nga feja.Pos ajeteve dhe haditheve, burime tjera të tasavvufit janë edhe fjalët dhe veprat e as'habver.anhum,intepretimet,traditat dheurdhratsi dhe parimet e feve të mëparshme që nuk janë anuluar.

Për të vlerësuar tasavvufin dhe metodat që ai përdor, duhet të merren parasysh të gjitha këto, duke hulumtuar dëshmitë që ekzistojnë në fe.

Ai që nuk e njeh kuptimin e burimeve të këtyre urdhrave dhe parimet e gjuhës, duhet të heshtë, ose të pyes atë që di. Në të kundërtën, ai bën *fitne*, futet në rrezik.

Një metodë si rabita, që mëson zemrën në dhikër dhe që përdoret për pjekuri, nuk ka nevojë të kërkohet në ajete dhe sunnet me këtë emër. Duhet shikuar se çka fitohet me këtë metodë në përfundim. Kur analizohet mirë rabita, do të shihet se ajo është një lloj meditimi.

Qëllimi i meditimit që urdhërohet dhe stimulohet shumë në Kur'an është i njëjtë me qëllimin e rabbitës.

Qëllimi i këtijmeditimi është që duke i menduar krijesat - në to të shihet arti i lartë i Krijuesit Madhështor, duke shikuar urtësinë - të arrihet dashuria hyjnore dhe njohja (marifet). Ky është pikërisht qëllimi kryesor në tasavvuf dhe fryt i rabbitës.

Fejaislame përbëhet nga imani, dituria, sinqeriteti dhe veprat e mira. Fryt i imanit dhe veprave të mira është xheneti. Nuk është qëllim i edukimit të tasavvufit të arrihen gjendje ndryshme të dalldisë hyjnore apo mrekullive. Qëllimi kryesor është përshtatja shariatit.

Nuk bën t'i përshtatem personit që kundërshton kriteret e fesë dhe jeton në atë gjendje. Ky person, edhe po të zbukurojë veten me veshje si pejgamber, veli, sufi – është bërë lodër e shejtanit. Personi i tillë ka nevojë për korrigjim, ai është jashtë tasavvufit të vërtetë që përshkruam.

Ne po përshkruajmë ajetin që shpjegon cilësitë e miqve të Allahut Teala:

“Dëgjoni atë që nuk kërkon prej jush ndonjë shpërblim dhe është udhërrëfyes.”³⁶-Jasinë:21.

Allahu Teala, edhe me ajetin në vazhdim, në esencë na jep lajmin se pas cilit person duhet të shkojmë, dhe cilësitë e të cilit duhet kërkuar:

“E ti ndiqe rrugën e atij që është i kthyer kah Unë.”³¹-Llukman:15.

Junus Emre thotë:

“Po të ishte dervishllëku me një kafshatë e një xhybe, edhe ne do takishim blerë atë për tridhjetë a katërdhjetë.”

Edhe Xhunejd Bagdadi thotë:

*“Ne nuk e fituam tasavvufin me transmetim prej atij a prej këtij dhe me fjalë të thata. Atë e fituam duke duruar uri vetëm për hatër të Allahut, duke hequr dorë nga kërkesat e botës, dhe duke u larguar nga gjithçka që më herët kemi dashur dhe me çka jemi mësuar.”*¹¹²

¹¹² Mynavi, el-Kevakiby'd-Dyrrijje, I, 378; Suhreverdi, Tasavvufi i Vërtetë, 62

Ata që shoqërohen me miqtë e Allahut, prej tyre mësojnë miqësinë me Allahun Teala. Qëllimi i jetës është të bërit mik i Allahut. Nuk ka lumturi jashtë kësaj.

Prej Allahut kërkojmë dashurinë e Tij, dashurinë e atyre që Ai i do; dëshirojmë veprat që na arrijnë te dashuria e Tij.

Elhamdulillahil'lahi rabbi'l-alemin.

